## KQZ-ja pret që rezultatet të shpallen më herët sesa ka parashikuar



Faqe 2

## Kamberi: Viti 2026 mund të shënojë fundin e pushtetit të Vuçiqit



Faqe 3

## Odesa në terr dhe në të ftohtë: Jeta nën sulmet e pandërprera ruse



Faqe 7

## Te "Dardanët" mund të ketë lëvizje, por jo të shumta



Faqe 17


# KOHA DITORE

e martë • 6 janar 2026

Numri 10234

www.koha.net


NJË JAVË PAS ZGJEDHJEVE ENDE "NUK KA REFLEKTIM" NGA PARTITË POLITIKE QË SHËNUAN RËNIE NË ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

# Partitë opozitare heshtin lidhur me reformat e premtuara pas humbjes në zgjedhje

**Një javë nga zgjedhjet e 28 dhjetorit, nga partitë opozitare ende nuk ka lëvizje në drejtim të zotimit të dhënë, atë për reforma. Në PDK e LDK nuk kanë treguar se kur do t'i zyrtarizojnë zgjedhjet e brendshme. E njohës të zhvillimeve politike vlerësojnë se ndryshimet duhet të jenë të mëdha, e jo vetëm të udhëheqësve**

**Valbona Bytyqi**

PRISHTINË, 5 JANAR – Liderët opozitarë nuk kanë nisur ende punën e premtuar për të reformuar partitë që drejtojnë, pas humbjes në zgjedhjet e 28 dhjetorit.

Një javë nga zgjedhjet, në Partinë Demokratike të Kosovës, që doli e dyta, kanë heshtur. Po ashtu edhe për Lidhjen Demokratike të Kosovës, KOHA ka mësuar se nuk ka lëvizje në drejtim të mbledhjes së kryesisë, e cila do t`i paraprinte mbajtjes së kuvendit zgjedhor.

Nga rezultatet e deritanishme, në të cilat nuk përfshihen në tërësi votat nga jashtë e as ato me kusht e të personave me nevoja të veçanta, PDK-ja është renditur e dyta me afro 188 mijë vota e LDK-ja e treta me afro 123 mijë vota. Krahasuar me rezultatet e 9 shkurtit 2025, PDK-ja ka pësuar rënie prej 8 mijë e 514 votave, kurse LDK-ja në këto zgjedhje ka 48 mijë e 540 vota më pak. Rënie prej 15 mijë e 360 votash ka pësuar edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, por që në zgjedhjet e kaluara garoi bashkë me Nismën.

Liderët e PDK-së e LDK-së, gjatë adresimeve të para pas shpalljes së rezultateve preliminare, patën pranuar përgjegjësinë dhe patën premtuar reforma të brendshme.

Sipas njohësit të zhvillimeve politike në vend, Berim Ramosaj, partitë politike duhet të bëjnë shumë ndryshime dhe jo vetëm në udhëheqjen e tyre.

"Refleksion i madh, mos me thënë radikal se nuk e njoh këtë koncept te partitë e djathta. Por mendoj se duhet me bo në mënyrë shumë të lehtë për ndryshimet që kërkohen dhe jo ndryshime veç në kreun, ai është i domosdoshëm. Ai duhet me qenë model për ndryshim, udhëheqja e tanishme, si me thanë kryesia ata ishte dashtë të deklarohen ose të largohen në mënyrë që t`i japin shanse, të hapin rrugë degëve, nëndegëve dhe të gjithë të tjerëve", ka thënë ai.

Ramosaj ka thënë se kalimi nga një lidership te tjetri duhet të bëhet me metoda konvencionale duke respektuar figurat "e vjetra" e duke futur "elemente të reja".

"Këta (LDK v.j.) nuk e kanë bërë. Këta kanë mendu ose të hyjnë drejtpërdrejt me një rrugë te re duke mohu rrugën e vjetër që në momentet më delikate kur kanë dasht me i kërku votat kanë rrëshqit me ndonjë slogan", ka thënë Ramosaj, duke vlerësuar se udhëheqja e LDK-së është "rob i një shkolle të caktuar politike, që politikën e mendon ekzistenciale e që nuk është model i Rugovizmit".

*vijon në faqen e dytë*



**New York, 5 janar - Presidenti i rrëzuar i Venezuelës, Nicolas Maduro, të hënën është deklaruar i pafajshëm në paraqitjen e tij të parë para një gjykate në Nju-Jork. I veshur me uniformë të burgut, Maduro ka dalë para gjykatës për t'u përballur me akuzat për narko-terrorizëm. Po ashtu, gjatë deklaratës së tij në gjykatore, Maduro ka thënë se ende është president i Venezuelës. Për këtë çështje, po në Nju-Jork, të hënën është mbajtur edhe një mbledhje Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ku shtetet anëtare kanë shprehur pikëpamje të ndryshme për operacionin amerikan në Venezuelë, që ka çuar në kapjen e Maduros dhe bashkëshortes së tij**

KËSHILLI GJYQËSOR KA PUBLIKUAR AKTGJYKIMET E VITIT 2025

# 7 mësimdhënës e 7 zyrtarë policorë u dënuan për keqtrajtim gjatë detyrës zyrtare

**Ardit Kika**

PRISHTINË, 5 JANAR - Mësimdhënësit dhe zyrtarët policorë janë ata të cilët janë dënuar më shumë për veprën penale "Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike" në bazë të aktgjykimeve të publikuara në vitin 2025.

Nga 13 aktgjykimet në faqen e Këshillit Gjyqësor për vitin 2025, 9 ishin për mësimdhënës, një për drejtor shkolle, ndërsa tri aktgjykime ku përfshihen 7 zyrtarë policorë kanë të bëjnë me keqtrajtim.

Prej tyre, në katër raste mësimdhënësit janë liruar ose janë dënuar me burgim me kusht.

"E shtyu me forcë dhe tentoi ta godiste përsëri (Gjilan) – u lirua pasi viktima tha se nuk u frikësua. Mësimdhënësi u lirua pasi nuk u mor në pyetje në prani të avokatit (Mitrovicë). Sulmoi fizikisht nxënësin (Dragash) – 10 muaj dënim me kusht. Goditi me të dy duart në kokë dhe trup nxënësin e klasës IX (Rahovec) – me kusht", janë dënimet me kusht të shqiptuara për mësimdhënësit gjatë vitit 2025.

Keqtrajtimi gjatë detyrës zyrtare ndaj fëmijëve në bazë të Kodit Penal dënohet me gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim.

Megjithatë, dënimi më i lartë i shqiptuar nga pesë rastet e dënuara me gjobë ishte 3.000 euro - ndaj mësimdhënësit të dhunshëm në Krushë të Prizrenit.

"Goditi nxënësen 13 vjeç me shuplaka, e kapi për fyti (Prizren) – 3.000 euro. Goditi mbrapa koke dhe e kapi për veshi (Lipjan – drejtor shkolle) – 500 euro gjobë. Goditi me shuplaka dy nxënës (Malishevë) – 800 euro gjobë. Sulmoi nxënësin me shuplakë në fytyrë (Prizren) – 800 euro. E qëllon me shuplakë në fytyrë (Suharekë) – 600 euro gjobë. E shtyu dhe goditi me shuplakë në fytyrë (Suharekë) – 350 gjobë", janë gjobat e shqiptuara nga gjykatat për mësimdhënësit gjatë vitit që shkoi.

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Rrahman Jasharaj, pavarësisht statistikave, nuk u beson shumë atyre.

"Nuk dua të besoj se punëtorët e arsimit qenkan të parët për ushtrim dhune. Mund të ketë raste të ndara, por SBASHK-u e dënon çdo dhunë të ushtruar, qoftë nga nxënësit, qoftë nga mësimdhënësit, qoftë nga prindërit... Nuk mund të besoj se jemi të parët në Kosovë për ushtrim dhune, sepse po të ishte kështu, këto do të ishin edhe raste të njohura për SBASHK-un", ka thënë Jasharaj.

*vijon në faqen e dytë*

## Drama me drejtorin e Teatrit Kombëtar: Komision disiplinor, paralajmërim për dorëheqje, pezullim, dorëheqje



Me alamet drame Kushtrim Sheremeti ia kishte dalë që të ulet në karrigen e drejtuesit të institucionit më të lartë teatror në vend para gati katër vjetësh. Një tjetër dramë është zhvilluar në ditët e fundit të dhjetorit deri me epilogun datës 31 dhjetor kur është pezulluar dhe ka dhënë dorëheqje...


*Faqe 12*

NUMËRIMI I VOTAVE TË ZGJEDHJEVE TË 28 DHJETORIT PO SHKON DREJT FUNDIT

# KQZ-ja pret që rezultatet të shpallen më herët sesa ka parashikuar

**Rreth 20 mijë pako me fletëvotime janë tërhequr të hënën nga kutitë postare jashtë Kosovës dhe pritet që gjatë ditëve në vijim të arrijnë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Këto fletëvotime i takojnë votimit me postë dhe janë të fundit. Më herët janë tërhequr shumë të tjera. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë shprehur pritshmërinë që numërimi i të gjitha votave të përfundojë gjatë kësaj jave**

**Rrezon Gashi**



PRISHTINË, 5 JANAR - Në Komisionin Qendror Zgjedhor kanë shprehur pritshmërinë që procesi i numërimit të të gjitha votave të zgjedhjeve të 28 dhjetorit të përfundojë brenda kësaj jave.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka njoftuar se edhe numërimi i votave me kusht do të fillojë së shpejti.

"Të gjitha përpjekjet e KQZ-së janë që numërimi i fletëvotimeve të mbetura, nga jashtë Kosovës – përmes postës, i fletëvotimeve nga votimi me kusht dhe i fletëvotimeve nga votimi i personave me nevoja të veçanta të përfundojë gjatë kësaj jave", ka thënë Elezi të hënën.

Për votim me postë nga jashtë vendit kanë aplikuar 58 mijë persona. Deri tash janë numëruar shumica e 28 mijë votave që janë tërhequr para natës së Vitit të Ri nga kutitë postare në Berlin të Gjermanisë dhe në Bernë të Zvicrës.

"Ndërkaq, më 2 janar, nga kutitë postare në Pragë, Londër, Paris, Zagreb, Stokholm, Stamboll, New York, Kanbera dhe Kopenhagë, janë tërhequr 8,180 pako të tjera me fletëvotime, të cilat gjatë ditës do të arrijnë në Kosovë", ka thënë ai.

Këto vota kanë mbërritur pasditen e së hënës, por fillimisht do t'i nënshtrohen procesit të verifikimit e më pas do të numërohen.

Po ashtu gjatë ditës së hënë edhe rreth 20 mijë pako të tjera me fletëvotime janë tërhequr nga kutitë postare jashtë Kosovës dhe pritet që gjatë javës të mbërrijnë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve dhe të verifikohen e të numërohen.

Përfundimi i numërimit të votave i hap rrugë shpalljes së rezultateve përfundimtare.

Sipas zëdhënësit të KQZ-së, Valmir Elezi, në planin e veprimit është paraparë që kjo të ndodhë më 19 janar, por me dinamikën aktuale të punës ekziston mundësia që rezultatet të shpallen më herët.

"Në planifikimet e KQZ-së, përfundimi i aktiviteteve në QKN është paraparë të bëhet deri më 7 janar, por kjo është arritur në mesditën e 3 janarit. Numërimi i votave nga votimi në përfaqësitë diplomatike dhe nga votimi me postë ishte planifikuar të bëhet nga data 7 janar, por ka përfunduar më 3 janar. Gjithashtu, edhe numërimi i votave me kusht dhe votave të personave me nevoja të veçanta ishte planifikuar të fillonte më 16 janar, por sipas planifikimeve kjo mund të fillojë gjatë ditës së sotme (e hënë v.j.). Nga kjo mund të përfundojmë se edhe rezultatet përfundimtare të planifikuara për t'u shpallur më së largu deri më 19 janar, mund të shpallen shumë më herët", ka thënë ai.

Elezi nuk ka dhënë një datë të saktë, duke theksuar se afatet varen edhe nga ankesat eventuale që mund të dorëzohen në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe në Gjykatën Supreme lidhur me procesin e numërimit.

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, subjektet politike kanë sërish të drejtë ankese në të dyja këto institucione.

Vetëm pas përfundimit të këtij procesi bëhet certifikimi i rezultateve zgjedhore, ndërsa sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të marrë në qershor të vitit të kaluar, Kuvendi obligohet të konstituohet brenda 30 ditëve nga dita e certifikimit të rezultateve.

© KOHA Ditore

NJË JAVË PAS ZGJEDHJEVE ENDE "NUK KA REFLEKTIM" NGA PARTITË POLITIKE QË SHËNUAN RËNIE NË ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

# Partitë opozitare heshtin lidhur me reformat e premtuara pas humbjes në zgjedhje

**Një javë nga zgjedhjet e 28 dhjetorit, nga partitë opozitare ende nuk ka lëvizje në drejtim të zotimit të dhënë, atë për reforma. Në PDK e LDK nuk kanë treguar se kur do t'i zyrtarizojnë zgjedhjet e brendshme. E njohës të zhvillimeve politike vlerësojnë se ndryshimet duhet të jenë të mëdha, e jo vetëm të udhëheqësve**

*vijon nga ballina*

"Unë mendoj që kombinimet duhet të ndodhin, midis të vjetrës dhe të rejës, pa mohuar kontributin e të vjetrit, por jo me çdo kusht ata që janë të rinj në moshë ndërtojnë edhe politikë të re", ka thënë ai.

E politologu Melazim Koci ka vlerësuar se LDK-ja me rënien e shënuar ka paguar gabimin që ka bërë, duke mos hyrë në koalicion me Lëvizjen Vetëvendosje.

"Nuk e përjashtoj mundësinë që është perceptuar fakti se nuk kanë hyrë në koalicion me Vetëvendosjen, të jetë perceptuar nga opinioni si faj i tyre, ndryshe nuk di ta shpjegoj këtë rënie kaq të madhe të LDK-së", ka thënë ai.

Për dallim nga PDK-ja, LDK-ja e AAK-ja, rezultat më të mirë se në zgjedhjet e 9 shkurtit, ka shënuar Lëvizja Vetëvendosje. Nga rezultatet e deritanishme, VV-ja ka gati 70 mijë vota më shumë.

Sipas profesorit Ramosaj, në fitoren e Vetëvendosjes ka ndikuar edhe pamundësia që partitë opozitare ta ndjekin atë në tema të interesit nacional, fajësimi i opozitës për ngërçin politik e lodhja e qytetarëve nga mungesa e institucioneve.

"Kjo narrativa e problemit të shtetndërtimit, që është kamufluar edhe me elementet e nacionalizmit, respektivisht identitetit nacional të shqiptarëve dhe të Kosovës për të ruajtur kufijtë sovran, respektivisht edhe integritetin faktikisht mendoj që i kanë dhënë një premisë pozitive partisë në pushtet që kanë luajtur mirë me ndjenjat nacionaliste të shumë shqiptarëve qoftë që jetojnë në Kosovë, qoftë jashtë saj. Ky është një ndër elementet kyç", ka deklaruar njohësi i zhvillimeve politike, Berim Ramosaj.

Kurse politologu Koci konsideron se edhe mosvotimi i të mandatuarit të dytë për kryeministër, Glauk Konjufca, ka ndikuar në rezultatin e thellë të Lëvizjes Vetëvendosje e në rënien e atij të partive opozitare.

"Mendoj që ka qenë gabim shumë i rëndë. Votimi i qeverisë së pakicës, të z. Konjufca ishte në favorin e opozitës, sepse në këtë mënyrë dërgonin tek opinioni sinjal se janë konstruktiv, se janë të gatshëm për bashkëpunim dhe se janë për tejkalimin e ngërçit dhe përfitonin edhe diçka tjetër, shtynin zgjedhjet për marsin e këtij viti dhe eliminonin votën e diasporës, e cila gati në tërësi, bindshëm ka anuar nga Lëvizja Vetëvendosje", ka thënë Koci.

Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, një ditë më parë, duke iu referuar mungesës së votave për të zgjedhur presidentin në mars të këtij viti, nuk ka hedhur poshtë mundësinë e zgjedhjeve të reja.

Për zgjedhjen e presidentit në dy raundet e para duhen 80 vota për, e në raundin e tretë mjaftojnë 61 vota për, me kushtin që në sallë të jenë 80 deputetë.

© KOHA Ditore

KËSHILLI GJYQËSOR KA PUBLIKUAR AKTGJYKIMET E VITIT 2025

# 7 mësimdhënës e 7 zyrtarë policorë u dënuan për keqtrajtim gjatë detyrës zyrtare

**Shumica e aktgjykimeve për veprën penale "Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike" gjatë vitit 2025 ishin për mësimdhënësit. Por sipas këtyre statistikave, numri i të dënuarve është i barabartë, sa mësues aq zyrtarë policorë për këtë vepër penale. Në Institutin për Avokimin e Politikave Korrektuese vlerësojnë se mësimdhënësit janë më lehtë të ndëshkueshëm sesa policët**

*vijon nga ballina*

Alban Muriqi, drejtor i Institutit për Avokimin e Politikave Korrektuese, vlerëson se mësimdhënësit janë më lehtë të ndëshkueshëm sesa policët.

"Nëse ka më shumë aktgjykime ndaj mësimdhënësve, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se mësimdhënësit keqtrajtojnë në shkallë më të gjerë, por janë më lehtë të ndëshkueshëm – rastet e tyre janë më të thjeshta ose të lehta për t'u proceduar dhe nuk prekin struktura ose autoritete me ndikim brenda infrastrukturës shtetërore", ka thënë Muriqi.

Sipas tij, institucionet duhet të punojnë shumë në mënyrë që të luftohet mosndëshkimi i keqtrajtimit.

"Së pari, dhuna nga ana e PK-së në shume raste shihet si diçka që po normalizohet dhe ekziston një kulturë në rritje e pandëshkueshmerisë; mandej shkalla e ulët e denoncimit që kryesisht vjen si pasojë e mungesës së besimit dhe në një masë bashkëpunimit qytetar-Polici; mediat dhe opinioni i trajtojnë vetëm në raste më ekstreme. Prokuroria dhe gjykata më pak priren të hetojnë dhe gjykojnë pjesëtarët e Policisë së Kosovës për shkeljet e tyre, dhe së fundi kemi mungesë të sanksionimit që nxit kulturën e mosndëshkimit në radhët e PK-së", ka deklaruar ai.

E të dënuar me burgim gjatë 2025-tës janë tre policët nga Shtimja: Adnan Ramadani, Afrim Rexhepi dhe Mehmet Beqaj, të cilëve iu vulos dënimi me nga një vit burg edhe nga Gjykata Supreme.

Në tri aktgjykimet e tjera për policët, Apeli në një rast e ka konfirmuar dënimin e tre policëve me nga 450 euro, kurse një tjetri me 3 mijë euro.

Policia e as Inspektorati Policor nuk janë përgjigjur në pyetjet e KOHËS, në të cilat i është kërkuar koment lidhur me këtë çështje.

Gjatë vitit 2025, IPK-ja i ka çuar 110 kallëzime penale në prokurori e një pjesë e tyre ka qenë për keqtrajtim.

© KOHA Ditore

DEPUTETI SHQIPTAR NË PARLAMENTIN E SERBISË, SHAIP KAMBERI, E KA VLERËSUAR TË THELLË KRIZËN NË KËTË VEND

# Kamberi: Viti 2026 mund të shënojë fundin e pushtetit të Vuçiqit

**Sipas Kamberit, 2026-a është vit i zgjedhjeve në Serbi dhe ato mund të shënojnë fundin e pushtetit të Aleksandar Vuçiqit. Ai ka thënë se Vuçiqi po mbijeton me "frymëmarrje artificiale". Po ashtu ka kërkuar nga Qeveria e ardhshme e Kosovës që Luginën e Preshevës ta shpallë çështje me rëndësi kombëtare**



PRISHTINË, 5 JANAR - Deputeti shqiptar në Parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka thënë se presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, po mbijeton në pushtet me "frymëmarrje artificiale". Sipas Kamberit, 2026-a është vit i zgjedhjeve në Serbi dhe ato mund të shënojnë fundin e pushtetit të Vuçiqit.

"Ndërkohë që duke qenë u përballur me krizën e brendshme, Vuçiq aktualisht po përballet edhe me krizën e jashtme. Dhe me shumë gjasë viti 2026 do të jetë vit i zgjedhjeve në Serbi. Zgjedhje që, siç paralajmëron ai, do të jenë udhëkryq, por me shumë gjasë Vuçiq në këto zgjedhje do të humbë pushtetin. Për të bile, sipas vlerësimit tim, do të jetë edhe më e vështirë nëse arrin t'i fitojë zgjedhjet me manipulimet e zakonshme që i ka bërë deri më tani dhe kjo do të na sjellë në një situatë ku askush, as opozita, as Lëvizja Studentore, as segmentet e tjera të shoqërisë nuk do t'ia njohin ato zgjedhje. Ky është një hap që Serbinë do ta futë në një krizë edhe më të thellë. Nuk mund të themi se do të ketë një stabilitet as në vitin 2026 dhe kjo natyrisht flet qartë se Serbia nuk do të ketë edhe kohë, edhe mundësi të merret me procesin e integrimeve", ka thënë ai.

Sipas Kamberit, Vuçiqi e ka futur Serbinë në një krizë të thellë politike e cila është më e rënda që prej vitit 2003 kur është vrarë kryeministri i atëhershëm serb, Zoran Gjingjiq.

Gjithashtu ai ka thënë se edhe në raport me politikën e jashtme, Vuçiqi ka pësuar degradim total.

"Shumëkush ka pritur që me një vit protestash, pushteti i Aleksandar Vuçiqit do të bjerë. Por, thjesht ai po mbahet, po mbijeton. Po mbijeton me një frymëmarrje artificiale, me atë që e ka futur Serbinë në një krizë ndër më të thellat politike prej vitit 2003 kur është vrarë kryeministri i atëhershëm. Është bërë një delegjitimim total i pushtetit të Vuçiqit, se këto që po ndodhin ditëve të fundit po dëshmojnë që politika e jashtme e Vuçiqit, e balancimit, e ekuilibrimit, e bazuar në katër shtylla, në Kinë, në Moskë, në Uashington e Bruksel, po pëson degradim total, sepse tashmë mund të thuhet shumë konkret pas aprovimit të Raportit të Progresit për Serbinë për vitin 2025, Bashkimi Evropian ka dhënë vërejtjet më seriozet deri më tani, në raport me ngecjen e Serbisë. Se ligji që aprovuan së fundmi Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe që ka nënshkruar presidenti Trump flet qartë për ngecjet në demokraci në Serbi. Dhe Serbia etiketohet si i vetmi vend në Ballkan me emër që ka ngecje të demokracisë", ka deklaruar Kamberi.

Kamberi ka kërkuar nga Qeveria e ardhshme e Kosovës që të shpallë Luginën e Preshevës çështje me rëndësi kombëtare.

Gjatë vitit të kaluar, deputeti i vetëm shqiptar në Parlamentin e Serbisë thotë se ka bërë disa propozime për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të pakicave. Ai ka përmendur kërkesën që Presheva e Bujanoci të kenë një prokurori, sepse aktualisht është në Vranjë, por gjithashtu edhe Gjykatën e Apelit. Të gjitha këto, ai thotë se nuk janë përfillur nga institucionet në Serbi.

"Parlamenti për vite me radhë, sidomos në këta pesë vjetët e fundit është një ambient toksik. Një ambient në të cilin shumicën absolute e kanë, e ka Vuçiqi me partitë e tij satelite, duke mos përjashtuar SPS-in dhe disa parti të vogla të tjera, ka arritur t'i bindë edhe disa pakica siç janë hungarezët dhe një pjesë e boshnjakëve që ta mbajnë në anën e tij. Dhe në kuadër të asaj mundësie, bashkë me deputetët e SDA-së ose vetë si deputet kam nisur disa iniciativa që janë të rëndësishme, por që mjerisht nuk po hasin në mirëkuptim në Beogradin zyrtar. Në radhë të parë, jo vetëm për t'iu krijuar shqiptarëve hapësirë më të mirë të veprimit, të drejta, por edhe për të përshpejtuar procesin e integrimit të Serbisë në Bashkimin Evropian. Por duket se Serbia nuk është akoma e gatshme të marrë hapat gjigantë drejt anëtarësimit në BE, sepse ajo vetë po i prolongon", është shprehur ai.

Ai ka paralajmëruar se për shkak të mosrekrutimit të shqiptarëve në polici që nga viti 2016, Lugina e Preshevës rrezikon të mbetet pa policë shqiptarë në dekadën e ardhshme.

"Ne kemi një situatë ku Kosova si shteti më i ri, si demokracia më e re në Ballkanin Perëndimor për pakicat atje ofron standarde që nuk i ka asnjë shtet, jo vetëm i Ballkanit, por mund të them lirisht edhe shumë shtete në Evropë nuk i kanë këto standarde. Ndërkohë që duke kërkuar për serbët diçka që nuk është e gatshme t'ua japë pakicave brenda territorit të vet, Serbia luan sa i përket sferës së të drejtave të pakicave, me standarde të dyfishta dhe kjo duhet të ndërpritet. Ne nuk mund të pajtohemi me Beogradin, vetëm të financojë ndonjë projekt infrastrukturor, ndërkohë që të heshtim sa i përket përfaqësimit tonë në gjykatë, në polici, sepse ne e dimë çfarë solli situata kur në Polici kishte pak ose aspak shqiptarë. Me trendin aktual, duke marrë parasysh që Ministria e Punëve të Brendshme nuk rekruton shqiptarë në policinë lokale prej vitit 2016, ne për dhjetë vjetët e ardhshëm do të mbesim pa policë shqiptarë këtu. Dhe kjo na kthen me automatizëm në situatën 1999-2000, ku nuk kishte policë shqiptarë", ka deklaruar Kamberi.

Në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë gjatë vitit 2024 janë organizuar tri protesta gjithëpopullore me thirrjet "Kthema adresën" dhe kundër veprimeve diskriminuese të autoriteteve të Serbisë ndaj shqiptarëve. Autoritetet serbe kanë pasivizuar me mijëra adresa të shqiptarëve në Luginë.

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2022, mbi 60 mijë shqiptarë jetojnë në Serbi./Ksp

© KOHA Ditore

AUTORITETET E KOSOVËS U KUNDËRPËRGJIGJEN AKUZAVE TË PRESIDENTIT TË SERBISË, ALEKSANDAR VUÇIQ

# Gërvalla: Askush nuk e kërcënon Serbinë, rreziku vjen nga udhëheqësit e saj

**Ministrja në detyrë Donika Gërvalla ka thënë se presidenti serb ka shpallur rendin botëror të vdekur dhe ka paralajmëruar dyfishimin e investimeve në ushtrinë e Serbisë, duke e cilësuar këtë mesazh si të qartë. Ajo ka theksuar se Serbia nuk po kërcënohet nga askush, por se kërcënimi i vërtetë qëndron te vetë lidershipi i saj**

PRISHTINË, 5 JANAR - Ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, ka reaguar ndaj deklaratave të fundit të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq duke theksuar se për të kuptuar qëllimet e Rusisë në rajon, është e domosdoshme të vëzhgohen veprimet e Serbisë.

Sipas saj, Serbia nuk ka një politikë të jashtme të ndryshme nga ajo e Moskës.

Gërvalla ka thënë se presidenti serb ka shpallur rendin botëror të vdekur dhe ka paralajmëruar dyfishimin e investimeve në ushtrinë e Serbisë, duke e cilësuar këtë mesazh si të qartë dhe të drejtuar si për Rusinë, ashtu edhe nga Rusia.

Ajo ka theksuar se Serbia nuk po kërcënohet nga askush, por se kërcënimi i vërtetë qëndron te vetë lidershipi i saj.

"Në vend që të ndërtojë një shtet normal evropian të përqendruar në reformat dhe vlerat demokratike të Bashkimit Evropian, udhëheqja serbe vazhdon të ëndërrojë një perandori rajonale, duke reflektuar një mentalitet rus në miniaturë", ka shkruar ajo.

Po ashtu, ajo ka thënë se nëse ndodh, atëherë nuk do të ishte hera e parë që Serbia kontribuon në destabilizimin e Evropës.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, të dielën, por edhe të hënën, ka thënë se intervenimi i SHBA-së në Venezuelë, ku është kapur presidenti Nicolas Maduro, është shkelje e rendit botëror dhe politikë e të fortëve. Po ashtu, ai ka thënë se për Serbinë është shqetësuese pse Forca e Sigurisë e Kosovës po forcohet dita-ditës. Ka folur edhe për aleancën Kosovë-Shqipëri-Kroaci, e cila sipas tij, ka synim ta sulmojë Serbinë.

© KOHA Ditore

FESTA E NDËRRIMIT TË MOTEVE PËRCILLET ME PASOJA

# Gjashtë pacientë po trajtohen në Kirurgjinë Plastike pas lëndimeve me mjete piroteknike

**Shumica e të lënduarve janë fëmijë dhe adoleshentë, ndërsa disa raste kanë rezultuar me dëmtime serioze të duarve dhe fytyrës, që kërkojnë ndërhyrje të specializuar dhe mund të lënë pasoja afatgjata**

**Sanie Jusufi**

PRISHTINË, 5 JANAR - Gjashtë pacientë janë hospitalizuar në Klinikën e Kirurgjisë Plastike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, pas lëndimeve të marra nga përdorimi i mjeteve piroteknike gjatë festave të fundvitit.

Nga Shërbimi Spitalor Universitar kanë bërë të ditur se pjesa me e madhe e të lënduarve janë fëmijë dhe adoleshentë.

"Rastet e trajtuara në këtë klinikë kanë qenë kryesisht lëndime të duarve, veçanërisht të gishtërinjve, të cilat në disa raste kanë përfunduar me amputime të pjesshme apo të plota, si dhe me dëmtime serioze funksionale të aparatit tendinoz (tendinave te gishtërinjve të duarve). Po ashtu, janë regjistruar edhe lëndime në regjionin e fytyrës, të cilat kërkojnë trajtim të specializuar dhe mund të lënë pasoja estetike dhe funksionale afatgjata", thuhet në njoftimin e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës.

Në natën e ndërrimit të moteve, 53 persona kanë kërkuar trajtim mjekësor në Klinikën Emergjente të QKUK-së, si pasojë e lëndimeve nga përdorimi i mjeteve piroteknike dhe nga plumbat qorr.

Dy të tjerë kanë pësuar plagë nga plumbat qorr, ndërsa mjekët paralajmërojnë për pasoja të rënda dhe invaliditet të përhershëm në disa raste.

E nga Klinika e Kirurgjisë Plastike u kanë bërë thirrje prindërve, kujdestarëve dhe institucioneve përkatëse që të rrisin kontrollin dhe ndërgjegjësimin lidhur me rreziqet e përdorimit të mjeteve piroteknike, veçanërisht nga fëmijët.

Në Policinë e Kosovës kanë bërë të ditur se kanë iniciuar dhe do të vazhdojnë t'i trajtojnë të gjitha rastet, qofshin vepra penale apo incidente, dhe në koordinim me prokuroritë kompetente ato do t'u përcillen organeve të drejtësisë.

© KOHA Ditore

SHTATË AKTAKUZA PËR SPIUNAZH NGA PROKURORIA SPECIALE NË VITIN 2025

# Vit i mbrapshtë për spiunët

**Viti 2025 shënoi dënimin e parë mbi akuzat për spiunazh me pranim fajësie. Shtatë persona u ndeshën me ligjin shkaku i pretendimeve të Prokurorisë Speciale se janë spiunë që i shërbyen Serbisë. Ekspertët vlerësojnë se viti i ardhshëm do të jetë vit i nxehtë në kuptimin e sigurisë, andaj nuk përjashtohet që rreziku nga spiunazhi të jetë i madh**

**Ardit Kika**



PRISHTINË, 5 JANAR - Shtetasi i Kosovës, Milan Vukashinoviq, për më shumë se pesë vjet kishte shmangur udhëtimet në Serbi për shkak të frikës për sigurinë e tij. Ai nuk i bindej Listës Serbe, parti me lidhje të drejtpërdrejta me Beogradin. Megjithatë, më 1 nëntor Vukashinoviqi udhëtoi drejt fshatit Jellakcë, pranë kufirit me Serbinë, ku dyshohet se ra në një kurth.

Atje ai u rrëmbye nga persona të panjohur dhe u qëllua me breshëri plumbash, në rrethana që po hetohen nga autoritetet e Kosovës. Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka konfirmuar se është duke zhvilluar hetime për tentativë vrasje, ndërsa Prokuroria e Lartë në Krushevc nuk ka bërë të ditur nëse ndaj Vukashinoviqit po zhvillohet ndonjë hetim për spiunazh.

Emri i tij ishte përmendur më herët nga Aleksandar Vllajiq, personi i parë i dënuar për spiunazh në Kosovë. Në komunikimet e tij me Agjencinë e Inteligjencës së Sigurisë së Serbisë (BIA), Vllajiq e kishte cilësuar Vukashinoviqin si "bashkëpunëtor shumëvjeçar të shërbimeve të Kosovës".

Viti i kaluar shënoi zhvillime të rëndësishme në luftën kundër spiunazhit në Kosovë: u ngritën shtatë aktakuzat a para për këtë vepër penale, u shqiptua dënimi i parë dhe u arrestua një person i dyshuar për bashkëpunim me Agjencinë e Inteligjencës Ushtarake të Serbisë.

Ish-kryeinspektori i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Shkëlzen Sopjani, thotë se Serbia ka për synim minimin e shtetësisë së Kosovës dhe ka ndërmarrë veprime konkrete në këtë drejtim edhe vitet e fundit. Sipas tij, numri i arrestimeve për spiunazh nuk është befasues, duke marrë parasysh rrethanat e sigurisë.

"Arrestimet nuk janë për t'u çuditur, kur merret parasysh volumi i veprimeve që ndodhin në Republikën e Kosovës. Sidomos kur këtyre u shtohen zhvillimet në veri, si rasti i Banjskës apo sulmi ndaj kanalit të Ibër-Lepencit", thotë Sopjani.

Edhe Mentori Vrajolli, drejtor i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, vlerëson se institucionet e Kosovës për një kohë të gjatë nuk e kanë konsideruar spiunazhin serb si kërcënim serioz për sigurinë kombëtare.

"Spiunazhi nuk është trajtuar si rrezik i madh, pasi ka pasur struktura të tëra që janë paguar drejtpërdrejt nga shteti serb. Kjo ka krijuar një logjistikë shumë të gjerë, e cila për një kohë të gjatë është toleruar", thekson Vrajolli

## Edhe organizatat kyç ndërkombëtare të sigurisë u cenuan nga spiunazhi

Ish-polic i Kosovës, Aleksandar Vllajiq, u arrestua në qershor të 2022-tës. Atëkohë dyshohej për sulmin në zyrën e Komisionit Komunal Zgjedhor të Mitrovicës së Veriut. Vllajiqi është dënuar në shkallë të parë për sulmin terrorist që kishte për synim t'i detyronte institucionet në Kosovë të mos i mbanin zgjedhjet që i planifikuan për katër komunat në veri të Ibrit. Vllajiq u dënua edhe më pesë vjet burgim për spiunazh pasi pranoi fajësinë.

Rasti i të dënuarit të parë për spiunazh shpalosi se BIA përmes spiunëve pati qasje, jo vetëm tek informata të klasifikuara të AKI-së dhe Policisë së Kosovës, por edhe të dhënat e organizatave kyç të sigurisë si misioni i NATO-s në Kosovë (KFOR), Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX), si dhe Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Në aktakuzën ndaj Vllajiqit përmendet se për informata në EULEX ai shfrytëzonte personin me emrin Martin, ndërsa për KFOR dyshohet se shfrytëzoi personin me emrin Nikita dhe në OSBE, Jelena Gjukanoviq. Këto institucione nuk kanë dhënë detaje lidhur me atë se a kanë ndonjë hetim të brendshëm sa u përket këtyre personave, por OSBE-ja ka bërë të ditur se Gjukanoviq është në pushim të detyrueshëm administrativ deri në vendosjen e rastit nga gjykata.

"Misioni i OSBE-së në Kosovë e respekton plotësisht pavarësinë e institucioneve të drejtësisë së Kosovës dhe vazhdon të jetë e përkushtuar në bashkëpunim me to në përputhje me mandatin e saj", ka shtuar OSBE-ja.

E ish-kryeinspektori Sopjani thotë se organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë janë vend i përshtatshëm për kamuflim të agjentëve.

"Në veçanti Kosova është një terren interesant për këtë fushë, për shkak se mundësitë për ta kryer këtë veprimtari janë më të mëdha për shkak edhe të mundësive të kamuflimit që i kanë, qoftë përmes organizatave jo-qeveritare, qoftë përmes edhe organizatave ndërkombëtare që operojnë në Republikën e Kosovës, që kemi disa prej tyre që edhe nuk e njohin zyrtarisht pavarësinë apo shtetësinë e Republikës së Kosovës", thotë Sopjani.

Prokuroria Speciale, përveç Vllajiqit, që është duke vuajtur dënimin, i akuzon edhe shtatë persona të tjerë për spiunazh. Gjashtë të akuzuarit si bashkëpunëtorë të BIA-s janë:, Hysri Selimi i cili është i dënuari edhe për terrorizëm, togeri i Policisë së Kosovës, Bojan Jevtiq (i dyshuar), ish-polici Muharrem Qerimi, ish-doganieri Bedri Shabani, punëtorja e OSBE-së, Jelena Gjukanoviq, ish-drejtuesi i organizatës "Instituti për Avancimin e Marrëdhënieve Ndëretnike", Fatmir Sheholli, i cili ishte edhe ish-anëtar i sigurimit të shtetit të Serbisë gjatë viteve '90.

Në bazë të aktakuzave të Prokurorisë Speciale të Kosovës, personat që akuzohen si spiunë të Serbisë, ndër të tjera, i dërgojnë informata këtij shteti lidhur me vehabistët, identitetet e zyrtarëve të AKI-së, vendet ku ka policë, hetimet për krimin e organizuar dhe personat e dyshuar për krim të organizuar, si dhe identitetet e pjesëtarëve të UÇK-së me qëllim të ndërtimit të narrativës së rreme për një rrjet trafikimi organesh nga UÇK-ja që shtrihet nga Kosova në Shqipëri.

## Strategjia e Serbisë

Gjatë dy vjetëve të kaluar edhe Serbia ka bërë arrestime për spiunazh. Në bazë të raportimeve të publikuara në mediat serbe, për spiunazh në favor të Shërbimit Informativ të Shqipërisë (SHISH) dhe Agjencisë Kosovare për Inteligjencë (AKI), nga janari i 2024-s janë arrestuar katër persona: D.R (dyshohet se filmoi ushtrinë serbe në Rashkë), A.D (dyshohet se i ndihmoi D.R), P.M dhe Sasha Gjorgjeiviq u arrestuan pasi dyshohet se ua shpalosën identitetet pjesëtarëve të BIA-s, ushtrisë dhe MUP-it të Serbisë.

Prokuroria në Prokuple e ka konfirmuar se ka ngritur aktakuzë kundër Sasha Gjorgjeviqit nga Komuna e Shtërpcës për spiunazh, ndërsa Prokuroria në Jagodinë (ku ka qenë duke u hetuar rasti i D.R, A.D dhe P.M) nuk janë përgjigjur në pyetjet e redaksisë.

Ish-kryeinspektori Shkëlzen Sopjani vlerëson se arrestimet e atyre që janë akuzuar si spiunë të Kosovës e Shqipërisë në Serbi janë bërë për efekt propagandistik.

"Në Serbi me sa kam parë, kam goxha bindje se nuk ka ndonjë element përveç një konsumi publik që e kanë bërë dhe ata shpesh dinë t'i bëjnë ato gjëra për konsum të brendshëm publik – të tregojnë se po bëjnë diçka e kështu me radhë, që edhe kur nuk e kanë armik gjithmonë, ta shpikin një armik", thotë Sopjani.

Ai ka folur edhe për rrezikun që kosovarët kanë kur kalojnë përmes Serbisë . Kalimi apo qëndrimi i zyrtarëve shtetërorë në Serbi, sipas ish-kryeinspektorit të AKI-së, Shkëlzen Sopjani, nuk i rrezikon vetëm zyrtarët, por edhe shtetin.

Përmes transportit rrugor, rruga nga shtetet e Evropës qendrore e veriore në Kosovë është më e shkurtër kah Serbia, por, BIA vazhdimisht ka ndaluar shtetasit e Kosovës e të cilët janë akuzuar për vepra penale kundër rendit kushtetues

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës u ka bërë thirrje të vazhdueshme qytetarëve që ta shmangin kalimin në Serbi. Serbia ka arrestuar edhe ish-pjesëtarë të institucioneve të sigurisë së Kosovës duke pretenduar për vepra të ndryshme penale, siç është ajo kundër rendit kushtetues.

Arbnor Spahiu, ish-polic i Kosovës, u mbajt në paraburgim nga qershori deri në nëntor kinse për vepra antikushtetuese që lidhen me vrasjen e pjesëtarëve të grupit në sulmin në Banjskë.

"Nuk duhet të presin ata dhembshuri prej Republikës së Kosovës kur arrestohen prej Serbisë, por ata duhet ta kenë parasysh se ata e kanë bërë gabimin, se ata e kanë bërë lëshimin, se ata kanë qenë të pakujdesshëm. Një pakujdesi e tyre, përveçqë e cenon lirinë e tyre, mund ta cenojë edhe integritetin e institucionit të cilit e përfaqësojnë", thotë Sopjani.

Aktakuza në të cilën e ka pranuar fajësinë Vllajiqi tregon edhe për pasojat që i ka pasur spiunazhi i tij te serbët të cilëve ua ka përmendur emrat. Në këtë dokument thuhet se disa shtetas të Kosovës që Vllajiqi ia ka përmendur BIA-s, i ka rekrutuar Serbia. Paraprakisht, sipas Prokurorisë Speciale, ata janë ndaluar në Serbi.

"Veprimet në mbështetje të këtij bashkëpunimi spiunazhi përfshijnë, por nuk kufizohen në:..4. Targetimi i individëve të ndryshëm, kryesisht serbë, të punësuar në organizata ndërkombëtare në Kosovë, si bashkëpunëtorë të shërbimeve të huaja të inteligjencës në Kosovë, të cilët më pas, gjatë vizitave në Serbi, janë ndaluar, intervistuar, shantazhuar dhe rekrutuar nga BIA, për të punuar më pas në favor të tyre", thuhet në aktakuzë.

Por ndjekja e spiunazhit penalisht në Kosovë është më e lehtë, sipas drejtorit të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, Mentor Vrajolli, meqë Kosova i ka tkurrur strukturat e sigurisë së Serbisë në veri të vendit dhe meqë tash nuk ka zyrtarë policorë që marrin paga nga Kosova dhe Serbia njëherësh.

Sipas tij, shteti duhet t'u japë mbrojtje të gjithë zyrtarëve të saj shtetërorë, në mënyrë që të mos ndodhin dorëheqjet si ato në FSK më 2018-n apo në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë më 2022-tën.

"Këto struktura kishin bërë presione të ndryshme te këta persona që pa dashjen e tyre ishin detyruar që të tërhiqeshin për shkak të një morie të metodave që kanë përdorur ata për t'i detyruar ata që të tërhiqeshin. Ngjashëm mund të ndodhë edhe me pjesëtarët e rinj të Policisë së Kosovës, të cilët janë duke u rekrutuar. Andaj, duhet të mbrohen, edhe zyrtari publik i yni që të mos u nënshtrohet këtyre personave", thekson Vrajolli.

Sipas tij, institucionet duhet të angazhohen në komunikim direkt me serbët dhe në mënyrë që ata të mos e njohin shtetin vetëm si shtet policor.

"Mendoj që është me rëndësi të krijohet ai momentum ku komuniteti serb të jetë i hapur për integrim dhe pastaj përgjegjësia të bartet tek institucionet tona, për shkak se është përgjegjësi e institucioneve tona për ta integruar çdo qytetar", deklaron Vrajolli.

## Trendët

42 shtetas të BE-së janë dënuar për spiunazh (shumica në favor të Rusisë) në bazë të raportit të Agjencisë Suedeze për Hulumtime të Sigurisë "Spiunazhi nga Evropianët".

Lufta në Ukrainë e ka ndryshuar bilancin e sigurisë, ndërsa në Kosovë që atëherë vit pas viti u ballafaqua me sulme terroriste në veri të vendit. Për të gjitha këto sulme, Kosova e ka fajësuar Serbinë.

Megjithatë, për ta përmirësuar situatën e sigurisë, sipas Vrajollit, institucionet duhet të përqendrohen te parandalimi i këtyre rasteve. Veçanërisht te komuniteti serb, sipas tij, shteti duhet t'u ofrojë mbrojtje zyrtarëve të institucioneve të Kosovës dhe t'i ndjekë penalisht personat që i kërcënojnë për t'u tërhequr nga institucionet e Kosovës.

"Ngjashëm mund të ndodhë edhe me pjesëtarët e rinj të Policisë së Kosovës, të cilët janë duke u rekrutuar. Andaj, duhet të mbrohen, edhe zyrtari publik i yni që të mos u nënshtrohet këtyre personave. Kjo është punë e bashkërenditur që duhet të bëhet mes institucioneve të sigurisë, duke filluar nga Policia, AKI-ja e institucionet e tjera", thotë Vrajolli.

Njohësit paralajmërojnë se edhe viti 2026 është po ashtu vit i rreziqeve të sigurisë. Sopjani vlerëson se rreziku i spiunazhit nga Serbia nuk ka afat dhe shton se pavarësisht rrethanave politike, ky shtet do të mundohet ta minojë Kosovën përmes spiunazhit.

"Rreziku është permanent dhe do të jetë edhe afatgjatë, sepse nuk është një rrezik që përfundon apo që ka një afat skadimi, sepse unë e vlerësoj që edhe në rastin më të mirë të mundshëm, nëse do ta kishim një marrëveshje paqeje me Serbinë apo për njohje të ndërsjellë, prapëseprapë në kanale të ndryshme do të vazhdojë kjo", thotë Sopjani.

E Vrajolli thotë se siguria është kryetemë gjithandej, shkaku i zhvillimeve globale, e posaçërisht në kontinentin evropian shkaku i luftës në Ukrainë.

"Siguria është temë globale, është tema numër një dhe duke i pasur parasysh edhe zhvillimet e përgjithshme botërore ne duhet të jemi të gatshëm që të mbrohemi nga kërcënimet dhe rreziqet dhe përderisa nuk mbrohemi brenda për brenda shoqërisë, atëherë këto rreziqe mund të bëhen shumë më potente", ka deklaruar Vrajolli.

© KOHA Ditore

GJATË VITIT 2025, NË QKUK JANË SHËNUAR MBI 30 RASTE TË BRAKTISJES SË FËMIJËVE TË POSALINDUR

# Kur të qarat e të vegjëlve përplasen me muret e QKUK-së

**Në vitin 2015, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës janë regjistruar 24.594 lindje, ndërsa 40 fëmijë janë braktisur. Një dekadë më vonë, në vitin 2024, numri i lindjeve ka rënë në 21.487, ndërsa numri i fëmijëve të braktisur në 23. Më 2025, deri në mes të dhjetorit, në Klinikën e Gjinekologjisë - ku funksionon edhe reparti i Neonatologjisë - janë regjistruar gjithsej 32 raste të fëmijëve të braktisur**




PRISHTINË, 5 JANAR - Në derën e dhomës shkruan: "Njësia e fëmijëve pa përcjellje të nënave".

Kur afrohesh, dëgjon zërat apo frymëmarrjen e lehtë të dy foshnjave.

Nuk janë thjesht thirrje për kujdes, por edhe jehonë e një të vërtete të hidhur.

Në fillimdhjetorin e 2025-tës, njëri sapo kishte mbushur një muaj jetë, tjetri tetëmbëdhjetë ditë.

Të dy ishin braktisur nga nënat e tyre, ndërsa për baballarët nuk dihej.

"Ne mundohemi t'i bindim nënat që të mos i lënë fëmijët, por në shumicën e rasteve vendimi është i prerë…", thotë Yllka Shala, e cila udhëheq zyrën për fëmijët e braktisur në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK).

## Histori pas secilit fëmijë

Yllka është personi i vetëm në këtë institucion që mundohet të mbajë gjallë lidhjen midis nënës dhe fëmijës - edhe kur shanset janë kundër.

Çdo ditë pune për të nis njësoj: me dosje të reja mbi tavolinë dhe me histori që rëndojnë më shumë se letrat që mban në duar.

Në sytë e saj lexohet çdo ndarje që ka ndodhur në korridoret e repartit të Neonatologjisë.

Ajo i njeh mirë hapat e nënave që hyjnë me kokën ulur, duart që dridhen kur firmosin dokumentin e fundit dhe heshtjen e rëndë që mbetet pas tyre.

"Secili rast është histori në vete, e të gjitha janë shumë të ndjeshme", thotë ajo për Radion Evropa e Lirë.

Yllka ulet përballë nënave jo si zyrtare, por si njeri.

Flet ngadalë, me kujdes, duke kërkuar një fije të vogël shprese.

U tregon për fëmijën, për fytyrën e tij, për ngjashmëritë që tashmë i sheh.

"U them se dita kur një nënë ndahet nga fëmija i saj është një ditë e errët, sikur edhe dielli të mos ndriçojë më", rrëfen ajo.

Por, në shumicën e rasteve, fjalët nuk mjaftojnë. Vendimi është marrë shumë më herët - jashtë mureve spitalore.

Një nga rastet që nuk e harron kurrë, ishte një nënë e re që nuk pushonte së qari.

Qante para lindjes, qante pas lindjes, qante edhe kur e mbante foshnjën pranë.

Ajo ngrihej për t'u larguar, ndalej, kthehej sërish. Një lëvizje e pafund mes dashurisë dhe frikës.

"Ajo nuk ishte e ftohtë... ishte e tmerruar. Dhe në fund u largua vetëm", kujton Yllka.

Në shumicën e këtyre historive, një e përbashkët përsëritet pothuajse gjithmonë.

Fëmijët që mbesin pas, duke qarë në dhomën e mbyllur të Neonatologjisë, janë kryesisht të lindur jashtë martese.

Yllka thotë se pas tyre fshihen histori grash të shtyra drejt cepit - pa përkrahje familjare, pa siguri ekonomike dhe të braktisura nga partnerët.

Shumë nga to nuk japin asnjë detaj për identitetin e babait, ose zgjedhin të mos flasin fare për të.

Pas momentit të braktisjes, historia e fëmijës nuk ndalet - ajo vetëm hyn në një fazë tjetër, po aq të pasigurt.

Procedurat nisin menjëherë, në heshtje, larg syve të publikut.

Në ditët e para pas lindjes, stafi i repartit njofton Qendrën për Punë Sociale në komunën nga vjen nëna, si dhe policinë.

Dosja hapet, deklaratat merren dhe gjithçka dokumentohet. Foshnja, ndërkohë, mbetet në spital.

Sipas rregullave, një fëmijë i braktisur mund të qëndrojë në spital deri në 40 ditë.

Nëse gjendja shëndetësore nuk është e mirë, kjo periudhë mund të zgjatet edhe pak. Janë ditë pritjeje, ku çdo orë kalon njësoj: qumësht, gjumë, të qara dhe mungesë e një fytyre që do ta njihte si të vetën.

Gjatë kësaj kohe, Yllka dhe stafi i Qendrës për Punë Sociale përpiqen të mbajnë të hapur edhe një derë të fundit.

Nëse nëna ndërron mendje, ligji i jep asaj ende të drejtë të kthehet dhe ta marrë fëmijën. Por kjo ndodh rrallë. Shumica e fëmijëve mbesin aty, në shtretër të vegjël, pa emra, vetëm me data lindjeje dhe numra dosjesh.

Kur kalojnë 40 ditët dhe shpresa për kthim shuhet, procedurat vazhdojnë drejt strehimit familjar.

Qendrat për Punë Sociale marrin përsipër rastin dhe fëmija dërgohet në një familje strehuese.

## Shifra që flasin

Yllka thotë se, viteve të fundit, vërehet një rënie e lehtë e numrit të fëmijëve të braktisur. Jo sepse arsyet që i shtyjnë nënat drejt këtij vendimi janë zhdukur, por sepse numri i lindjeve ka rënë.

Për krahasim, në vitin 2015, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës janë regjistruar 24.594 lindje, ndërsa 40 fëmijë janë braktisur. Një dekadë më vonë, në vitin 2024, numri i lindjeve ka rënë në 21.487, ndërsa numri i fëmijëve të braktisur në 23.

Më 2025, deri në mes të dhjetorit, në Klinikën e Gjinekologjisë - ku funksionon edhe reparti i Neonatologjisë - janë regjistruar gjithsej 32 raste të fëmijëve të braktisur.

Yllka thotë se shifrat mund të mos tregojnë gjithë të vërtetën.

Ajo thotë se ka raste kur nëna nuk do të flasë fare... ose edhe kur flet, është shumë e revoltuar.

"Kam ardhur në QKUK për të lindur, sepse mund të kisha lindur në rrugë dhe askush të mos dinte për fëmijën tim", shpjegon Yllka rastet me të cilat përballet.

## Dhoma e braktisjes

Teksa flet, vëmendjen ia tërheqin zërat dhe lëvizjet e dy foshnjave në dhomën e dedikuar për ta.

Historitë e tyre, edhe pse të ndryshme, ndajnë të njëjtin fund: u braktisën nga nëna që nuk panë rrugëdalje.

Njëri ka lindur nga një nënë e re, vetëm 20 vjeçe, e pamundur të kujdeset për shkak të kushteve ekonomike dhe sociale.

Tjetri, më i vogël dhe i dobët, ishte fëmijë i një gruaje 40-vjeçare, tashmë me dy fëmijë nën përkujdesjen e gjyshërve, ndërsa ajo ndodhej në burg. Për të tretin, nuk kishte asnjë mundësi që të siguronte kujdesin e duhur.

Realiteti bëhet edhe më i vështirë nga kushtet në repartin ku qëndrojnë.

Nga ora 7 deri në 14:00, për kujdesin e tyre përgjigjet vetëm një infermiere. Pas kësaj ore, dy infermiere të tjera marrin përsipër përgjegjësinë, duke u përkujdesur njëkohësisht edhe për 28 deri në 30 fëmijë të tjerë të repartit.

Dhoma e fëmijëve të braktisur mbahet e mbyllur me dry kur nuk ka staf, për siguri. E, kjo do të thotë se të qarat e tyre shpesh mund të mbeten të padëgjuara, pa asnjë fytyrë që t'i qetësojë.

Dhoma i ka katër shtretër të vegjël dhe Yllka lutet që ata të mbeten sa më bosh, me shpresën që çdo fëmijë të gjejë dashurinë dhe kujdesin që i nevojitet.

(Rel)



## SHKURT

### KRU "Prishtina" publikon tarifat e reja me rritje për ujin

Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka publikuar më 5 janar tarifat e reja me rritje që hyjnë në fuqi nga ky muaj. Vendimi për tarifat e reja është marrë më 31 dhjetor 2025 dhe vlen deri më 2028. Sipas tarifave të reja, uji për konsumatorët shtëpiakë është 0.63 euro për metër kub nga 0.45 euro sa ishte vitin e kaluar. Edhe tarifat e tjera janë shtrenjtuar. Ajo për konsumatorët joshtëpiakë (komercialë dhe industrialë) është 0.82 euro nga 0.62 euro sa ishte vitin e kaluar. Tarifa për shërbimet e ujërave të ndotur është 0.28 euro për metër kub, nga 0.17 sa ishte. Po ashtu, KRU "Prishtina" ka publikuar edhe tarifat të reja për kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe shërbime të tjera. KRU "Prishtina" furnizon me ujë të pijshëm disa komuna të Kosovës dhe trajton ujërat e zeza. Kjo ndërmarrje ofron shërbime në Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Graçanicë, Shtime, Lipjan, Podujevë dhe Drenas.

### Shembja e gurëve dëmton binarët hekurudhorë në relacionin Klinë-Prishtinë

Binari hekurudhor në rrugën Klinë-Prishtinë është dëmtuar nga një shembje e gurëve. Ndërmarrja "Trainkos" ka njoftuar se gjatë ditës së hënë ka ndodhur një rrëshqitje e gurëve në Km 51/200 dhe si pasojë e kësaj është dëmtuar binari hekurudhor dhe treni nuk ka pasur mundësi të qarkullojë si pasojë e këtij incidenti. "Treni Pejë – Prishtinë -Pejë nuk do të qarkullojë deri në njoftimin e radhës", thuhet në njoftim.

### Arrestohet në Morinë shtetasi i Kosovës, kërkohej ndërkombëtarisht nga Lituania

Policia e Shqipërisë ka arrestuar të hënën në pikëkalimin kufitar në Morinë një 39-vjeçar nga Kosova. Ai po kërkohej ndërkombëtarisht nga autoritetet lituaneze, ku është i dënuar me 2 vjet e 3 muaj burgim për "Dëmtim i papërfillshëm i shëndetit, kërcënim për të vrarë ose për t'i shkaktuar një personi një dëmtim të rëndë shëndeti ose terrorizëm i një personi". Personi me inicialet B.K. do të ekstradohet drejt Lituanisë. "Si rezultat i kontrolleve me përzgjedhje dhe i verifikimeve në hyrje/dalje, me objektiva goditjen e paligjshmërive në kufi, si dhe ndalimin e shtetasve të shpallur në kërkim, të cilët tentojnë të lëvizin ilegalisht për t'iu shmangur përgjegjësisë penale, shërbimet e Policisë Kufitare të Morinës, në bashkëpunim me shërbimet e DVP Kukës, kapën në hyrje të RSh-së dhe arrestuan me qëllim ekstradimin, shtetasin kosovar: B. K., 39 vjeç, banues në Kosovë. Nga verifikimet e kryera dhe nga informacioni i shkëmbyer me Interpol Tiranën, rezultoi se ky shtetas ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Vilnius, Lituani, pasi Gjykata e Vilnusit e ka dënuar me 2 vjet e 3 muaj burgim, për veprën penale "Dëmtimi i papërfillshëm i shëndetit, kërcënimi për të vrarë ose për t'i shkaktuar një personi një dëmtim të rëndë shëndeti ose terrorizmi i një personi". Interpol Tirana, në bashkëpunim me homologët në Lituani, vijon procedurat për ekstradimin e 39-vjeçarit", ka njoftuar Policia e Shqipërisë.

(Koha.net)

MBAHET SEANCA E PARË GJYQËSORE NDAJ NICOLAS MADUROS

# Maduro deklarohet i pafajshëm para gjykatës në SHBA, seanca tjetër më 17 mars

**Presidenti i rrëzuar i Venezuelës, Nicolas Maduro, është deklaruar i pafajshëm në paraqitjen e tij të parë para gjykatës së SHBA-së të hënën në New York. I veshur me uniformë të burgut, Maduro ka dalë para gjykatës për t'u përballur me akuzat për narkoterrorizëm. E, pak para seancës ndaj tij, Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka mbajtur mbledhje urgjente, gjatë së cilës palët kanë paraqitur pikëpamje të ndryshme për operacionin amerikan në Venezuelë**



New York, 5 janar (BBC, AP) - Presidenti i rrëzuar i Venezuelës, Nicolas Maduro, është deklaruar i pafajshëm në paraqitjen e tij të parë të hënën para gjykatës amerikane në New York, bashkë me gruan e tij, ku është përballur me akuzat për narkoterrorizëm, të cilat administrata Trump i përdori për të arsyetuar kapjen dhe dërgimin e tij në SHBA.

Gjatë seancës dëgjimore ai ka thënë se është ende president i Venezuelës teksa nuk ka kërkuar lirim me kusht.

Seanca e radhës ndaj tij është caktuar për 17 mars.

Maduro po ashtu ka deklaruar gjatë seancës se është një "i burgosur lufte".

Transferimi i Maduros dhe gruas së tij nga burgu për në gjykatë kishte filluar me momente dramatike të hënën. Zhurma e prangave në këmbë të Maduros mund të dëgjohej para se ai të hynte në sallën e gjyqit, ku ai është kthyer, ka tundur kokën dhe duket sikur u ka thënë "buenos dias" disa personave në sallë.

Momenti më i tensionuar ishte në fund të seancës, kur një anëtar i publikut filloi t'i bërtiste në spanjisht Maduros se ai do të "paguajë" për atë që kishte bërë.

Mirëpo Maduro është kthyer nga ai dhe është përgjigjur në spanjisht se ai ishte një "president i rrëmbyer" dhe një "rob lufte" përpara se të shoqërohej jashtë i lidhur, pas gruas së tij, përmes derës së pasme të gjykatës.

Çifti u transportua nën masa të rrepta sigurie të hënën herët nga burgu i Bruklinit ku është duke u mbajtur, për në një gjykatë të Manhattanit.

Mst: Tensionet në KS të OKB-së

Ndërkohë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka mbajtur të hënën një takim urgjent për Venezuelën, gjatë të cilit palët kanë paraqitur pikëpamje të kundërta për operacionin amerikan në shtetin e Amerikës së Jugut.

I dërguari i Rusisë në Kombet e Bashkuara, Vasily Nebenzya, u ka bërë thirrje të hënën Shteteve të Bashkuara të lirojnë presidentin e Venezuelës, Nicolas Maduro, duke paralajmëruar se veprimet e Washingtonit mund të sjellin një epokë të re kolonializmi dhe imperializmi.

"Washingtoni po gjeneron një vrull të ri për neokolonializmin dhe imperializmin, të cilat u dënuan dhe u hodhën poshtë në mënyrë të përsëritur dhe vendimtare nga popujt e këtij rajoni dhe nga jugu global në tërësi... Kambana tani bie në të gjithë rajonin, duke rënë për çdo vend të Hemisferës Perëndimore", ka deklaruar Nebenzya.

Ndërkaq i dërguari i SHBA-së, Mike Waltz, ka përsëritur deklaratën e sekretarit amerikan të shtetit, Marco Rubio, duke thënë se kapja e Maduros ishte një "operacion i zbatimit të ligjit". Ai ka theksuar se SHBA-ja nuk e ka pushtuar Venezuelën.

"Nuk ka luftë kundër Venezuelës apo popullit të saj. Ne nuk po pushtojmë një vend", është shprehur Waltz.

Mediat kanë raportuar se Maduro është paraqitur në gjykatë me uniformë burgu teksa ai ka angazhuar avokatin Barry Joel Pollack, tregojnë të dhënat e gjykatës federale.

Pollack njihet më së shumti për përfaqësimin e themeluesit të Wikileaks, Julian Assange.

## Zbutja e tonit

Ndërkohë, presidentja e përkohshme e Venezuelës, Delcy Rodriguez, e cila fillimisht ka kërkuar që SHBA-ja ta kthejë Maduron, të dielën vonë ka zbutur qëndrimin duke ofruar bashkëpunim me presidentin Trump dhe "marrëdhënie respekti" me SHBA-në.

E presidenti Trump i ka bërë thirrje asaj të sigurojë "qasje të plotë" në vendin e saj, përndryshe e ka kërcënuar se do të përballet me pasoja.

Një aktakuzë prej 25 faqesh e bërë publike të shtunën ngarkon Maduron dhe të tjerët se kanë bashkëpunuar me kartelet e drogës për të lehtësuar dërgesën e mijëra tonëve kokainë në SHBA.

Ata mund të përballen me burgim të përjetshëm nëse dënohen.

SHBA-ja ka kapur Maduron dhe gruan e tij gjatë një operacioni ushtarak të shtunën, në shtëpinë e tyre në një bazë ushtarake.

Trumpi ka thënë pas kapjes së tij se SHBA-ja do ta drejtojë Venezuelën përkohësisht.

## Lajmi i mirë për Hungarinë

Kryeministri hungarez, Viktor Orban, ka thënë të hënën se operacioni ushtarak amerikan në Venezuelë që rrëzoi presidentin e vendit, Nicolas Maduro, është një "lajm i mirë" për Hungarinë, për shkak të efekteve të mundshme pozitive të këtij veprimi në tregjet botërore të energjisë.

Duke folur në një konferencë për shtyp në Budapest, Orban, një aleat i ngushtë i presidentit të SHBA-së, Donald Trump, i cili urdhëroi sulmin ushtarak kundër Venezuelës, ka thënë se së bashku Shtetet e Bashkuara dhe Venezuela mund të kontrollojnë 40% deri në 50% të rezervave globale të naftës.

"Amerikanët kanë nevojë për energji më të lirë për programin e politikave ekonomike të shpallur nga presidenti. Kjo kërkon çmime më të ulëta të energjisë se ato të sotmet. Dhe ky është një lajm i mirë për Hungarinë", ka thënë Orban.

"Unë shoh një shans serioz që, si rezultat i vënies nën kontroll të Venezuelës, një situatë më e favorshme globale e energjisë do të lindë edhe për Hungarinë. Dhe ky është një lajm i mirë", ka shtuar ai.

Hungaria nën Orbanin ka mbetur shumë e varur nga nafta dhe gazi rus edhe pasi Moska nisi pushtimin e saj në shkallë të plotë të Ukrainës fqinje në shkurt 2022, duke ngatërruar shumicën e partnerëve të saj në Bashkimin Evropian, të cilët kanë ulur ndjeshëm importet e tyre të energjisë ruse ose i kanë ndaluar ato plotësisht.

## Kërcënimi i Trumpit dhe paralajmërimi i Petros

Presidenti kolumbian, Gustavo Petro, ka paralajmëruar të hënën se do të "merrte armët në dorë" nëse SHBA-ja vendos ta sulmojë atë ose vendin e tij, pas një sërë kërcënimesh nga presidenti amerikan, Donald Trump.

Në një postim në X, Petro ka nënvizuar përpjekjet e tij për të luftuar trafikun e drogës, gjë për të cilën Trumpi e ka kritikuar, teksa ka pretenduar se sulmet ushtarake amerikane kundër trafikantëve në Kolumbi do të rrezikonin vrasjen e fëmijëve dhe nxitjen e rekrutimit për grupet separatiste që kanë qenë në konflikt me shtetin për dekada.

"Dhe nëse arrestojnë një president që ka mbështetjen dhe respektin e një pjese të madhe të vendit, ata do të nisin një kryengritje popullore", ka shtuar ai.

Petro, një ish-anëtar i grupit guerilas "M19", ka thënë gjithashtu se ai vetë do të luftonte për të mbrojtur Kolumbinë.

"U betova se nuk do të prekja më një armë, por për atdheun do të marr përsëri armët", ka thënë ai.

Trumpi ka pasur fjalë të ashpra për Petron të dielën, duke e përshkruar atë si "një njeri të sëmurë që i pëlqen të bëjë kokainë dhe ta shesë atë në Shtetet e Bashkuara, dhe se nuk do ta bëjë këtë për shumë kohë".

Kur një gazetar e pyeti nëse këto komente nënkuptonin se mund të kishte një "operacion" në Kolumbi në të ardhmen, Trump është përgjigjur: "Më duket mirë".



### Qeveria zvicerane ngrin pasuritë e Maduros

Qeveria zvicerane ka ngrirë pasuritë e mbajtura nga presidenti i rrëzuar i Venezuelës, Nicolas Maduro, dhe "persona të tjerë të lidhur me të me efekt të menjëhershëm". Ajo ka thënë se kjo po bëhet për të parandaluar nxjerrjen e çdo pasurie të tillë nga vendi dhe se nëse procedurat e ardhshme ligjore tregojnë se ato janë fituar në mënyrë të paligjshme, Zvicra do të përpiqet t'ia kthejë ato popullit venezuelas. Zvicra ka vendosur sanksione ndaj Venezuelës që nga viti 2018, të cilat përfshijnë ngrirje pasurish dhe ndalime udhëtimi për 54 individë. Nuk është e qartë se çfarë pasurish mban Maduro në Zvicër, por një raport i vitit 2021 në një gazetë zvicerane bazuar në dokumente të rrjedhura thoshte se prokurorët zviceranë kishin identifikuar llogari bankare që përmbanin afërsisht 10 miliardë dollarë që mund të kenë ardhur nga fonde publike të përvetësuara në Venezuelë.



## SHKURT

### Identifikohen të gjitha viktimat e zjarrit në Crans-Montana të Zvicrës

CRANS-MONTANA/ZVICËR, 5 JANAR (BBC) - Janë identifikuar trupat e të gjithë 40 të vdekurve nga zjarri që ka ndodhur në orët e para të vitit 2026 në një bar në resorin zviceran të skijimit Crans-Montana, e po ashtu të 116 të lënduarve, ka njoftuar policia kantonale e Valaisit. Të vdekurit janë të moshave nga 14 deri 39 vjeç, ndërsa 15 ishin nën 18 vjeç. Viktimat më të reja janë një vajzë zvicerane dhe një djalë francez të moshave 14-vjeçare. Në mesin e të vdekurve ka shtetas zviceran, italian, rumun, turk, portugez, francez dhe belg. Po ashtu ka edhe qytetarë nga Britania e Madhe e Izraeli. Ndërkohë, shumica e të lënduarve kanë djegie të rënda dhe po vazhdojnë të trajtohen në spital. Një hetim penal ka nisur ndaj çiftit francez që ka menaxhuar barin "Le Constellation". Një hetim paraprak ka zbuluar se shkëndijat në shishe që mbaheshin shumë afër tavanit janë shkaku i mundshëm i zjarrit. Policia ka thënë se nuk do të publikojë detaje të mëtejshme rreth viktimave që kanë identifikuar, për shkak të respektit ndaj familjeve të tyre.

### Shpallen fajtorë 10 persona për ngacmim online ndaj Brigitte Macron

PARIS, 5 JANAR (AP) - Një gjykatë në Paris ka shpallur të hënën fajtorë 10 persona për ngacmim online ndaj zonjës së parë të Francës, Brigitte Macron, të cilët kishin përhapur pretendime të rreme në internet rreth gjinisë dhe seksualitetit të saj, dhe duke përfshirë pretendimet se ajo ka lindur burrë. Gjykata i dënoi të gjithë të pandehurit me dënime që variojnë nga një trajnim ndërgjegjësimi për ngacmimin kibernetik deri në dënime me burgim me kusht, me kohëzgjatje prej 8 muajsh. Të pandehurit, tetë burra dhe dy gra të moshës 41 deri në 65 vjeç, akuzohen se kanë postuar "komente të shumta keqdashëse" duke pretenduar në mënyrë të rreme se gruaja e presidentit Emmanuel Macron ka lindur burrë dhe duke lidhur diferencën e tyre në moshë prej 24 vjetësh me pedofilinë. Disa nga postimet u shikuan dhjetëra mijëra herë. Brigitte Macron nuk mori pjesë në gjyqin dyditor në tetor. Duke folur në televizionin kombëtar TF1 të dielën, ajo ka thënë se nisi procedurat ligjore për të "dhënë një shembull" në luftën kundër ngacmimit. Macronët kanë ngritur gjithashtu një padi për shpifje në Shtetet e Bashkuara kundër influencueses konservatore, Candace Owens.

### Protestat në Iran hyjnë në ditën e nëntë, Trumpi përsërit kërcënimin për ndërhyrje

TEHERAN, 5 JANAR (BBC) - Një valë protestash të shkaktuara nga rënia ekonomike e Iranit ka hyrë në ditën e nëntë, ndërsa presidenti amerikan, Donald Trump, ka përsëritur kërcënimin e tij për ndërhyrje të SHBA-së. Trumpi ka paralajmëruar gjatë natës të së dielës se autoritetet iraniane do të "goditeshin shumë rëndë" nëse vdesin më shumë protestues. Të paktën tre të mitur raportohet se janë vrarë dhe më shumë se 40 të tjerë janë arrestuar në protestat e vazhdueshme në të gjithë Iranin. Grupet e të drejtave të njeriut kanë akuzuar forcat e sigurisë së regjimit për "shënjestrim pa dallim të civilëve". Kryengritja mbarëkombëtare e shkaktuar nga rënia e monedhës së vendit dhe rritja e kostove të jetesës është përhapur në të paktën 26 nga 31 provincat, teksa demonstruesit bëjnë thirrje për fundin e regjimit, sipas Aktivistëve të të Drejtave të Njeriut në Iran (HRAI) me bazë në SHBA. Protestat kanë vazhduar gjatë fundjavës pavarësisht përkeqësimit të masave nga forcat e sigurisë pas komenteve të udhëheqësit suprem të vendit, Ali Khamenei, i cili iu drejtua protestuesve si "rebelë".

“FERRI” QË PO PËRJETOJNË UKRAINASIT E ODESËS

# Odesa në terr dhe në të ftohtë: Jeta nën sulmet e pandërprera ruse

**Vuajtjet për njerëzit e moshuar dhe për personat me aftësi të kufizuara janë veçanërisht të rënda dhe të dhimbshme, pasi forcat e Moskës vazhdojnë të godasin në mënyrë të përsëritur infrastrukturën jetike të këtij qyteti-port, duke e kthyer jetën e përditshme në një përballje të vazhdueshme me mungesën e shërbimeve bazë, frikën dhe pasigurinë**




ODESA, JANAR (NYT) - Kur ajo dëgjon shpërthime, Tetiana Rybak bën të vetmen gjë që ka mundësi të bëjë në rrethanat e saj: shtrihet në shtratin e saj dhe pret, sepse trupi i saj nuk e lejon të ecë dhe as të zbresë drejt strehimoreve, të cilat për shumë njerëz të tjerë përbëjnë të vetmen mundësi shpëtimi. Rybak, e vetëdijshme për pafuqinë e saj fizike, i kërkoi së fundmi një punonjësi social që t’i mbulonte dritaret e apartamentit me letër ambalazhi të kuqe festive, me posterë të vjetër ushtarakë dhe madje edhe me një version të lutjes së Zotit, duke shpresuar se kështu do të gjente pak qetësi shpirtërore.

Në këtë mënyrë, ajo nuk është më e detyruar të shohë me sytë e saj dronët rusë që kalojnë pranë banesës, duke mbjellë frikë dhe pasiguri. Gjatë dy javëve të fundit, Rusia ka përqendruar një pjesë të madhe të fuqisë së saj ushtarake në bombardimin e qytetit të saj të lindjes, Odesës, portit më të madh të Ukrainës, duke e goditur vazhdimisht me dronë dhe raketa në atë që konsiderohet si bombardimi më i rëndë i qytetit gjatë gati katër vjetëve luftë.

Rybak ka mbetur pa energji elektrike për të paktën nëntë ditë gjatë këtij muaji dhe për katër prej tyre ajo nuk ka pasur as ngrohje dhe as ujë, gjë që e ka bërë jetën e saj të përditshme pothuajse të padurueshme. Një punonjës social u detyrua të ngjitej shtatë kate shkallë për t’i sjellë shishe me ujë, pasi ajo nuk kishte asnjë mundësi tjetër për t’u furnizuar. E paaftë prej vitesh, Rybak u përpoq të ruante nxehtësinë duke veshur dy palë çorape, dy palë pantallona të trasha, një triko dhe një rrobë banje të trashë prej pëlhure, përpara se të futej nën dy batanije.

“Psikologjikisht askush nuk mund ta përballojë më këtë situatë”, tha Rybak, 64 vjeçe, teksa qëndronte e ulur në shtratin e saj gjatë një vizite të fundit nga punonjësit socialë. “Sistemi im nervor është plotësisht i shkatërruar. Vetëm mbrëmë, kur u ndërpre energjia elektrike dhe filluan bombardimet, me sirenat e alarmit ajror që ulërinin pa pushim, zhurma ishte tmerrësisht e fortë. Por edhe më e frikshme ishte vala e shpërthimit: dyert dhe dritaret po dridheshin bum, bum, bum... dhe unë isha shtrirë aty, e paaftë të vrapoja apo të fshihesha diku, pa asnjë vend ku të shkoja”.

Ukrainasit spekulojnë se Moska po e sulmon Odesën, e vendosur buzë Detit të Zi, si një akt hakmarrjeje për sulmet e fundit të Ukrainës ndaj të ashtuquajturës “flotë hije” që Rusia përdor për të transportuar naftën e saj dhe për t’iu shmangur sanksioneve ndërkombëtare. Ndërsa qytetet e mëdha të Ukrainës zakonisht përjetojnë periudha bombardimesh intensive të ndjekura nga qetësi relative, Odesa ka qenë nën sulme pothuajse të pandërprera që nga orët e para të mëngjesit të 12 dhjetorit. Rusia ka synuar kryesisht portet e qytetit dhe infrastrukturën energjetike, duke lënë pasoja të rënda për popullsinë civile, ndërsa të paktën nëntë persona kanë humbur jetën deri tani.

## Improvizim për mbijetesë

Kur energjia elektrike, gazi dhe uji mungojnë për ditë të tëra pa ndërprerje, banorët e qytetit detyrohen të përshtaten me mënyra improvizuese për të mbijetuar, duke karikuar telefonat dhe kompjuterët e tyre në qendrat shtetërore të ndihmës ose në dyqane ushqimore që ende kanë energji, ndërsa ushqimin e përgatisin në soba të improvizuara jashtë, shpesh në oborre ose në anë të rrugëve. Për të ruajtur ushqimet të freskëta, ata vendosin qese plastike me qumësht, vezë dhe ajkë kosi në pragjet e dritareve, duke shfrytëzuar të ftohtin e jashtëm si frigorifer natyror. Disa banorë kanë vendosur gjeneratorë të mëdhenj në oborre, jo vetëm për veten e tyre, por edhe që fqinjët të mund të marrin pak energji elektrike për nevojat më bazike.

Një burrë lidhi kapëse direkt në baterinë e makinës së tij dhe zgjati kabllon deri në apartament, duke arritur kështu të furnizonte me energji frigoriferin dhe rrobalarësen. Ndërkohë dhjetëra drejtues makinash “Tesla” pritën për orë të tëra në radhë pranë të vetmit pikë karikimi që ende funksiononte në qytet.

Që nga momenti kur trupat ruse pushtuan Ukrainën në shkurt të vitit 2022, ukrainasit janë mobilizuar dhe kanë treguar një qëndrueshmëri të jashtëzakonshme, aq shumë sa kjo rezistencë është përmendur dhe lavdëruar vazhdimisht, deri në atë pikë sa është kthyer pothuajse në klishe. Oleksii Kolodchuk, 83 vjeç, tha se ndërprerjet e energjisë dhe ngrohjes nuk ishin ndonjë problem i madh për të. Keqardhja e tij më e madhe ishte se kishte harruar ta nxirrte borshctin, supën tradicionale ukrainase jashtë në të ftohtë dhe, për pasojë, supa iu prish shumë më herët nga sa duhej.

Ai shtoi gjithashtu se do të donte t’ia dërgonte një mesazh presidentit rus, Vladimir V. Putin.

“Ndonjëherë mendoj se po të mundesha t’i afrohesha Putinit me një shkop, do t’i jepja një goditje të mirë në kokë - ndoshta do t’ia kthente pak mendjen, sepse duket qartë se diçka nuk shkon aty”, tha Kolodchuk.

Megjithatë, pas gati një jave pa energji elektrike, durimi i disa banorëve të Odesës kishte filluar të shteronte dhe ata dolën në protestë. Për disa të moshuar, përballja me këto vështirësi pikërisht para Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri e bënte shumë të vështirë ruajtjen e optimizmit dhe shpresës.

E vetmja gjë që i sjell gëzim Valentyna Avdiienkos, 72 vjeçe, është nipi i saj trevjeçar, Denys, një fëmijë gjithmonë i gëzuar dhe llafazan, pavarësisht gjithçkaje që ndodh rreth tij. Sa herë bien alarmet ajrore, ai bërtet “balistika, balistika”, duke imituar fjalët që ka dëgjuar nga të rriturit.

Së fundmi ajo ecte me vështirësi në errësirë drejt shtëpisë së saj, duke u mbështetur në një bastun në dorën e majtë dhe duke shtyrë një karrocë të vogël pazari me dorën e djathtë.

“Dua vetëm që kjo çmenduri të marrë fund”, tha ajo. “Jemi kaq të lodhur. Kur do të mbarojë më në fund kjo?”

## Luftë e dhimbshme

Për njerëzit e moshuar që e kujtojnë jetën nën Bashkimin Sovjetik, kjo luftë është edhe më e dhimbshme, sepse vë përballë ukrainasit dhe rusët, të cilët dikur i konsideronin si vëllezër.

Për 25 vjet, Mahadan Farkhiiev, 73 vjeç, shërbeu në Ushtrinë Sovjetike krah për krah me ukrainas dhe rusë. Ai luftoi në Afganistan, ku u plagos në këmbën e djathtë. Në dhomën e ndenjës mban një fotografi të vetes me uniformë, me gjoksin të mbuluar me medalje sovjetike. Megjithatë, ai nuk flet më me vëllain dhe motrën e tij, të cilët jetojnë në Rusi.

Olha Demydova, 43 vjeçe, punonjëse sociale e organizatës bamirëse ukrainase “Culture of Democracy”, e vizitoi së fundmi Farkhiievin për të parë se për çfarë kishte nevojë familja e tij. Ai ishte ulur në divan me bashkëshorten e tij, Anastasiia, dhe djalin e tyre, Andrii, 42 vjeç, i cili vuan nga paraliza cerebrale. Andrii nuk mund të flasë dhe as të ecë, ndërsa ushqimin mund ta gëlltisë vetëm në formë pureje. Prindërit e tij duhet t’ia ndërrojnë pelenat rreth katër herë në ditë.

Kur bombardimet intensifikohen, Farkhiiev dhe bashkëshortja e tij e vendosin Andriin në një karrige me rrota dhe e çojnë në korridor, ku ai shtrëngon grushtet dhe mbyll sytë fort derisa shpërthimet të pushojnë.

“Sepse, Zoti na ruajt - ku do të vraponim me të?”, pyeti ai.

Demydova tha se një pjesë e madhe e punës së saj kohët e fundit ka qenë thjesht të inkurajojë njerëz si Farkhiiev, duke u qëndruar pranë dhe duke i pyetur për jetën e tyre në rininë e hershme.

“Kur nuk ka energji elektrike, nuk ka ngrohje, nuk ka ujë, një lloj apatie të pushton” tha ajo. “Mendon se ka marrë fund gjithçka. Dhe pastaj e kupton - jo. Absolutisht jo. Nuk mund të dorëzohesh. Duhet të vazhdosh përpara. Duhet ta jetosh këtë, ta përballosh. Do të bëhet më mirë”.

Për Rybakun, gruan e cila është e detyruar të qëndrojë e shtrirë në shtrat në apartamentin e saj në katin e shtatë, kjo nuk ishte aspak mënyra se si ajo e kishte imagjinuar apo pritur të shkonte jeta e saj. Dikur, ajo vetë ishte punonjëse sociale dhe kujdesej për njerëz të pambrojtur, duke menduar se përvoja e saj dhe forca shpirtërore e kishin përgatitur për çdo vështirësi apo fatkeqësi që mund të sillte jeta.

Megjithatë, pas shumë vjetësh me probleme shëndetësore dhe paaftësi fizike, gjendja e saj u përkeqësua ndjeshëm në vitin 2023, kur pas një operacioni të vështirë në veshka humbi pjesën më të madhe të funksionit të këmbëve, duke e lënë pothuajse të palëvizshme dhe plotësisht të varur nga ndihma e të tjerëve.

Ajo gjithmonë kishte besuar se tre djemtë e saj, më i madhi 45 vjeç, ndërsa binjakët 35 vjeç dhe vajza e saj do të ishin pranë saj dhe do ta ndihmonin në pleqëri, ashtu siç ndodh shpesh në familjet tradicionale. Por realiteti i luftës ia ka shkatërruar këto pritshmëri: ajo i sheh shumë rrallë tre djemtë e saj, sepse të tre ndodhen në vijat e frontit duke luftuar, ndërsa vitin e kaluar vajza e saj u detyrua të largohej nga Ukraina, pasi presioni psikologjik dhe stresi ishin bërë të padurueshëm për të.

Dikur zonja Rybak ishte në gjendje të flinte edhe gjatë alarmeve ajrore, sikur trupi dhe mendja e saj të ishin mësuar me rrezikun e vazhdueshëm, por tani kjo është e pamundur. Alarmet zgjasin ndonjëherë deri në 10 orë rresht, duke e lënë të zgjuar, të tensionuar dhe të mbërthyer nga frika për një kohë të gjatë.

“E vetmja gjë që dua tani është pak paqe, qoftë edhe një grimcë e vogël e saj”, tha ajo me zë të lodhur. “Shëndeti im po keqësohet dita-ditës. Ndihem sikur forca ime ka rënë në zero. Nuk ka më asnjë fuqi të mbetur”.

*Përktheu: Blerta Haxhiu*






**Autor: Jeton Mikullovci**

EDITORIAL I GAZETËS FRANCEZE "LE MONDE"

# Rikthimi i imperializmit grabitqar amerikan

**Sulmi ushtarak amerikan në Karakas të Venezuelës dhe kapja e Nicolas Maduros tregojnë se Uashingtoni tani pretendon të drejta të plota mbi atë që e konsideron oborrin e vet**

PARIS, 5 JANAR - Ndoshta qeshëm para kohe me vullnetin e Donald Trumpit për ta riemërtuar Gjirin e Meksikës me emrin "Gjiri i Amerikës", kur ai sapo u rikthye në Shtëpinë e Bardhë, një vit më parë. Sulmi i ushtrisë amerikane në Karakas, në Venezuelë, natën e 2-3 janarit, dhe rrëmbimi i Nicolas Maduros tregojnë se Uashingtoni tashmë pretendon të gjitha të drejtat në atë që e konsideron si "oborrin e pasmë të shtëpisë së vet".

Përmes këtij operacioni, të justifikuar me akuzën e paqartë të "narkoterrorizmit", Shtetet e Bashkuara po i imponojnë kontinentit amerikan një kthim pas prej më shumë se një shekulli, kësaj here me forcën e një superfuqie ushtarake. Duke përmendur me një ngulmim të sikletshëm naftën venezuelase gjatë konferencës për shtyp, Donald Trump deshi të theksonte se ky imperializëm i ri amerikan është po aq grabitqar sa ai i së kaluarës.

Nicolas Maduro ka kontribuar jo pak në këtë situatë. Duke u mbajtur në pushtet me çdo mjet, përfshirë terrorin, pasi kishte humbur qartazi zgjedhjet presidenciale të vitit 2024, ai e zhveshi veten nga sadopak legjitimitet popullor që i kishte mbetur. Si shkaktar i një vale migratore që ka prekur gjithë kontinentin amerikan, bilanci i tij katastrofik, në krye të një vendi të pasur me hidrokarbure, por të varfëruar sa nga një ideologji shterpë, po aq edhe paaftësia, dhuna dhe korrupsioni, prej kohësh fliste në favor të largimit të tij.

Megjithatë, brutaliteti i një pushteti nuk mund të justifikojë gjithçka. Nëse vendos në peshore të gjitha pasojat, askush s'mund të kënaqet me një përmbysje të tillë, përmes forcës. E para ka të bëjë, natyrisht, me venezuelasit, të cilët mësuan më 3 janar se Uashingtoni kishte ndërmend tashmë të drejtonte vendin e tyre pa ua kërkuar mendimin dhe për një periudhë të pacaktuar. Interesat e Shteteve të Bashkuara, ashtu siç i koncepton Donald Trump, mbizotërojnë mbi vullnetin popullor venezuelas, mbi sovranitetin e vendit dhe mbi shqetësimin për ringjalljen e një demokracie të martirizuar nga vite të gjata diktature. Të gjitha këto shqetësime thelbësore kalojnë, në sytë e Trumpit, pas interesave të kompanive amerikane të naftës.

E drejta është viktima tjetër kolaterale e operacionit amerikan. Nuk bëhet fjalë vetëm për traktatet e së drejtës ndërkombëtare që duhej ta mbronin botën nga ligji i xhunglës i imponuar prej grabitqarëve të mëdhenj. Donald Trump shkeli po aq edhe Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara, e cila parashikon se vetëm Kongresi mund të shpallë luftë.

Përpjekja për ta paraqitur një plan për ndryshim regjimi si një operacion të thjeshtë policor, me qëllim që një i dyshuar të nxirret para gjykatave amerikane, mund t'i kënaqë vetëm ata që nuk e çajnë kokën fare për ligjin amerikan. Ky duket qartazi se ishte rasti i sekretarit të Shtetit, Marco Rubio, i cili ka qenë vetë më parë senator. Në vitin 2003, të paktën, Shtetet e Bashkuara të George W. Bush-it kishin pushtuar Irakun pa mandat ndërkombëtar, por pas votimit të një autorizimi për përdorimin e forcës nga Kongresi.

Ky precedent sjell në vëmendje se çfarë mund të shkaktojnë ndërhyrje brutale, të zhveshura nga legjitimiteti ndërkombëtar, në vende të sfilitura nga një pushtet autoritar. Duhet të jesh i armatosur me një optimizëm të fortë për të imagjinuar se një administratë kaq iste dhe nga etja për grabitje është përgatitur për të gjitha eventualitetet në Venezuelë.

Pushtimi i Irakut mbahet mend si goditja e parë e fortë kundër rendit ndërkombëtar, që Shtetet e Bashkuara kishin vendosur pas Luftës së Dytë Botërore. Ndonëse ky rend u shërbeu megjithatë interesave të tyre, kjo u bë pa shkelur parime të mëdha universale. Ai kishte për bazë një rregullim, ndonëse të papërsosur, por të domosdoshëm, të marrëdhënieve ndërkombëtare. Mes të çarave dhe hapësirave të tij, Vladimir Putini shfrytëzoi rastin për të sulmuar Gjeorgjinë po ashtu edhe Ukrainën, duke mbjellë vdekje dhe shkatërrim.

Nëse precedenti i Karakasit bëhet normë, ata që duan të gjejnë virtyte te topuzi amerikan, duke shpërfillur rreziqet e tij, do të pendohen hidhur për këtë mirëkuptim kur interesat e tyre, po aq arbitrarisht, të bëhen pluhur dhe hi. (Lapsi.al)

OPINION

# Ukshin Hoti dhe filozofia e shtetit

**Skender Asani**

Rivlerësimi i mendimit politik të Ukshin Hotit në kontekstin e Kosovës bashkëkohore përbën një domosdoshmëri analitike për studimin e natyrës së shtetësisë së papërmbyllur dhe të sfidave strukturore me të cilat përballet Republika e Kosovës në sistemin ndërkombëtar. Ky rivlerësim nuk synon rehabilitimin simbolik të një figure historike, por përdorimin e mendimit të tij si kornizë teorike për interpretimin e marrëdhënieve ndërmjet sovranitetit, diplomacisë dhe funksionalitetit shtetëror. Ukshin Hoti duhet trajtuar si mendimtar i shtetformimit dhe i realizmit etik, jo si figurë mitike apo referencë emocionale.

Në qendër të filozofisë politike të Ukshin Hotit qëndron koncepti i shtetësisë si proces i vazhdueshëm politik, institucional dhe diplomatik. Për të, shteti nuk është rezultat i një akti juridik të vetëm, por produkt i ndërveprimit të qëndrueshëm midis legjitimitetit të brendshëm dhe pranueshmërisë ndërkombëtare. Në këtë prizëm, shpallja e pavarësisë së Kosovës do të përfaqësonte vetëm një fazë tranzitore drejt konsolidimit të subjektivitetit të plotë ndërkombëtar. Kjo qasje mbetet thelbësore për të kuptuar paradoksin e Kosovës së sotme: një shtet formalisht i pavarur, por ende i sfiduar në kapacitetin e tij për të vepruar si subjekt i barabartë në sistemin ndërkombëtar.

Formimi akademik i Ukshin Hotit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përbën një element thelbësor për të kuptuar orientimin e tij politik dhe diplomatik. Studimet e tij në një mjedis ku politika trajtohet si disiplinë e interesit shtetëror, e balancuar me përgjegjësinë morale dhe rendin institucional, ndikuan drejtpërdrejt në konceptimin e tij mbi shtetin, sovranitetin dhe aleancat strategjike. Hoti nuk e perceptonte politikën si fushë improvizimi apo emocioni kolektiv, por si proces racional të ndërtimit të fuqisë legjitime brenda një rendi ndërkombëtar të strukturuar.

Në këtë kontekst, vlerësimi që Ukshin Hoti i bënte aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishte thelbësisht strategjik dhe jo instrumental. Për të, SHBA-të përfaqësonin jo vetëm mbështetësin kryesor të çlirimit dhe mbijetesës së Kosovës, por aktorin kyç për rrumbullaksimin e shtetësisë së saj në planin ndërkombëtar. Aleanca me Amerikën nuk konceptohej si garanci automatike e suksesit, por si kornizë politike brenda së cilës Kosova duhej të dëshmonte pjekuri shtetërore, qartësi strategjike dhe kapacitet institucional. Hoti e kuptonte se mbështetja amerikane është e qëndrueshme vetëm kur përputhet me një subjekt politik të përgjegjshëm dhe koherent.

Ndryshe nga qasjet pasive që e trajtojnë aleancën me SHBA-të si zëvendësim të vullnetit politik vendor, Hoti e shihte këtë marrëdhënie si partneritet asimetrik, por aktiv. Në këtë partneritet, Kosova duhej të hynte jo si objekt i mbrojtjes ndërkombëtare, por si subjekt që artikulon interesa të qarta dhe të përputhshme me rendin perëndimor. Kjo perspektivë përkon me teorinë e shteteve të vogla në marrëdhëniet ndërkombëtare, sipas së cilës aleancat funksionojnë në mënyrë efektive vetëm kur shteti aleat ruan kapacitetin për të formësuar agjendën e vet strategjike.

Artikulimi i kërkesës për Republikë në vitin 1981 duhet parë edhe në këtë dritë. Ajo nuk ishte akt rebelimi simbolik, por projekt politik i ndërtuar mbi leximin e parimeve të rendit liberal ndërkombëtar dhe të të drejtës për vetëvendosje. Hoti e kuptonte se legjitimiteti i Kosovës nuk mund të mbështetej vetëm në narrativën historike, por duhej të përkthehej në gjuhë politike të kuptueshme dhe të pranueshme për aleatët perëndimorë, veçanërisht për Shtetet e Bashkuara.

Një element qendror i mendimit të tij është perceptimi realist i Serbisë si projekt shtetëror afatgjatë. Hoti e refuzonte interpretimin e Serbisë si regjim kalimtar, duke theksuar kontinuitetin e strategjisë së saj shtetërore. Ky realizëm politik e çonte në përfundimin se çdo dialog me Serbinë, i zhvilluar pa vetëdije të plotë sovraniteti dhe pa mbështetje të qartë strategjike perëndimore, rrezikon të prodhojë asimetri strukturore në dëm të Kosovës.

Në këtë kuptim, dialogu, sipas mendimit të Hotit, nuk duhet të shndërrohet në proces të menaxhimit teknik të konfliktit, por të mbetet instrument për përmbylljen e tij. Çdo negociatë që relativizon subjektivitetin shtetëror ose e trajton sovranitetin si çështje të hapur kompromisi përbën regres në procesin e shtetndërtimit. Ky parim ofron një kriter akademik për vlerësimin e dialogut Kosovë–Serbi dhe të rolit të ndërmjetësimit ndërkombëtar.

Një tjetër dimension thelbësor i mendimit të Ukshin Hotit është mosndarja artificiale midis politikës së brendshme dhe asaj të jashtme. Për të, fragmentarizimi i brendshëm në çështjet e sovranitetit përbën dobësi strukturore dhe jo pluralizëm funksional. Konsensusi minimal shtetëror mbi integritetin territorial dhe rendin kushtetues është parakusht për çdo veprim diplomatik efektiv, veçanërisht në raport me aleatët strategjikë.

Në përmbyllje, mendimi politik i Ukshin Hotit ofron një sintezë të qartë parimesh për rrumbullakimin shtetëror të Kosovës: shtetësia nuk konsolidohet me deklarata, por me disiplinë politike; nuk mbrohet me improvizim, por me strategji; nuk përmbyllet me dialog të paorientuar, por me vetëdije të plotë sovraniteti. Mesazhi hotian është i prerë: Kosova duhet të veprojë si shtet, përpara se të kërkojë të trajtohet si i tillë. Kjo nënkupton konsensus minimal të brendshëm mbi integritetin territorial dhe rendin kushtetues, artikulim të qartë të interesave kombëtare në raport me Serbinë, dhe një aleancë aktive e jo pasive me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të konceptuar si partner strategjik në përmbylljen e subjektivitetit ndërkombëtar. Në logjikën e Hotit, Perëndimi nuk e ndërton shtetin në vend të Kosovës; ai e mbështet atë vetëm nëse Kosova dëshmon pjekuri shtetërore, qartësi konceptuale dhe guxim moral. Alternativa është e njohur dhe historikisht e rrezikshme: ose Kosova flet dhe vepron si subjekt sovran me orientim të qëndrueshëm perëndimor, ose mbetet çështje e hapur, e menaxhuar nga të tjerët. Ky është testi hotian i shtetësisë dhe ende mbetet i hapur.

*(Marrë nga "Javanews")*

OPINION

# Shërbimi Inteligjent Evropian, koha e maturisë strategjike të BE-së

**Evarist Beqiri**

Propozimi i presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, për ngritjen e një Njësie të re Inteligjence pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komisionit është një sinjal serioz për fazën e re ku po hyn Bashkimi Evropian. BE po kalon në fazën e maturimit strategjik. Evropa po kërkon të parandalojë goditjen e radhës.

Pyetja që shtrohet është, se si mund të ndërtohet ky shërbim informativ pa cenuar sovranitetin e shteteve anëtare?! Bazuar në përvojat e strukturuara të vendeve kryesore evropiane, arkitektura aktuale e inteligjencës në BE nuk është më e përshtatshme për rreziqet e shekullit XXI. Nga ana tjetër, BE nuk vuan nga mungesa e informacionit, por nga mungesa e kohezionit.

Evropa prodhon shumë informacion, por shumë pak strategji. Ka shumë agjenci dhe shumë protokolle. Ka pak centralizim, pak standardizim dhe pak përgjegjshmëri.

Sistemi aktual përbëhet nga INTCEN, Europol, ENISA dhe strukturat e mbrojtjes kibernetike. Njëzetë e shtatë shërbimet kombëtare kanë kultura, prioritete dhe kufizime të ndryshme. Sistemi nuk funksionon si një arkitekturë e integruar strategjike.

Në kushtet e sotme gjeopolitike, ndryshimi është domosdoshmëri. Lufta në Ukrainë e ka shkatërruar iluzionin e sigurisë evropiane. Rreziku i një tërheqjeje të pjesshme amerikane nga mbrojtja evropiane po e çon BE-në drejt autonomisë strategjike. Kërcënimet hibride, nga ndërhyrjet kibernetike deri te operacionet e influencimit, nuk i respektojnë kufijtë kombëtarë. Ato nuk i përshtaten as modelit tradicional të inteligjencës së decentralizuar.

Duhet të qartësojmë se propozimi nuk bën fjalë për krijimin e një shërbimi informativ klasik, pra një "CIA evropiane". Nuk flitet për një strukturë operative që mund të përplaset me shërbimet kombëtare. Flitet për një qendër të nivelit strategjik.

Megjithatë, një sistem inteligjence ka nevojë për një mekanizëm të posaçëm për mbikëqyrjen. Ai duhet që të jetë i ngjashëm me komisionet parlamentare kombëtare. Ky mekanizëm është i domosdoshëm, sepse siguron legjitimitet demokratik, garanton proporcionalitetit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Njëkohësisht, ai parandalon abuzimet politike. Pa këto element çdo reformë e inteligjencës evropiane do të ngjall dyshim të madh në opinionin publik.

BE duhet të zgjedhë mes copëzimit apo fuqisë. Debati rreth krijimit të një shërbimi inteligjent evropian është një çështje politike madhore. Ai lidhet me pyetjen ekzistenciale, nëse BE dëshiron që të jetë thjesht një treg apo një fuqi?!

Nëse Evropa synon autonomi strategjike të vërtetë, ajo ka nevojë për një qendër komande të përbashkët. Pa analizë të integruar, nuk ka parandalim. Pa parandalim, nuk ka siguri. Kompetencat e ndara e bëjnë Bashkimin Evropian të dobët. Jo sepse shtetet anëtare janë të vogla, por sepse ato nuk mendojnë së bashku si një organizëm unik.

Njësia e propozuar është një hap i parë i drejtë, por jo i mjaftueshëm. BE-së i duhet një arkitekturë strategjike e unifikuar. Një mekanizëm mbikëqyrës i pavarur dhe një kulturë e re inteligjence. Siguria duhet parë si një përgjegjësi e përbashkët, jo si një monopol kombëtar.

Në epokën e rreziqeve të përditshme, Evropa nuk mund të lejojë më luksin e moskoordinimit. Nëse kontinenti dëshiron të mbijetojë politikisht dhe strategjikisht, ai duhet që të mendojë si një trup i vetëm. Dhe inteligjenca është vendi nga ku ky transformim duhet të fillojë.

Njësia e inteligjencës në Komision paraqitet si zgjidhje ndaj rreziqeve hibride, infiltrimeve ruse, presionit kinez dhe mungesës së paralajmërimit strategjik. Por realiteti tregon se, problemi i BE-së nuk është mungesa e strukturave. Është mungesa e besimit dhe integrimit. Që njësia e re e inteligjencës të mos jetë një fasadë, duhet një ndryshim konceptual.

Evropa ka INTCEN. Ka EUMS INT. Pra, ka mekanizma. Ajo që mungon është një analizë e unifikuar. Mungon një kulturë strategjike dhe një ambient ku shtetet t'i besojnë mjaftueshëm njeritjetrit për të ndarë inteligjencë me peshë. BE nuk vuan nga boshllëku institucional, por nga boshllëku analitik. BE vuan nga fragmentimi, jo nga mungesa e strukturave.

INTCEN dhe EUMS INT funksionojnë si dy botë paralele. Kanë dy lidershipe dhe dy cikle prodhimi. Të dyja kanë ekspertizë, por asnjëra nuk ka autoritetin e duhur për të prodhuar një pamje të unifikuar strategjike të Evropës. Në fakt, Evropa ka inteligjencë. Ajo që mungon është sinteza.

Zgjidhja e propozuar duket se diagnostikon simptomat, por nuk shëron sëmundjen. BE nuk ka integrim analitik. Nuk ka kulturë të përdorimit të inteligjencës në vendimmarrje. Nuk ka peshë politike dhe mekanizmat për t'i detyruar shtetet që të ndajnë të dhëna thelbësore. Nuk ka garanci se informacioni i ndarë nuk do të përdoret politikisht. Dhe mungon ritmi strategjik për ta përfshirë inteligjencën në politik-bërje.

Inteligjenca është zemra e sovranitetit kombëtar. Nuk ndahet lehtë. Nuk centralizohet shpejt. Në fushat ku BE ka më shumë nevojë për informacion si, energjia, ekonomia, politika e brendshme dhe rreziqet hibride, shtetet anëtare janë më pak të gatshme ta ndajnë atë. Asnjë logo e re në Bruksel nuk mund ta ndryshoj lehtësisht këtë psikologji.

BE-ja ngriu së fundmi 247 miliardë dollarë asete ruse. Ky vendim ka hapur rrugën për një hua gati 200 miliardë dollarëshe për Ukrainën. Kjo garanton financim shumëvjeçar të Ukrainës, pavarësisht mbështetjes nga Uashingtoni.

Për herë të parë që nga fillimi i luftës, është Evropa dhe Ukraina, jo SHBA-të, që do të kenë më shumë ndikim në përcaktimin e fatit të luftës. Megjithatë, kjo rritje e peshës gjeopolitike përkon me një moment të brishtë për vetë BE-në. Sepse kemi ekonomi të ngadalta. Politikë të përçarë. Kapacitete mbrojtjeje të dobëta. Presion amerikan që ushqen euroskepticizmin. Pyetja që ngrihet natyrshëm është, si mund të pretendojë Evropa një rol strategjik në luftë, nëse mbetet e verbër në inteligjencë?

Një "njësi e re" nuk do ta ndryshoj këtë realitet psikologjik dhe politik. Por, nëse nxjerrim një mësimi nga NATO. Ai është që bashkimi funksionoi, sepse u bashkuan strukturat, jo sepse u shtuan. Zgjidhja nuk ishte krijimi i një agjencie të tretë, por shkrirja e plotë e tyre.

Ndërkohë, NATO dhe BE duhet të integrojnë më mirë kapacitet e tyre të inteligjencës. Çështjet e sigurisë nuk duhet të instrumentalizohen nga politika. Evropës i duhen aftësi reale, jo struktura boshe.

*(Marrë nga "Balkanweb")*

**Vështrimet dhe opinionet e shprehura në këtë faqe nuk përfaqësojnë qëndrimet e redaksisë.**

KOHA DITORE

E përditshme e pavarur informative

**Themelues:** Veton SURROI
**Numri i parë u botua më 31 mars 1997**

**Pronare dhe botuese:**
Flaka SURROI

**Redaksia**

**Kryeredaktore:**
Brikenda REXHEPI

**Zëvendëskryeredaktor:**
Elmaz ISUFI

**Ndihmëskryeredaktor/**
**Redaktor i kulturës:**
Granit KURTI

**Redaktorë përgjegjës:**
Driton MEHMETI
Visar LOCI
Nita LLESHI-DOBROSHI
Besnik KRASNIQI

**Redaktorë në Portal:**
Endrit BERISHA
Shkumbin SEKIRAQA
Nora SHABANI-HYSENI
Besjana BAJRAMI-POLISI

**Redaktorë/Autorë:**
Mimoza KOPRANI-MUÇAJ
Eraldin FAZLIU
Donika VOCA-GASHI

**Ndihmësredaktore:**
Minushe REXHEPI

**Redaktor i sportit:**
Arsim MAXHERA

**Redaktor i mediave sociale/i qendrës grafike**
Ben KAJTAZI

**Fotografia:**
Driton PAÇARADA

**Adresa:**
**KOHA**
Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë)
Xhorxh Bush p.n.
10000 Prishtinë

**Fahu postar** 202

**Telefonat:**
(00 383 38) 249-104 249-105;
249-106; 248 014 dhe 248 015

**e-mail:**
redaksia@kohaditore.com;
lajmet@kohavision.net; info@koha.net

**Marketing dhe shitje KOHA**
(KOHA Ditore; KTV, Koha.net,
ARTA dhe KOHA Print):
**tel:** (00 383 38) 249-104; 249-105;
249-106; 248 014 dhe 248 015
**e-mail:** marketing@koha.net
berat@koha.net, afrim@koha.net
marketing@kohaditore.com

**Xhirollogaria**:
**ProCredit** - 1110086926000189
**NLB** - 1701001010645930
**TEB** - 2011000000081423
**Raiffeisen** - 1501001002095874
**BKT** - 1901217632031247
**B. Ekonomike** - 1401000000903831
**BpB** - 13002712000030870

**Shtypshkronja "KOHA Print"**
045 701 288

**Marketingu për jashtë:**
Era Press GmbH
Sihlstrasse 38 CH-8001 Zürich
Tel.+41(0) 43 497 32 80
koha@erapress.ch

Nuk lejohet ribotimi i pjesshëm apo i plotë, në cilindo medium, i cilitdo material për të cilin KOHA (KOHA Ditore, KTV, KOHA.net, ARTA) i mban të drejtat e rezervuara, pa autorizimin paraprak me shkrim nga KOHA.

**Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen**

Rubrika e përhershme "Shprehu" është krijuar si hapësirë e "Kohës Ditore" për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve. Të gjitha shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se 500 fjalë. Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PER SHERBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

ARRU

31. 12. 2025

Në mbështetje të nenit 19, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016, datë 14. 01. 2016, dhe komfor nenit 29 të Rregullores së ARRU Nr. 12/2020 për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë, datë qershor 2020, si dhe rezultatet finale nga kalkulimet, përmes aplikacionit tarifor të DT, për tarifat gjegjëse të shërbimeve, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, merr këtë:

## VENDIM

**për miratimin e urdhëresës së tarifave të shërbimeve (UTSH)**

919
D
31.12.2025

1. Miratohet Urdhëresa Tarifore e Shërbimeve (UTSH) e KRU "Prishtina" sh. a Prishtinë (ARRU/UTSH-18/01/2026), për aktivitetet themelore të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.
2. Lartësia e tarifave përfshinë vetëm vlerën faturale (përjashtohet TVSH), për shërbimet themelore.
3. Monitorohet për së afërmi realizimi i investimeve kapitale të aprovuara nga ARRU, dhe do të ndërmerren veprime komfor nenit 10, të Rregullores 12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë.
4. ARRU mund të bëjë korrigjime të jashtëzakonshme të UTSH, me kërkesë të KRU "Prishtina" sh. a, në përputhje me nenin 47 të *Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe* në pajtim me nenin 30 dhe 31 të Rregullores 12/2020 Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë.
5. KRU "Prishtina" sh. a. duhet të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë UTSH, tek secili Konsumator, në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në fillim të aplikimit të saj t'i bashkëngjis të njëjtën, faturës të konsumatorëve.
6. Lista e Tarifave për Shërbime, e aprovuar nga ARRU me këtë UTSH, duhet të publikohet nga KRU "Prishtina" sh. a., së paku në njërën prej gazetave ditore me tirazh gjithë përfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU ueb faqen: www.arru-rks.org;
7. Kjo UTSH publikohet në tre (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze. Në rast mospërputhje në mes të versioneve (për gjuhët e përdorura) të UTSH-ës, do të mbizotërojë versioni i shkruar në Gjuhën Shqipe.
8. UTSH, hyn në fuqi më 1 janar 2026 dhe se vlen vetëm për vitin fiskal 2026 (01.01-31.12.2026).

**Këshillë juridike**: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi me shkrim.*

Dërguar:
1 x 1 Arkivit të ARRU
1 x 1 Departamenti i Tarifave
1 x 1 Krye shefit Ekzekutiv të KRU-së

Hajrije Morina
Drejtoreshë e ARRU

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
Adresa: Rr. Gazmend Zajmi nr. 85-87, Prishtinë
Tel. +383 38 200 62 900; +383 45 999 630
http://www. arru-rks.org

ARRU/UTSH-18/01/2026

# URDHËRESË TARIFORE E SHËRBIMEVE

## KRU "PRISHTINA" SH. A PRISHTINË PËR VITIN 2026

1. **Tarifat fikse dhe volumetrike për aktivitetet themelore të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura**

| Kategoria e Konsumatorëve | Njësia | Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujësjellësit | Tarifa Volumetrike për Shërbimet e ujërave të ndotura |
|---|---|---|---|
| Shtëpiak | EUR/$m^3$ | 0.6345 | 0.1279 |
| Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional) | EUR/$m^3$ | 0.8248 | 0.2813 |

2. **Tarifa fikse mujore**

| Diametri i kyçjes në rrjetin shpërndarës | Njësia | Vlera |
|---|---|---|
| Konsumatorët vetëm me lidhje të ujërave të ndotur | EUR/kons/muaj | 0.6520 |
| 15mm | EUR/kons/muaj | 1.3040 |
| 20mm | EUR/kons/muaj | 1.3040 |
| 25mm | EUR/kons/muaj | 2.0864 |
| 32mm | EUR/kons/muaj | 2.0864 |
| 40mm | EUR/kons/muaj | 8.4500 |
| 50mm | EUR/kons/muaj | 8.4500 |
| 65mm | EUR/kons/muaj | 20.8642 |
| 80mm | EUR/kons/muaj | 20.8642 |
| 100mm | EUR/kons/muaj | 25.6630 |
| 125mm | EUR/kons/muaj | 25.6630 |
| 150mm | EUR/kons/muaj | 40.4765 |
| 200mm | EUR/kons/muaj | 40.4765 |
| 250mm | EUR/kons/muaj | 56.3333 |

3. **Tarifat për aktivitetet themelore të lidhjes së konsumatorëve në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit**

**3.1 Tarifa për inspektimin e lidhjes së re në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit**

| Kategoria e Konsumatorëve | Diametri i gypit të lidhjes | Njësia | Vlera |
|---|---|---|---|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve | EUR/konsumator | 10.00 |

***Shënim:***

1. *Pasi që kjo tarifë përfshinë kryesisht shpenzime fikse, atëherë e njëjta shumë (d.m.th. 10 EUR) do të paguhet kur inspektimi: (i) për lidhjet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, kur ekzistojnë të dyja bashkë; dhe (ii) kur ekziston kërkesa vetëm për njërin shërbim.*
2. *Kjo tarifë nuk aplikohet kur lidhja e re realizohet nga Kompania, me ç 'rast duhet të aplikohet vetëm tarifa: "Tarifat për realizmin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit".*
3. *Kjo tarifë nuk aplikohet në rastet kur lidhja e re realizohet nga kompanitë e autorizuara përmes donacioneve, pasi që tërë projekti (përfshirë edhe lidhjet) i nënshtrohen pranimit teknik.*

**3.2 Tarifat për realizmin fizik të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit**

| Kategoria e Konsumatorëve | Diametri i gypit të lidhjes | Tarifa e lidhjes (pa pusetë)* (EUR) | Tarifa e lidhjes (me pusetë, pa asfaltim)** (EUR) | Tarifa totale (lidhja, puseta, asfaltimi)*** (EUR) |
|---|---|---|---|---|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional) | 15 mm | 80.00 | 240.00 | 490.00 |
| | 20 mm | 80.00 | 240.00 | 490.00 |
| | 25 mm | 100.00 | 260.00 | 510.00 |
| | 32 mm | 140.00 | 300.00 | 550.00 |
| | 40 mm | 180.00 | 340.00 | 590.00 |
| | 50 mm | 370.00 | 530.00 | 780.00 |
| | 65 & 75 mm | 490.00 | 650.00 | 900.00 |
| | 80 mm | 625.00 | 785.00 | 1,035.00 |
| | 100 mm | 780.00 | 940.00 | 1,190.00 |

**Shënim:**
**Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusetës)*
***Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusetës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim*

****Aplikohet në rastet kur gypi i shërbimit gjendet në rrugë apo trotuar kur Kompania pas punimeve është e obliguar të e kthej rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.*

**3.3 Tarifat për realizmin fizik të lidhjes në rrjetin e kanalizimit**

| Kategoria e Konsumatorëve | Diametri i gypit të lidhjes | Tarifa e lidhjes (pa pusetë)* (EUR) | Tarifa e lidhjes (me pusetë, pa asfaltim)** (EUR) | Tarifa totale (lidhja, puseta, asfaltimi)*** (EUR) |
|---|---|---|---|---|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional) | 160 mm | 26.00 | 153.00 | 403.00 |
| | 200 mm | 36.00 | 163.00 | 413.00 |
| | 250 mm | 46.00 | 173.00 | 423.00 |
| | 315 mm | 76.00 | 203.00 | 453.00 |

**Shënim:**
**Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh vetëm realizimin e lidhjes (pa përfshirë ndërtimin e pusetës)*
***Aplikohet në rastet kur konsumatori zgjedh realizimin e lidhjes dhe ndërtimin e pusetës, ndërsa nuk ka kërkesë për asfaltim*
****Aplikohet në rastet kur puseta gjendet në rrugë apo trotuar kur Kompania pas punimeve është e obliguar të e kthej rrugën apo trotuarin në gjendjen e mëparshme.*

**3.4 Tarifa për ndërprerjen e përkohshme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit**

| Kategoria e Konsumatorëve | Diametri i gypit të lidhjes | Njësia | Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim |
|---|---|---|---|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional) | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve | EUR/konsumator | 10.00 |

**3.5 Tarifa për ndërprerjen e përhershme të lidhjes në rrjetin e ujësjellësit**

| Kategoria e Konsumatorëve | Diametri i gypit të lidhjes | Njësia | Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim |
|---|---|---|---|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional) | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve | EUR/konsumator | 20.00 |

**3.6 Tarifa për ri-lidhje në rrjetin e ujësjellësit (pas ndërprerjes së përkohshme)**

| Kategoria e Konsumatorëve | Diametri i gypit të lidhjes | Njësia | Tarifa për ujësjellës dhe kanalizim |
|---|---|---|---|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional) | Për të gjitha dimensionet e gypave shpërndarës /grumbullues dhe ujëmatësve | EUR/konsumator | 10.00 |

4. **Tarifat për aktivitetet tjera themelore të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura**

**4.1 Testimi i ujëmatësit për siguri të matjes**

| Kategoria e Konsumatorëve | Diametri i ujëmatësit | Tarifa për ujësjellës (EUR) |
|---|---|---|
| Shtëpiak dhe Jo-shtëpiak (komercial dhe Institucional) | 20 mm | 16.50 |
| | 25 mm | 16.50 |
| | 32 mm | 16.50 |
| | 40 mm | 18.00 |
| | 50 mm | 18.00 |
| | 63 mm | 18.00 |
| | 75 mm | 19.00 |
| | 90 mm | 19.00 |
| | 110 mm | 19.00 |

**Shënim**: *Kjo tarifë aplikohet komfor nenit 28 të Rregullores 10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.*

5. Tarifa e mbi-ngarkesës (përforcimit) së infrastrukturës

| *Kategoria e shërbimit* | *Njësia* | *Vlera* |
|---|---|---|
| *Ujësjellës* | *EUR/konsumator* | 135.6173 |
| *Kanalizim* | *EUR/ konsumator* | 99.1049 |

Tarifa e mbi-ngarkesës zbatohet për çdo konsumator të ri që kyçet në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit sipas letrës zyrtare të ARRU me nr prot. 983/D, datë 25.11.2024.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024, Plotësim ndryshimin e UA 03/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik, Kodin e punës nr. 804 të datës 28.01.2025 të KEKsh.a, si dhe bazuar në skemën organizative aktuale në fuqi dhe nevojës për plotësimin e kuadrit në Divizionin e Shërbimeve të Korporatës në KEK.sha, UD Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut autorizon Burimet Njerëzore, më 05.01.2025, të publikojnë ofertën për poziten e mëposhtme:

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
05 -01- 2026
Nr. 25
PRISHTINË - A

# KONKURS

**Titulli i pozitës:** **Drejtor i Burimeve Njerëzore**

**Institucioni:** Korporata Energjetike e Kosovës
**Numri i referencës:** 01-05.01.2026
**Tipi Akt Emërimit të punës:** Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA 01/2024, plotësim ndryshimi i UA 03/2024 dhe KP të KEK-ut
**Titulli i mbikëqyrësit:** I raporton Drejtorit Ekzekutiv të Shërbimeve të Korporatës
**Kohëzgjatja e kontratës:** 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
**Koeficienti-paga**: 1990 Euro
**Procedura e aplikimit**: I jashtëm
**Numri i kërkuar**: 1
**Vendi i punës**: Korporata Energjetike e Kosovës, Prishtinë

**Përmbledhgje e shkurtë e vendit të punës:**
Bartësi i vendit të punës është përgjegjës për menaxhim të suksesshëm të Burimeve Njerëzore në Korporatën Energjetike të Kosovës, ku përfshihet: vlerësimi i vendeve të punës, caktimi i personelit, punësimi, trajnimi, zhvillimi i karrierës, kompensimi, vlerësimi i performancave, sistemet e shpërblimit, etj. Bashkëpunon ngushtë me Menaxhmentin e Lartë të KEK-ut dhe institucionet relevante të vendit.

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**
- Zhvillimi, koordinimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të strategjisë dhe politikave të burimeve njerëzore në përputhje me objektivat strategjike të kompanisë.
- Sigurimi i burimeve njerëzore adekuate (numri, aftësitë dhe kuadrot kyçe) për funksionimin dhe zhvillimin e kompanisë.
- Menaxhimi strategjik i proceseve të rekrutimit, përzgjedhjes dhe punësimit të stafit.
- Zhvillimi dhe mbikëqyrja e sistemeve të menaxhimit të performancës dhe vlerësimit të punonjësve.
- Zhvillimi, koordinimi dhe ofrimi i programeve të trajnimit dhe zhvillimit për punonjësit.
- Administrimi i punonjësve (mirëmbajtja e të dhënave të stafit, procesi i pushimeve dhe kërkesave të punonjësve të tjerë, etj.).
- Zhvillimi dhe menaxhimi i sistemeve të pagave, përfitimeve dhe kompensimeve, përfshirë buxhetin dhe monitorimin e tij.
- Mbikëqyrja dhe udhëheqja e ekipit të Burimeve Njerëzore dhe administrimi i softuerit e sistemeve për menaxhimin e stafit. Gjithashtu përgjegjës për kontrollin e kohës dhe frekuentimin e punonjësve.
- Këshillimi i menaxhmentit të lartë për çështje të marrëdhënieve të punës, përfshirë masat disiplinore dhe zgjidhjen e konflikteve.
- Sigurimi i përputhshmërisë së kompanisë me legjislacionin e punës dhe rregulloret në fuqi, përfshirë shqyrtimin e kërkesave për shkeljet e punës brenda procesit të masave disiplinore sipas rregulloreve të brendshme.
- Zhvillimi i strukturës organizative, përshkrimeve të vendeve të punës dhe grafikut organizativ.
- Menaxhimi i marrëdhënieve me sindikatat dhe negocimi i marrëveshjeve kolektive.
- Kryerja e detyrave të tjera në përputhje me pozitën, sipas kërkesës së menaxhmentit.

**Autorizimet:** Në harmoni me Rregulloret e KEK-ut dhe nivele tjera të autorizimeve të caktuara kohë pas kohe.

**Kërkesat profesionale/Kualifikimet**
- Diplomë universitare në: Menaxhim të Burimeve Njerëzore, Juridik, Administrim Biznesi, Ekonomi, Administratë Publike, Psikologji, Sociologji.
- Të paktën 8 vite përvojë pune profesionale në fushat e lartpërmendura
- Të paktën 5 vite përvojë pune në nivel menaxherial

**Aftësitë dhe njohuritë e pritshme:**
- Njohuri të shkëlqyera të menaxhimit të kapitalit njerëzor dhe praktikave më të mira të BNJ-së.
- Njohuri të thella të legjislacionit për burimet njerëzore, përfshirë Ligjin e Punës, Ligjin për Shërbimin Civil, Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë dhe legjislacionin përkatës dytësor.
- Përvojë në zbatimin dhe interpretimin e politikave të BNJ dhe këshillimin e menaxherëve.
- Aftësi për të menaxhuar organizata komplekse me mbi 1000 punonjës, duke ruajtur fokusin strategjik.
- Qasje sistematike dhe aftësi vendimmarrëse, duke marrë parasysh opsionet dhe rreziqet.
- Orientim i qartë ndaj zhvillimit dhe trajnimit të stafit, me integritet dhe etikë profesionale.
- Kompetenca për të ndërtuar dhe menaxhuar marrëdhënie nderpersonale në të gjitha nivelet e kompanisë.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi verbal dhe me shkrim.
- Njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe angleze
- Njohuri dhe aftësi në përdorimin e teknologjive bazë dhe pakos Microsoft Office (Word, Excel, PowerPoint).

**Dokumetet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:**
Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

a. Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: **"Ngarko Aplikacionin e plotësuar"**
b. Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomë universitare në:** Menaxhim të Burimeve Njerëzore, Juridik, Administrim Biznesi, Ekonomi, Administratë Publike, Psikologji, Sociologji, e skanoni në një dokument të vetëm dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online te vegëza **"Ngarko dëshmitë e kualifikimit"** si dhe
c. **Dëshminë e përvojës se punës** e dokumetoni me kontratë pune dhe e ngarkoni te vegëza **"Ngarko dëshmitë për përvojë".**

Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

**Mënyra e aplikimit:**
Aplikimi është online, ngarkoni dokumentet sipas kërkesave në konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuar vetëm nëse e merrni e-mailin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri në aplikim kontaktoni në numrin e telefonit: 038 501-401-2671, por mund të shkruani edhe në e-mailin (ofertapune@kek-energy.com) për të vërtetuar aplikimin tuaj (vetëm nëse nuk keni pranuar e-mailin konfirmues).

**Njoftimi me rezultatin e konkursit publik**:
Kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi duke e respektuar Udhëzimin Administrativ nr. 01/2024, plotesim ndryshimin e UA nr 03/2024 dhe Kodin e punës nr. 804 te datës 28.01.2025 për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

**Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:**

| | |
|---|---|
| Intervista vlerësohet deri në shtatëdhjetë | (70) pikë |
| Jetëpërshkrimi (CV) vlerësohet deri në tridhjetë | (30) pikë |

**KEK-u fton të gjithë të interesuarit, në veçanti gjininë femërore, të aplikojnë për poziten e publikuar.**
Për më shume informata për poziten e lartpërmendur vizitoni web-faqen: www.kek-energy.com, ikona *'Shpallje'* dhe mund ta shkarkoni **aplikacionin** për pozitën qe aplikon.

Në rast të pikëve të barabarta në fund të procesit të intervistimit dhe vlerësimit të CV-së, përparësi do të kenë kandidatët nga komuna e Obiliqit dhe zonat tjera të rrezikuara konform ligjit nr. 05/l-044.

**Vërejtje:**
Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes si në vijim: **Nëse nuk e deklaroni që anëtari i familjes së ngushtë ju punon në KEK, në cilëndo fazë që vërtetohet, aplikacionet e juaja do të refuzohen.** Aplikacionet pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen. Kandidati i suksesshëm do të sistemohet në pozitën për të cilën ka aplikuar sipas kësaj shpalljeje dhe për pozita pune që ka mungesë të theksuar të punëtorëve nuk do të mund të propozohen për caktim në pozita tjera pa arritur kohen prej tri (3) vite përvojë pune.

Kalendari i përafërt: brenda 25 ditësh intervistat me gojë dhe njoftimi final brenda 30 ditësh nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA 01/2024, plotësim ndryshimi i UA 03/2024 dhe Kodit te punës nr. 804 te datës 28.01.2025.

**Data e aplikimit deri më 20.01.2026 ora 24:00**
**Prishtinë, 05.01.2026**

**Divizioni i Shërbimeve të Korporatës**

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a. - KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. - KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d. • PRISHTINË-A

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03/L-212, član 5. Upravnog uputstva br. 01/2024, Dopuna amandmana UA 03/2024 o uređenju konkurencije u javnom sektoru, Zakonik o radu br. 804 od 28.01.2025. godine KEK.d.d, kao i na osnovu trenutne organizacione šeme koja je na snazi i potrebe za popunjavanjem osoblja u Sektoru korporativnih usluga u KEK.d.d, izvršni direktor VD KEK-a ovlašćuje Ljudske Resurse, 05.01.2025. godine, da objavi ponudu za sledeće radno mesto:

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
05 -01- 2026
Nr. 25
PRISHTINË - A

# KONKURS

**Naziv pozicije:** **Direktor za Ljudske Resurse**

**Institucija:** Korporacija Energetike Kosova
**Poziv na broj:** 01-05.01.2026
**Vrsta Zakon o imenovanju posla:** Prema Zakonu o radu 03/L-2012, UA 01/2024, dopuna izmena UA 03/2024 i KZ KEK
**Naziv supervizora:** Izveštaji izvršnom direktoru korporativnih usluga
**Trajanje ugovora:** 1 (jedna) godina sa mogućnošću nastavka, dok je probni rad 6 (šest) meseci.
**Koeficijent-plata**: 1990 evra
**Postupak prijave**: Spoljni
**Potreban broj**: 1
**Mesto rada**: Korporacija Energetike Kosova, Priština

**Kratak opis posla:**
Nosilac posla je odgovoran za uspešno upravljanje ljudskim resursima u Korporaciji Energetike Kosova, što uključuje: procenu posla, raspoređivanje osoblja, zapošljavanje, obuku, razvoj karijere, kompenzaciju, procenu učinka, sisteme nagrađivanja, itd. Blisko sarađuje sa višim menadžmentom KEK-a i relevantnim institucijama u zemlji.

**Dužnosti i odgovornosti:**
- Razvoj, koordinacija i nadzor sprovođenja strategije i politika ljudskih resursa u skladu sa strateškim ciljevima kompanije.
- Obezbeđivanje adekvatnih ljudskih resursa (broj, veštine i ključni kadrovi) za rad i razvoj kompanije.
- Strateško upravljanje procesima zapošljavanja, selekcije i zapošljavanja osoblja.
- Razvoj i nadzor sistema upravljanja učinkom i evaluacije zaposlenih.
- Razvoj, koordinacija i pružanje programa obuke i razvoja zaposlenima.
- Administracija zaposlenih (vođenje evidencije osoblja, proces odmora i zahteva drugih zaposlenih, itd.).
- Razvoj i upravljanje platama, beneficijama i kompenzacionim sistemima, uključujući budžet i njegovo praćenje.
- Nadgledanje i vođenje tima za ljudske resurse i administriranje sistemskog softvera za upravljanje osobljem. Takođe je odgovoran za kontrolu vremena i prisustvo zaposlenih.
- Savetovanje višeg menadžmenta o pitanjima radnih odnosa, uključujući disciplinske mere i rešavanje sukoba.
- Obezbeđivanje usklađenosti kompanije sa važećim zakonima i propisima o radu, uključujući razmatranje zahteva za povrede rada u okviru procesa disciplinskih mera u skladu sa internim propisima.
- Razvoj organizacione strukture, opisa poslova i organizacione šeme.
- Upravljanje odnosima sa sindikatima i pregovaranje o kolektivnim ugovorima.
- Obavljanje drugih poslova u skladu sa položajem, na zahtev menadžmenta.

**Ovlašćenja:** U skladu sa KEK propisima i drugim nivoima određenih ovlašćenja s vremena na vreme.

**Profesionalni zahtevi / kvalifikacije**
- Univerzitetsku diplome u: Upravljanje Ljudskim Resursima, Pravo, Poslovna Administracija, Ekonomija, Javna Uprava, Psihologija, Sociologija.
- Najmanje 8 godina radnog iskustva u gore navedenim oblastima
- Najmanje 5 godina radnog iskustva na menadžerskom nivou

**Očekivane veštine i znanja:**
- Odlično poznavanje upravljanja ljudskim kapitalom i najboljih praksi Ljudskih Resursa(LjR).
- Detaljno poznavanje zakonodavstva o Ljudskim Resursima(LjR), uključujući Zakon o Radu, Zakon o Državnoj Službi, Zakon o Bezbednosti i Zdravlju na Radu i relevantno sekundarno zakonodavstvo.
- Iskustvo u implementaciji i tumačenju politika ljudskih resursa i savetovanju menadžera.
- Sposobnost upravljanja složenim organizacijama sa preko 1000 zaposlenih, uz održavanje strateškog fokusa.
- Sistematski pristup i veštine donošenja odluka, uzimajući u obzir opcije i rizike.
- Jasna orijentacija ka razvoju i obuci osoblja, sa integritetom i profesionalnom etikom.
- Kompetentnost za izgradnju i upravljanje međuljudskim odnosima na svim nivoima kompanije.
- Odlične verbalne i pismene komunikacijske veštine.
- Tečno poznavanje albanskog i engleskog jezika
- Znanja i veštine u korišćenju osnovnih tehnologija i Microsoft Office paketa (Word, Excel, PowerPoint).

**Dokumenti koji se moraju dostaviti kao deo prijave i kako ih dostaviti:**
Tokom online prijave, nakon popunjavanja polja sa tačnim i potpunim ličnim podacima, obratite pažnju na sledeće tačke:

a. Popunite prijavu preuzetu sa sajta KEK-a, nakon popunjavanja potrebno ju je učitati u onlajn prijavni formular na link: **"Pošalji popunjenu prijavu"( Ngarko Aplikacionin e plotësuar)**
b. Dokaz o vašoj kvalifikaciji: **Univerzitetska diploma u:** Upravljanje Ljudskim Resursima, Pravo, Poslovna Administracija, Ekonomija, Javna uprava, Psihologija, Sociologija, skenirajte ga u jednom dokumentu, a zatim ga prenesite u online aplikaciju u odeljku **"Otpremite dokaz o kvalifikaciji"( Ngarko dëshmitë e kualifikimit)** kao i
c. **Dokaz o radnom iskustvu dokumentujete** ugovorom o radu i otpremite ga u **odeljak "Otpremite sertifikate za iskustvo" (Ngarko dëshmitë për përvojë).**

Ako je diploma stečena u inostranstvu, potvrda o nostrifikaciji stečene diplome ili akt kojim se dokazuje da je stečena diploma u postupku nostrifikacije, pod uslovom da se nostrifikacija diplome podnosi do trenutka potpisivanja akta o imenovanju na to radno mesto.

**Način prijave:**
Prijava je na mreži, otpremite dokumente u skladu sa zahtevima u konkursu. Vaša prijava je potpuna samo ako primite e-poštu za potvrdu. Za bilo kakvu nesigurnost i sigurnost u aplikaciji, kontaktirajte broj telefona: 038 501-401-2671, ali možete pisati i na e-mail (ofertapune@kek-energy.com) da biste potvrdili svoju prijavu (samo ako niste primili e-mail s potvrdom).

**Proglašenje rezultata javnog konkursa**:
Kandidati će biti pojedinačno obavešteni o rezultatima ovog konkursa u skladu sa Administrativnim uputstvom br. 01/2024, kojim se dopunjuje izmena i dopuna UA br. 03/2024 i Zakona o radu br. 804 od 28.01.2025. godine o regulisanju konkurencije u javnom sektoru.

**Način vrednovanja kandidata/kandidata:**

| | |
|---|---|
| Intervju je ocenjen do sedamdeset | (70) poena |
| Biografija (CV) se ocenjuje do trideset | (30) poena |

**KEK poziva sve zainteresovane strane, posebno ženski rod, da se prijave za objavljeno radno mesto.**
Za više informacija o navedenoj poziciji posetite sajt: www.kek-energy.com, ikonu *"Oglas" (Shpallje)* i možete preuzeti **prijavu** za poziciju za koju se prijavljujete.

U slučaju jednakog broja bodova na kraju procesa evaluacije intervjua i CV-a, prednost će imati kandidati iz opštine Obiliq i drugih ugroženih područja u skladu sa zakonom br. 05 / L-044.

**Napomene:**
Prilikom prijavljivanja putem interneta, nakon popunjavanja polja sa tačnim i potpunim ličnim podacima, obratite pažnju na sledeće: **Ako ne izjavite da član vaše uže porodice radi u KEK-u, u bilo kojoj fazi koja je potvrđena, vaše prijave će biti odbijene.** Prijave nakon isteka roka neće biti prihvaćene, dok će one koje su manjkave ili nisu u gore navedenom formatu biti odbijene. Uspešan kandidat će biti postavljen na radno mesto za koje se prijavio u skladu sa ovim saopštenjem, a za radna mesta koja imaju značajan manjak radnika, neće moći da bude predložen za raspoređivanje na druga radna mesta bez navršenog radnog staža od tri (3) godine.

Okvirni kalendar: u roku od 25 dana usmeni razgovori i konačno obaveštenje u roku od 30 dana ukoliko nema pritužbi kojima se obustavlja rok predviđen prema UA 01/2024, dopunjuju izmene i dopune UA 03/2024 i Zakona o radu br. 804 od 28.01.2025.

**Datum prijave do 20.01.2026 u 24:00**
**Priština, 05.01.2026**

**Divizija Korporativnih Usluga**

KORPORATA ENERGJETIKE - KOSOVA ENERGY CORPORATION J.S.C. - KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d. • PRISHTINË-A

TEATRI KOMBËTAR I KOSOVËS MBETET PA DREJTOR, PEZULLOHET E DORËHIQET KUSHTRIM SHEREMETI

# Drama me drejtorin e Teatrit Kombëtar: Komision disiplinor, paralajmërim për dorëheqje, pezullim, dorëheqje

**Për një ditë, atë të 31 dhjetorit Ministria e Kulturës ka nxjerrë tri vendime: Komisioni Disiplinor ka pezulluar Kushtrim Sheremetin nga pozita e drejtorit të përgjithshëm të Teatrit Kombëtar, të njëjtën gjë e ka bërë edhe sekretari i përgjithshëm dhe më pas nëpërmjet një tjetër vendimi udhëheqësja teknike e TKK-së, Rrezarta Basha, është emëruar ushtruese e detyrës së drejtorit. Po atë ditë, Kushtrim Sheremeti ka paraqitur dorëheqjen – e paralajmëruar zyrtarisht katër ditë më herët – dhe më pas do të njoftonte kolegët e institucionit për vendimin. Krejt kjo ka ndodhur pasi Këshilli Drejtues ka kërkuar inicimin e procedurës disiplinore. Në shkurt, Sheremeti do të përmbyllte mandatin 4-vjeçar**

**Shaban Maxharraj**



**Ministri në detyrë i Kulturës, Hajrulla Çeku (nga e djathta), ish-drejtori i Teatrit Kombëtar të Kosovës, Kushtrim Sheremeti, udhëheqësi artistik i këtij institucioni, Kushtrim Mehmeti dhe aktorja, Aurita Agusha në ceremoninë e ndarjes së çmimeve vjetore të teatrit në mars 2025**

PRISHTINË, 5 JANAR – Me alamet drame Kushtrim Sheremeti ia kishte dalë që të ulet në karrigen e drejtuesit të institucionit më të lartë teatror në vend para gati katër vjetësh. Një tjetër dramë është zhvilluar në ditët e fundit të dhjetorit deri me epilogun datës 31 dhjetor kur është pezulluar dhe ka dhënë dorëheqje nga pozita. Historia e nis me kërkesën e Këshillit Drejtues të TKK-së për ta dërguar në Komision Disiplinor. Më pas vjen njoftimi se Sheremeti do të përballet me këtë Komision, paralajmërimi i tij i menjëhershëm për dorëheqje, pezullimi dhe po atë ditë dorëheqja nga pozita.

## Inicimi i procedurës disiplinore

KOHA ka parë të gjitha komunikimet midis palëve. Më 16 dhjetor të vitit të kaluar, kur Kushtrim Sheremeti ishte zyrtarisht në pushim, Këshilli Drejtues i Teatrit Kombëtar të Kosovës që kryesohet nga Visare Aliu i ka kërkuar Ministrisë së Kulturës inicimin e procedurës disiplinore ndaj asokohe drejtorit të përgjithshëm të Teatrit Kombëtar të Kosovës. Kjo, pasi Këshilli konstatonte keqmenaxhim nga ana e tij. I njëjti Këshill edhe në pjesën e parë të vitit të kaluar kishte kërkuar inicim të procedurave dhe Sheremeti ishte përballur me Komisionin Disiplinor. Por ai proces ishte i barabartë me zero. Kërkesa e dhjetorit ka ndikuar që Komisioni Disiplinor të hapë rast të ri për Kushtrim Sheremetin. Për këtë rast, ai është njoftuar më 26 dhjetor. I menjëhershëm ka qenë reagimi i tij.

## Paralajmërimi për dorëheqje

"Ju kërkoj që të informoni të gjitha palët, të mos lodhen me procedura dhe me krijime të ngarkesave të panevojshme administrative me këto procedura të cilat nuk janë ndalur përgjatë vitit 2025, sepse që nga ky moment, zyrtarisht paralajmëroj se letrën e dorëheqjes nga pozita e drejtorit të përgjithshëm të TKK-së do ta deponoj në MKRS sapo të kthehem në zyrë pas pushimit zyrtar në të cilin gjendem", kishte shkruar Sheremeti ku nëpërmjet postës elektronike kishte vënë në dijeni një varg zyrtarësh ministrorë për vendimin që do të merrte pas kthimit nga pushimi. Por te MKRS-ja paralajmërimi për dorëheqje, s'ka çuar peshë. Kushtrim Sheremeti ishte në pushim deri në ditën e fundit të vitit. Pikërisht atë ditë, MKRS-ja ka nxjerrë vendimin për pezullim nga detyra deri në përfundimin e procedurës disiplinore.

## Pezullimi nga detyra dhe dorëheqja brenda ditës

"Komisioni Disiplinor konstaton se ekziston bazë e mjaftueshme për aplikimin e masës jodisiplinore të pezullimit të përkohshëm nga puna deri në marrjen e vendimit përfundimtar në procedurë disiplinore për drejtorin e përgjithshëm të Teatrit Kombëtar të Kosovës z. Kushtrim Sheremeti, si masë parandaluese kundrejt ushtrimit të përshtatshëm të detyrës së tij", shkruhet në vendimin e datës 31 dhjetor të vitit të kaluar. Po atë ditë vendim për pezullim të Sheremetit ka nxjerrë edhe sekretari i përgjithshëm i MKRS-së, Bislim Bislimi. MKRS-ja atë ditë ka emëruar udhëheqësen teknike të TKK-së, Rrezarta Basha – e punësuar në këtë pozitë në qershor të vitit 2024 – në pozitën e ushtrueses së detyrës së drejtorit. Po atë ditë, pasi është pezulluar nga detyra, Kushtrim Sheremeti i ka dërguar MKRS-së letrën e dorëheqjes nëpërmjet postës elektronike. Nuk ishte ndalur me kaq. U ka shkruar edhe kolegëve të TKK-së.

"Po ju shkruaj për herë të fundit nga zyra e drejtorit të përgjithshëm të Tetarit Kombëtar të Kosovës për t'ju falënderuar për bashkëpunimin dhe punën e bërë në tejkalimin e sfidave të mëdha që i kemi kaluar këto vite së bashku! Unë nga data 26 dhjetor 2025 jam tërhequr nga kjo pozitë", shkruhet në këtë porosi të dërguar nëpërmjet postës elektronike.

## "Nuk kisha çfarë të jap më shumë"

Të hënën, Sheremeti i ka thënë KOHËS se është dorëhequr.

"Më datë 26 dhjetor 2025 e kam informuar zyrtarisht Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes emailit për dorëheqjen time. Në rrethana të jashtëzakonshme dhe shumë të vështira pune, jam krenar për sukseset e arritura në Teatrin Kombëtar të Kosovës gjatë kësaj periudhe. Vendimin për t'u tërhequr e kam marrë që në maj të vitit 2025, por vendosa të qëndroj në detyrë me këmbëngulje që, pavarësisht sfidave, festivali 'Moisiu' të organizohej në Prishtinë, gjë që u realizua me shumë sukses", ka thënë ai. Sipas Sheremetit, ky edicion i festivalit ishte motivi i tij dhe pas realizimit ndihet plotësisht i përmbushur.

"Për periudhën e mbetur nuk kisha çfarë të jap më shumë, andaj kam vendosur të tërhiqem nga pozita. Ky ishte një vendim personal, i mirëmenduar dhe besoj edhe i drejtë. Koha dhe konteksti gjithmonë i qartësojnë gjërat, andaj besoj se detajet janë të parëndësishme në këtë moment. E rëndësishme është mirëqenia dhe suksesi i Teatrit Kombëtar të Kosovës. Dorëheqjen dhe arsyet e saj i kam sqaruar edhe publikisht. Aktualisht jam i përqendruar në punë artistike dhe nuk planifikoj deklarime të tjera", ka thënë ai prerazi.

Mungesa e bashkëpunimit midis Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit të TKK-së e ka sjellë institucion në situatë me shumë telashe. TKK-ja për një kohë të gjatë ka probleme të mëdha.

Më 7 maj të vitit të kaluar ministri në detyrë i Kulturës, Hajrulla Çeku e ka emëruar në Këshillin Drejtues të TKK-së në përbërje të Rajmonda Ahmetajt, Visare Aliut, Shkurtë Aliut, Vlora Merovcit, Gresa Pallaskës, Molikë Maxhunit dhe Donika Gashit si përfaqësuese të MKRS-së. Midis tyre janë dy aktiviste aktive të partisë që i takon ministri në detyrë Çeku dhe një ish-aktiviste e po kësaj partie, Lëvizjes Vetëvendosje.

## Akuzat për keqmenaxhim

Kur më 16 dhjetor të vitit të kaluar Këshilli Drejtues kërkoi inicimin e Komisionit Disiplinor, renditi disa pika. Sipas Këshillit Drejtues, Kushtrim Sheremeti ka vonuar dërgimin e kërkesave për miratim, gjatë muajit qershor, TKK-ja s'ka pasur repertor, e po ashtu është evidentuar mospërmbushje serioze e obligimeve ndaj bashkëpunëtorëve të jashtëm.

"Një rast tjetër domethënës është dështimi i shfaqjes "Emira", e cila u ndërpre pesë ditë para premierës për shkak të grevës së një pjese të ansamblit rezident të TKK-së. DP nuk ka treguar vullnet për të gjetur zgjidhje që do të mundësonte kryerjen e obligimeve financiare ndaj ekipit krijues, i cili mbeti pa u kompensuar për punën e kryer deri në ndërprerje", shkruhet në arsyetime. Midis të tjerash shkruhet se planifikimi i festivalit "Moisiu" është bërë në mënyrë "ad hoc", pa koordinim të duhur me Këshillin Drejtues dhe pa transparencë në proces.

"Informatën e parë se festivali do të zhvillohej, KD e ka marrë jo nga menaxhmenti, por përmes një postimi në rrjete sociale, çka tregon për mungesë serioze të komunikimit institucional", shkruhet në arsyetimin e kërkesës për Komision Disiplinor. Më pas janë përmendur një klimë armiqësore dhe joprofesionale, favorizime brenda TKK-së e deri te konstatimi se institucioni është dëmtuar shumë.

Historia e largimit të Kushtrim Sheremetit nga pozita e drejtorit të përgjithshëm të TKK-së ngjan me zhurmën e madhe që ishte bërë në kohën kur ishte ulur në karrigen e drejtorit.

## Zhurma e 2022-s

I zgjedhur më 16 shkurt të vitit 2022, ai nuk e kishte nënshkruar kontratën deri më 5 prill të atij viti. Ai kishte marrë pikë maksimale nga përbërja e atëhershme e Këshillit Drejtues në raport me kundërkandidatët Avni Dalipi, Xhemail Agaj e Blerim Krasniqi. Aktorja Vlora Merovci – tash anëtare e Këshillit Drejtues –nuk i kishte plotësuar kushtet e konkursit.

TKK-ja asokohe u bë me drejtor pas një zvarritjeje dyvjeçare. Në shkurt të 2022-s kishte mjaftuar lajmi se aktori Kushtrim Sheremeti është kandidati i suksesshëm për drejtor të Teatrit Kombëtar të Kosovës që të shpërthenin edhe akuzat se ai nuk është i duhuri. Nëpër rrjete sociale, diskursi qe kryesisht politik, e nga anëtarë të partisë në pushtet kishte pasur të ashtuquajtura distancime prej përzgjedhjes.

Gjuhë të ashpër kundër Sheremetit kishte përdorur asokohe deputeti i VV-së, Haki Abazi. Reagimet ishin të shumta nga anëtarë e militantë të partisë që asokohe e edhe tash është në pushtet. E Ministria e Kulturës kishte shpejtuar të sqaronte se procesi nuk kishte marrë epilog.

"Procesi i zgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm të Teatrit Kombëtar të Kosovës nuk ka përfunduar. Këshilli Drejtues i TKK-së ka përfunduar vlerësimin e kandidatëve pas intervistimit (me shkrim dhe me gojë). Ministria e Kulturës do t'i ndjekë afatet ligjore për zhvillimin e hapave të mëtutjeshëm…", shkruhej në njoftimin e MKRS-së që për shumë artistë ishte i panevojshëm.

Edhe Sheremeti është provuar në politikë si pjesë e Lëvizjes për Bashkim. Ka qenë këshilltar politik i ish-ministrit të Diasporës, Valon Murati.

MKRS-së i janë dashur gati dy muaj që të shqyrtojë ankesat e Avni Dalipit dhe të Xhemail Agajt. Dyshja kishte pretenduar që gjatë procesit nuk ishin përfillur rregullat ligjore, por sipas MKRS-së ka ndodhur e kundërta.

Ministria e Kulturës shkaku i reagimeve të partiakëve të vetë ministrit Çeku nuk kishte nënshkruar kontratë me Sheremetin deri në prill duke pritur një moment të përshtatshëm. Kur kishin shpërthyer akuzat për punësime partiake në KEK në prillin e 2022-s MKRS-ja shfrytëzoi rastin për të nënshkruar kontratën me Sheremetin. Sheremeti kishte aplikuar për drejtor të TKK-së edhe më 2020 e edhe më 2008. Në mars të atij viti ai kishte çuar pluhur në raport me procesin që po zhvillohej. Fillimisht nuk ishte ftuar në intervistë për këtë pozitë. Sheremeti kishte ngritur zërin se ishte larguar nga lista qëllimshëm, përderisa Këshilli Drejtues i asaj kohe kishte thënë se në aplikacion nuk kishte paraqitur diplomën. Më pas ishte vendosur që të realizohen intervista dhe kandidatët t'i sillnin diplomat për t'i parë anëtarët e KD-së. Por Sheremeti nuk kishte shkuar fare në intervistë. Për dallim prej tij, gjashtë kandidatët e tjerë – Faik Ispahiu, Hazir Myftari, Xhavit Muçaj, Arian Krasniqi, Emine Toska dhe Qemajl Sokoli – kishin dalë para panelit që drejtohej nga Luan Daka, asokohe kryetar i Këshillit drejtues të TKK-së. Por pas 14 vjetësh Sheremeti ia kishte dalë të ulet në karrigen e drejtorit të TKK-së.

© KOHA Ditore

MEMOARET QË VIJNË ME SHUMË PIKËPYETJE

# “The Salt Path” dhe librat më skandalozë të vitit 2025

LONDËR, 5 JANAR (BBC) - Historitë personale ishin të popullarizuara dhe të fuqishme në vitin 2025, por disa polemika kanë ngritur pyetje për të ardhmen e zhanrit të memuareve.

Historitë personale mund të jenë shumë të fuqishme, dhe kjo nuk ka qenë asnjëherë më e dukshme se në vitin 2025. Gjatë 12 muajve të fundit, kujtimet shpesh kanë qenë tituj të gazetave për historitë që u treguan ashtu edhe për detajet që u anashkaluan.

Në pranverë, Sarah Wynn-Williams me librin e saj “Careless People”, një shpalosje mbi kohën që kaloi duke punuar si udhëheqëse në “Meta”, kompaninë që qëndron pas “Facebook” dhe “Instagram”, u bë bestseller, pavarësisht urdhrit që ndalonte të bëhej reklamë për të.

Më pas, autobiografia e Virginia Giuffre – “Nobody’s Girl”, e cila përshkruan abuzimin e saj seksual nga Jeffrey Epstein dhe rrethina e tij si dhe përfshin akuza kundër Andrew Mountbatten-Windsor të cilat ai i ka mohuar gjithmonë, u shit në një milion kopje brenda dy muajve. Ky libër intensifikoi presionin për t’i hequr titujt ish-princit, kërkesë që u realizua në fund të tetorit.

Libri “107 Days” i Kamala Harris, një rrëfim i fushatës dështuese presidenciale të saj, tërhoqi shumë vëmendje për kritikat e saj ndaj Joe Biden. Po ashtu, viti pati edhe libra autobiografikë që bënë nam nga Margaret Atwood, Malala Yousafzai dhe Jacinda Ardern, si dhe histori të prekshme jete si “Mother Mary Comes to Me” nga Arundhati Roy dhe “Things in Nature Merely Grow” nga Yiyun Li, rrëfim për humbjen e dy djemve të saj nga vetëvrasja.

Po viti 2025 ishte gjithashtu viti kur memoaret tërhoqën vëmendje për arsyet e gabuara. Gazetarja Olivia Nuzzi publikoi librin e shumëpritur “American Canto”, që ndër të tjera përshkruan “romancën digjitale” me Robert F. Kennedy, i cili cilësohet nga kritikët si “jashtëzakonisht i tmerrshëm” duke shitur më pak se një mijë e 200 kopje në javën e parë.

Në shtator, “New York Times” ka publikuar një artikull që ngrinte dyshime mbi memoarin “The Tell” të Amy Griffin, një libër që kishte mbështetje nga figura të njohura si Oprah Winfrey, Gwyneth Paltrow dhe Reese Witherspoon. Ky libër përshkruan abuzimin seksual që Griffin kishte përjetuar në fëmijëri, bazuar në kujtime të rikuperuara gjatë seancave të terapisë




**Mbase një nga skandalet më të mëdha letrare të vitit që shkoi lidhet me memoarin e Raynor Winn “The Salt Path”. Libri i botuar për herë të parë në vitin 2018, tregon historinë e Raynor Winn dhe burrit të saj Moth, të cilët ecën për mbi një mijë kilometra përgjatë rrugës së bregut jugperëndimor në Britaninë e Madhe**

## Skandali i “The Salt Path”

Mbase një nga skandalet më të mëdha letrare të vitit që shkoi lidhet me memoarin e Raynor Winn “The Salt Path”. Libri i botuar për herë të parë në vitin 2018, tregon historinë e Raynor Winn dhe burrit të saj Moth, të cilët ecën për mbi një mijë kilometra përgjatë rrugës së bregut jugperëndimor në Britaninë e Madhe. Në libër, lexuesit mësojnë se çifti humb shtëpinë e tyre pas një investimi të dështuar dhe një mosmarrëveshjeje ligjore me një mik të tyrin. Për t’u bërë gjërat më keq, disa ditë më pas Moth diagnostikohet me një sëmundje neurologjike. Duke ditur se nuk kishte më asgjë për të humbur, ata vendosin të nisen në këmbë. Deri në fund të udhëtimit të tyre, një i huaj u ofron një vend për të jetuar dhe simptomat e Moth fillojnë të përmirësohen dukshëm.

Lexuesit u dashuruan me narrativën e triumfit mbi tragjedinë, të cilën botuesit e quajtën “shumë të sinqertë”. Ky libër ka shitur më shumë se dy milionë kopje dhe është përkthyer në më shumë se 25 gjuhë. Raynor Winn publikoi më pas edhe dy libra të suksesshëm “The Wild Silence” dhe “Landlines”. Në pranverë të vitit të kaluar u shfaq një film i bazuar në “The Salt Path” me Gillian Anderson dhe Jason Isaacs në rolet kryesore.

Por në muajin korrik, gazeta britanike “The Observer” publikoi një hulumtim që vuri në dyshim saktësinë dhe sinqeritetin e librit. Dokumentet dhe intervistat zbuluan se çifti, emrat e vërtetë të të cilëve janë Sally dhe Tim Walker, humbën shtëpinë e tyre pasi Raynor kishte marrë një kredi për të paguar qindra mijëra funte të cilat akuzohej se i kishte vjedhur nga punëdhënësi i saj. Po ashtu gazetarja Chloe Hadjimatheou ka biseduar me neurologë që shprehën dyshime se simptomat e Moth mund të ishin kthyer ose që ai mund të ishte ende i shëndetshëm, 18 vjet pas diagnostikimit.

Raynor Winn ka dalë me një deklaratë të gjatë në faqen e saj të internetit, duke e quajtur hulumtimin “jashtëzakonisht të padrejtë dhe shumë mashtrues”, duke thënë se “The Salt Path” ishte “rreth një kapsule kohe kur jetët tona kaluan nga një vend i plotë dëshpërimi në një vend shprese”.

Në të njëjtin muaj, një hetim tjetër nga gazetarja Hadjimatheou dhe një dokumentar i ri me titull “The Salt Path Scandal” nxorën më shumë zbulime, duke përfshirë një letër rrëfyese nga Raynor Winn, e siguruar nga mbesa e saj, ku duket se ajo pranon se ka vjedhur para nga nëna e saj dhe nga prindërit e burrit të saj. Në një tjetër deklaratë Raynor mohon akuzat, duke thënë: “Nuk kam vjedhur nga familja… As kam pranuar ta bëj këtë dhe nuk kam shkruar letrën e cila thotë se kam bërë kështu”.

Por ky rrëfim nuk jep shenja se do të shuhet pasi një seri “podcast” do të dalë këtë vit. Hadjimatheou e cila planifikonte një udhëtim raportimi në Siri kur një mesazh në “Instagram” e njoftoi për historinë e “The Salt Path”, e quajti këtë “një nga shkrimet më të mëdha të karrierës gazetareske”.

Në fillim, pati raportime që libraritë ofronin rimbursime për lexuesit që ndiheshin të tradhtuar. Megjithatë, pas hulumtimit, “The Salt Path” u ngjit sërish në listën e librave më të shitur. Kinematë vazhduan të shfaqin filmin. Sot, ende mund të gjendet ky memoar në disa librari.

Në dokumentar, Hadjimatheou pyet lexuesit në një festival letrar për reagimet e tyre ndaj skandalit. Disa janë të shokuar, por shumë të tjerë nuk duket se janë të prekur nga akuzat. “Është një libër për një shëtitje. Nuk është diçka që ndryshon jetën. Shijojeni librin”, thotë njëri. “Në çdo histori gjithmonë ka diçka fiktive që shtohet”, thotë një tjetër.

## Debati mes faktit dhe fantazisë

Kjo sagë ka ndezur diskutime se sa të vërteta duhet të jenë memoaret, një debat që lind gjithmonë kur ka një histori të tillë. Në vitin 2006, pasi memoari i James Frey me titull “A Million Little Pieces” u zbulua të ishte i sajuar në disa pjesë ai kishte thënë se e bërë këtë ai tha se e bëri këtë "për t’i shërbyer asaj që e ndjeja si qëllimin më të madh të librit”.

Në fillim të vitit të kaluar, shkrimtarja Lily Dunn botoi librin “Into Being”, kushtuar artit të memoarit. Libri erdhi si rrjedhojë e dhjetë viteve mësimdhënie dhe mentorimi në këtë zhanër, si dhe nga përvoja e saj personale me memoarin “Sins of My Father: A Daughter, a Cult, a Wild Unravelling” i vitit 2022.

“Jam disi e fiksuar pas tij”, ka thënë ajo. “Prej vitesh nuk kam lexuar pothuajse asgjë tjetër përveç memoareve”, ka shtuar më tej,

Për Dunn, ekziston një lidhje e veçantë mes lexuesit dhe autorit që ndan përvoja intime dhe shpesh të dhimbshme në faqe libri. “Memoaret mund të bëhen shumë më të rëndësishëm sesa historia që tregojnë, për sa i përket ndikimit në jetë, ndryshimit të ligjeve apo mënyrës se si i shohim disa gjëra”, ka thënë ajo. “Libri im çoi në një dokumentar, i cili më pas u shndërrua në një platformë për zërat e të tjerëve. Një memoar mund të vazhdojë të ketë jetë përtej teje, dhe kjo e bën atë jashtëzakonisht të fuqishëm”.

Ajo u habit nga disa reagime ndaj zbulimeve për “The Salt Path”.

“Kishte qëndrime të tipit: ‘Po ç‘rëndësi ka?’. Për mua, elementi më i rëndësishëm në përkufizimin e memoarit është ndershmëria. Besimi mes rrëfimtarit dhe lexuesit është thelbësor. Sigurisht, të gjithë i kujtojmë gjërat ndryshe dhe memoari është shumë subjektiv. Por memoaret më të mirë janë ata që e pranojnë këtë dhe e eksplorojnë përmes vetë shkrimit”, ka thënë Dunn.

Besimi kërkohet edhe mes autorit dhe redaktorit – veçanërisht pasi pak botues verifikojnë çdo detaj. Michael Joseph nga “Penguin” ka thënë se “kujdesi i duhur” për botimin e “The Salt Path” përfshinte një klauzolë mbi saktësinë faktike në kontratën e autorit dhe një lexim para botimit.

Amelia Fairney, ish-drejtoreshë e komunikimit në “Penguin Books”, e cila tani punon për një organizatë që lufton dezinformimin, ka shkruar në “The Observer” se “botimi ka probleme me verifikimin e fakteve”, duke sugjeruar se fitimi shpesh vjen përpara së vërtetës. Ajo shkruante se “të ngrije dyshime mbi autenticitetin e një autori me status kaq fitimprurës sa Raynor Winn do të kërkonte guxim të jashtëzakonshëm”.

Si redaktore e asociuar e “The Bookseller”, Caroline Sanderson ka kaluar 25 vjet duke redaktuar dhe recensuar memoare. Këtë vit ajo botoi edhe një të sajin: “Listen With Father: How I Learned to Love Classical Music”.

Ajo mendon se ka pyetje serioze që duhet të marrin përgjigje lidhur me “The Salt Path” dhe nëse lexuesit janë mashtruar, por shqetësohet se një rast i vetëm mund të njollosë të gjithë zhanrin e memoarit. Sidomos sepse, për të, kufiri mes trillimit dhe jofiksionit është gjithmonë i paqartë.

“Jam kampione e madhe e idesë se trillimi dhe jofiksioni nuk qëndrojnë në pole të kundërta të universit”, ka thënë ajo. “Ka shumë romane – shpesh romane debutuese – që janë thellësisht autobiografike në natyrë. Ka edhe shumë libra jofiksion që mund të quhen imagjinarë.

“Nëse themi se memoaret duhet të jenë vetëm dhe ekskluzivisht fakte të sakta, atëherë përjashtojmë një pjesë të madhe të krijimtarisë narrative”, ka thënë Sanderson.

## Shpërthimi i “natyrës shëruese”

Vitet e fundit ka pasur një rritje të librave që ndërthurin rrëfimin personal me shkrimin mbi natyrën, përfshirë “Raising Hare” nga Chloe Dalton, “H is for Hawk” nga Helen Macdonald dhe “The Outrun” nga Amy Liptrot – dy të fundit janë përshtatur edhe në filma artistikë.

Historia e “The Salt Path” për qëndresën ndaj fatkeqësive është veçanërisht joshëse, por pasojat e skandalit kanë ngritur pyetje mbi narrativat që promovojnë fuqinë shëruese të natyrës.

Në një shkrim për “LitHub”, memoaristja dhe shkrimtarja e natyrës Polly Atkin, autore e “Some of Us Just Fall: On Nature Writing and Not Getting Better”, ka shkruar se “shkrimi për natyrën pranon sëmundjen në faqet e tij vetëm kur kjo shërben për të treguar natyrën duke kryer një shërim mrekullibërës”.

James Rebanks, autor i “The Shepherd’s Life” dhe “The Place of Tides” ka thënë: “Mua më duket më interesant (shkrimi për natyrën) kur ka më pak të bëjë me shpengimin personal dhe më shumë me pasqyrimin e gjërave të mëdha që më interesojnë: politika, ekonomia dhe ajo që po ndodh realisht në botë”.

Atkin dhe shkrimtarë të tjerë po zgjerojnë kufijtë e memoarit të natyrës. “Undercurrent” nga Natasha Carthew rrëfen fëmijërinë e saj në varfëri rurale, ndërsa vitin e ardhshëm do të botohet “Rough”, që shqyrton historitë e patreguara të komuniteteve bregdetare të Britanisë. “A Flat Place” nga Noreen Masud përdor peizazhet e hapura britanike për të eksploruar traumën emocionale dhe për të reflektuar mbi rritjen e saj në Pakistan dhe Skoci.

Për Sanderson, këto lloj historish personale na ndihmojnë të mendojmë për çështje më të mëdha në mënyra që librat e aktualitetit apo historisë nuk munden. Duke parë drejt vitit 2026, ajo është e entuziazmuar për “Lifeboat at the End of the World” nga Dominic Gregory, memoar debutues i një vullnetari të RNLI-së (Institucioni Mbretëror i Varkave të Shpëtimit). “Është gjëja më tronditëse që kam lexuar për krizën e varkave të vogla. Ndihem më e informuar pasi e lexova këtë libër, dhe është shkruar bukur”, ka thënë Sanderson.

Viti 2026 pritet të sjellë edhe më shumë memoare që do të bëjnë bujë, nga histori të fuqishme si “Hymn to Life” e Gisèle Pelicot, e mbijetuar e dhunimit, deri te botime nga emra të njohur si Lena Dunham dhe Liza Minnelli.

Sa i përket pyetjes nëse skandali i “The Salt Path” do t’i bëjë botuesit më të kujdesshëm për të porositur histori reale, Sanderson shpreson që jo. Në një botë të copëzuar dhe me inteligjencën artificiale që po e shtrembëron gjithnjë e më shumë ndjesinë tonë të realitetit, përvojat njerëzore janë më të rëndësishme se kurrë.

“Të lexosh historitë e të tjerëve dhe të kuptosh jetën e tyre është diçka për të cilën kemi urgjentisht nevojë”, ka thënë ajo.

# “Critics Choice Awards 2026”: “One Battle After Another”- filmi më i mirë i vitit



Filmi “One Battle After Another” u shpall fituesi kryesor i mbrëmjes në spektaklin e ndarjes së çmimeve “Critics Choice Awards 2026”, duke marrë çmimin për filmin më të mirë, si dhe atë për regjinë më të mirë, e cila i takoi Paul Thomas Anderson.

Mbrëmja e ndarjes së çmimeve u mbajt të dielën në Barker Hangar në Santa Monica dhe u drejtua për herë të katërt radhazi nga Chelsea Handler.

The Hollywood Reporter ka publikuar listën e fituesve kryesorë në film.

Filmi më i mirë: “One Battle After Another”

Regjia më e mirë: Paul Thomas Anderson - “One Battle After Another”

Aktori më i mirë: Timothée Chalamet- “Marty Supreme”

Aktorja më e mirë: Jessie Buckley- “Hamnet”

Aktori më i mirë në rol dytësor: Jacob Elordi –“Frankenstein”

Aktorja më e mirë në rol dytësor: Amy Madigan – “Weapons”

Filmi “Sinners” ishte një tjetër fitues i madh i mbrëmjes, me katër çmime, përfshirë skenarin origjinal më të mirë, të cilin e mori Ryan Coogler dhe muzikën më të mirë për Ludwig Göransson.

Miles Caton u shpall aktori i ri më i mirë për rolin e tij në këtë film.

Animacioni dhe muzika

“KPop Demon Hunters” fitoi çmimin për filmin më të mirë të animuar, ndërsa kënga “Golden” e këtij filmi u shpall kënga më e mirë.

Televizioni

Seriali më i mirë dramë: “The Pitt”

Seriali më i mirë komedi: “The Studio”

Seriali i limituar më i mirë: “Adolescence”

Talk show më i mirë: “Jimmy Kimmel Live!”

Kur komediani Kimmel pranoi çmimin, përgjatë fjalimit të tij, ai ka falënderuar me ironi presidentin e SHBA-së, Donald Trump.

“Faleminderit për të gjitha gjërat qesharake që i bën çdo ditë”, ka thënë ai me ironi.

Kimmel gjithashtu ka falënderuar edhe të gjithë yjet që e mbështetën, pasi atij i ishte ndaluar transmetimi i emisionit pas disa komenteve që i pati bërë në lidhje me aktivistin politik Charlie Kirk.

Në kategoritë televizive u vlerësuan edhe emra si: Noah Wyle, Rhea Seehorn, Seth Rogen, Jean Smart dhe Janelle James.

Shoqata e kritikëve shtoi këtë vit edhe katër kategori të reja, përfshirë kastin më të mirë, dizajnin e akrobatëve dhe zërin.

# 10 veshjet më të përfolura të tepihut të zi të “Critics Choice Awards 2026”

Vetëm katër ditë në vitin 2026, sezoni i çmimeve në Hollywood për vitin 2026 u hap zyrtarisht me edicionin e 31-të të ceremonisë së ndarjes së çmimeve “Critics Choice Awards”. Ceremonia u mbajt të dielën mbrëma dhe u karakterizua nga stili elegant, por më i përmbajtur sesa vitet e kaluara.

“Critics Choice Awards” konsiderohen si parashikues i rëndësishëm për ceremoninë prestigjioze të ndarjes së çmimeve “Oscar” nga Akademia e Filmit, prandaj industria ndjek me vëmendje performancën e filmave më të përfolur si “Sinners” dhe “Hamnet”.

Përveç çmimeve, ngjarja shërben edhe si një parashikim i trendëve të modës që pritet të dominojnë deri te ndarja e çmimeve “Oscar” në mes të muajit mars.

Nëse ky tepih është një shenjë paralajmëruese, atëherë sipas CNN-it, dy muajt e ardhshëm do të dominohen nga fustane elegante me ngjyra të errëta, paleta e ngjyrave neutrale dhe veshje femërore të frymëzuara nga kostumet klasike mashkullore.

Organizatorët vendosën që hyrja në Barker Hangar në Santa Monica të shtrohej me tepih të zi, dhe jo të kuq, duke krijuar një atmosferë më serioze. Kjo u reflektua edhe në zgjedhjet e shumta të kostumeve dhe fustaneve të zeza.

Megjithatë, kreativiteti nuk mungoi.

Zërat kryesorë të filmit “KPop Demon Hunters” sollën qasje më lozonjare ndaj trendit monokromatik, sidomos Audrey Nuna, aktorja e zërit të personazhit Mira, me një fustan voluminoz me ngjyrë të zezë nga brendi “Marc Jacobs”.

Ndërkohë, aktoret, Teyana Taylor dhe Keri Russell u orientuan drejt kostumeve të strukturuara, me Russell që ra në sy me një kostum të ripunuar, të zbukuruar me një brosh.

Në anën tjetër, ylli i filmit “Marty Supreme”, Odessa A’zion, solli glamur klasik me një fustan nga brendi me seli në Dubai, “OTT”

Aktorja Chase Infiniti mahniti me një kostum dypjesësh pa mëngë nga brendi “Louis Vuitton” në një nuancë të verdhë të zbehtë, ndërsa aktorja Elle Fanning zgjodhi arkivat, duke u shfaqur me një fustan të vjetër nga brendi “Ralph Lauren” që shkëlqente në nuancë ari.

10 dukjet që u komentuan më së shumti në tepihun e “Critics Choice Awards 2026”:

Artistja, Ariana Grande vazhdoi të përqafojë estetikën e personazhit të saj Glinda nga filmi “Wicked”, këtë herë me një fustan me ngjyrë rozë të lehtë me pelerinë, i punuar me porosi vetëm për të nga disenajtorja e mirënjohur, Alberta Ferretti.

Aktori Jacob Elordi u shfaq me një kombinim total të zi nga brendi “Bottega Veneta”, të cilin e kompletoi me syze dielli.



Aktorja Chase Infiniti ka ndriçuar tepihun e zi me një kostum dypjesësh nga brendi “Louis Vuitton”.

I nominuari për “Aktorin më të Mirë”, Michael B. Jordan, zgjodhi një kostum vishnje të errët po ashtu nga brendi “Louis Vuitton”.

Në një mbrëmje me ngjyra të zbehta, Odessa A’zion ka thyer rregullat me një fustan maksimalist dhe shkëlqyes nga brendi “OTT”.

Aktorja Elle Fanning ka shkëlqyer me një fustan të vjetër ngjyrë ari nga brendi “Ralph Lauren”.

E nominuar për serilain “The Diplomat”, aktorja Keri Russell ofroi një nga shembujt më të spikatur të trendit të smokingut për gra.

Aktorja Teyana Taylor u shfaq me një kostum me pupla, doreza lëkure, çizme mbi gju dhe kravatë me vija, i përshtatur nga koleksioni i burrave nga brend “Saint Laurent” Vjeshtë/Dimër 2025.

Aktorja Audrey Nuna, zëri i personazhit Mira në “KPop Demon Hunters”, solli një interpretim argëtues të fustanit të zi me brendin “Marc Jacobs”.

Aktorët Paul W. Downs dhe Megan Stalter nga “Hacks” bënë një referencë plot humor ndaj veshjeve me ngjyrë të portokalltë si yjet Timothée Chalamet dhe Kylie Jenner në premierën e filmit “Marty Supreme” muajin e kaluar.



# Pse disa njerëz e kanë shumë më të vështirë të humbin peshë se të tjerët?

Ideja se obeziteti është thjesht mungesë vullneti, vazhdon të jetë e përhapur, madje edhe mes disa profesionistëve shëndetësorë.

"Personat me mbipeshë thjesht nuk kanë vetëkontroll"; "Është çështje përgjegjësie personale"; "Mjafton të hash më pak".

Këto ishin disa nga gati 2.000 komentet që u lanë nën një artikull për injeksionet për humbje peshe, ka raportuar BBC.

Një studim i publikuar në revistën mjekësore "The Lancet" ka treguar se 8 nga 10 persona në Britani, SHBA, Australi dhe Zelandë të Re besojnë se obeziteti mund të parandalohet plotësisht vetëm përmes stilit të jetesës.

Por, dietologia Bini Suresh, e cila ka mbi 20 vjet përvojë me pacientë mbipeshë, e kundërshton këtë qasje.

"Shpesh shoh pacientë shumë të motivuar, të informuar dhe që përpiqen vazhdimisht, por sërish nuk arrijnë të humbin peshë", ka thënë ajo.

Edhe Kim Boyd, drejtoreshë mjekësore në WeightWatchers, pajtohet.

"Termat si 'vullnet' dhe 'vetëkontroll' janë fjalët e gabuara. Për dekada njerëzve u është thënë: ha më pak dhe lëviz më shumë. Por obeziteti është shumë më kompleks", ka thënë ajo.

Ekspertët kanë theksuar se nuk janë të gjithë njerëzit në të njëjtën pikënisje.



## Luftë me biologjinë

Profesoresha Sadaf Farooqi, endokrinologe që trajton obezitetin e rëndë, shpjegon se gjenet luajnë rol të rëndësishëm.

"Sasia e peshës që shton një person ndikohet ndjeshëm nga gjenet dhe këto gjene i prekin të gjithë", ka thënë ajo.

Disa gjene ndikojnë në mënyrën si truri kontrollon urinë dhe ndjenjën e ngopjes.

"Kjo do të thotë se disa njerëz shtojnë më shumë peshë duke ngrënë të njëjtën sasi ushqimi si të tjerët, ose djegin më pak kalori gjatë aktivitetit fizik", ka shtuar Farooqi.

Pse dietat shpesh dështojnë?

Kirurgu bariatrik, Andrew Jenkinson, ka shpjeguar se truri i çdo njeriu ka "peshë të preferuar", të quajtur pika e balancës së peshës.

"Kjo përcaktohet nga gjenet, por edhe nga stresi, gjumi dhe mjedisi ushqimor", ka thënë ai.

Trupi përpiqet ta mbajë këtë peshë si një termostat. Kur pesha bie nën këtë nivel, rritet uria dhe ngadalësohet metabolizmi.

"Nëse dikush peshon 127 kilogramë dhe truri i tij mendon se kjo është pesha e duhur, humbja e peshës shihet nga trupi si uri. Kjo shkakton oreks të pakontrollueshëm dhe metabolizëm të ulët. Këto sinjale janë jashtëzakonisht të forta", ka shpjeguar ai.

Rol të rëndësishëm luan hormoni leptinë, i cili duhet t'i tregojë trurit sa yndyrë ka trupi. Por në shumë raste, sidomos në mjedisin modern perëndimor, ky mekanizëm nuk funksionon si duhet.

Megjithatë, pika e balancës mund të ndryshojë gradualisht, përmes ndryshimeve afatgjata në stilin e jetesës, gjumit dhe menaxhimit të stresit.

## Mjedisi që shtyn njerëzit drejt obezitetit

Obeziteti është rritur ndjeshëm në Britani. Sipas një analize të vitit 2025, mbi 60 për qind e të rriturve janë mbipeshë ose obezë.

Kjo lidhet me ushqimet ultra të përpunuara, porcionet e mëdha, marketingun agresiv, mungesën e aktivitetit fizik dhe faktin se ushqimet e shëndetshme janë shpesh më të shtrenjta.

"Ne nuk kemi humbur papritur vullnetin. Jetojmë në një mjedis të ndërtuar për mbikonsum", ka thënë Alice Wiseman, drejtoreshë e shëndetit publik në Newcastle.

Dietologia Suresh ka theksuar se obeziteti nuk është dështim karakteri.

"Është gjendje kronike, e ndikuar nga biologjia dhe mjedisi. Vetëm vullneti nuk mjafton", ka thënë ajo.

A ka ende vend për vullnetin?

Jo të gjithë bien dakord që vullneti duhet "përjashtuar" nga debati.

Profesori Keith Frayn ka paralajmëruar se injorimi i tij mund t'i bëjë njerëzit të dorëzohen.

"Personat që kanë humbur peshë dhe e kanë mbajtur atë e përshkruajnë procesin si shumë të vështirë. Të thuash se vullneti nuk ka fare rol, do t'i ofendonte", ka thënë ai.

Psikologia Eleanor Bryant ka shtuar se vullneti nuk është i qëndrueshëm. Ai ndikohet nga lodhja, humori dhe uria.

"Vullneti fleksibil është më efektiv sesa ai rigid. Nëse ha një biskotë, nuk do të thotë që ke dështuar", ka thënë ajo.

Në fund, ekspertët bien dakord për një gjë: kuptimi i biologjisë dhe i kufijve të vullnetit nuk e dobëson përpjekjen, por e forcon atë.

"Kur njerëzit kuptojnë se lufta e tyre nuk është mungesë disipline, por biologji dhe marrin mbështetje reale, marrëdhënia e tyre me ushqimin përmirësohet ndjeshëm", ka përfunduar Suresh.

# Britania ndalon reklamat e ushqimit të pa shëndetshëm në televizion dhe online

Reklamat për ushqime të pashëndetshme janë ndaluar në televizion dhe në internet duke filluar nga e hëna, si pjesë e përpjekjeve për të luftuar obezitetin tek fëmijët.

Ndalimi vlen në të gjithë Britaninë dhe ndalon reklamimin e ushqimeve dhe pijeve me shumë yndyrë, kripë dhe sheqer (HFSS) në televizion para orës 21:00, si dhe në çdo kohë në platformat online, ka raportuar BBC.

Masat prekin produktet që konsiderohen si kontribuuesit kryesorë në obezitetin e fëmijëve, përfshirë pijet e gazuara, çokollatat, ëmbëlsirat, picat dhe akulloret.

Federata e Ushqimit dhe Pijeve (FDF) ka deklaruar se është e përkushtuar të ndihmojë njerëzit të ushqehen më shëndetshëm dhe se kompanitë anëtare i kanë zbatuar vullnetarisht këto kufizime që nga muaji tetor i vitit 2025.

Përveç ushqimeve që duken qartazi të pashëndetshme, ndalimi përfshin edhe disa drithëra të përpunuara për mëngjes, tërshërën me sheqer të shtuar, produkte buke me sheqer të shtuar, si dhe ushqime kryesore dhe sanduiçe.

Vendimi se cilat produkte ndalohen bazohet në një sistem vlerësimi që merr parasysh përmbajtjen ushqyese dhe nivelin e yndyrës së ngopur, kripës dhe sheqerit.

Tërshëra e thjeshtë dhe shumica e tërshërës pa sheqer të shtuar, si mueslit dhe granola nuk ndalohen, por versionet me sheqer të shtuar, çokollatë apo shurup mund të preken nga kufizimet.

Kompanitë ende mund të reklamojnë versione më të shëndetshme të produkteve të ndaluara, me shpresën e qeverisë se kjo do t'i shtyjë prodhuesit të krijojnë receta më të mira për shëndetin.

Josh Tilley, drejtor i strategjisë së markave në agjencinë e marketingut "Initials CX", ka thënë se kompanitë mund të reklamojnë brendin e tyre në përgjithësi, por jo produkte konkrete.

Reklamat që përfshijnë vetëm logon e kompanive, si ajo e "PepsiCo" apo harqet e "McDonald's", nuk ndalohen, gjë që sipas tij favorizon kompanitë e mëdha.

Ndërsa bizneset e vogla, ka thënë ai, nuk kanë gjithmonë mundësi të bëjnë fushata të mëdha të brendit dhe zakonisht fokusohen në promovimin e produkteve konkrete, gjë që tani nuk do të jetë më e mundur për to.

Ndalimi vlen vetëm për reklamat ku shfaqen produkte të pashëndetshme, çka do të thotë se zinxhirët e ushqimit të shpejtë mund të vazhdojnë të reklamojnë emrin e brendit.

Më herët, reklamat për ushqime HFSS ndaloheshin vetëm në platformat ku më shumë se 25 për qind e audiencës ishte nën moshën 16 vjeç.

Kompanitë që nuk i zbatojnë rregullat rrezikojnë masa nga Autoriteti i Standardeve të Reklamimit (ASA).

Të dhënat e institucioneve shëndetësorë në Britani (NHS) tregojnë se gati një në dhjetë fëmijë në moshë parashkollore jetojnë me obezitet, ndërsa një në pesë fëmijë kanë probleme me prishjen e dhëmbëve deri në moshën pesëvjeçare.

Obeziteti vlerësohet se i kushton shërbimit shëndetësor britanik mbi 11 miliardë funte në vit.

Studimet tregojnë se ekspozimi i fëmijëve ndaj reklamave për ushqime të pashëndetshme ndikon në zgjedhjet e tyre ushqimore që në moshë të hershme, duke rritur rrezikun për mbipeshë dhe obezitet.

Qeveria vlerëson se ndalimi i reklamave do të parandalojë rreth 20 mijë raste të obezitetit te fëmijët.

Katherine Brown, profesoreshë e ndryshimit të sjelljes shëndetësore në Universitetin e Hertfordshire, e quajti këtë masë "të vonuar, por në drejtimin e duhur".

Ajo ka thënë se fëmijët janë shumë të ndjeshëm ndaj marketingut agresiv të ushqimeve të pashëndetshme dhe se ekspozimi ndaj tyre rrit rrezikun për obezitet dhe sëmundje kronike.

Brown ka bërë thirrje që qeveria t'i bëjë ushqimet me vlera ushqyese më të përballueshme, më të qasshme dhe më të përshtatshme.

Federata e Ushqimit dhe Pijeve ka deklaruar se prodhuesit janë të përkushtuar të bashkëpunojnë me qeverinë për t'i ndihmuar njerëzit të bëjnë zgjedhje më të shëndetshme, duke shtuar se produktet e tyre sot përmbajnë më pak kripë, sheqer dhe kalori krahasuar me një dekadë më parë.

# HOROSKOPI

**Dashi (21 mars - 19 prill)**
Sot do të lini një përshtypje të mrekullueshme te të tjerët. Në veçanti, shefat, prindërit dhe njerëzit me autoritet do t'ju shohin si tërheqës, efikas dhe të aftë. Ky admirim mund të nxisë një flirt ose romancë me një shef ose dikë me autoritet.

**Demi (20 prill - 20 maj)**
Udhëtoni për kënaqësi nëse mundeni. Nëse nuk mund të udhëtoni larg, atëherë bëhuni turist në qytetin tuaj dhe shijoni mjedisin përreth. Edhe ngjarja më e vogël - një filxhan kafeje, mund të jetë një përvojë e re e këndshme. Nëse është e mundur, vizitoni galeritë dhe panaire artizanale për ta admiruar artin e kulturave të tjera.

**Binjakët (21 maj - 20 qershor)**
Vendimet që lidhen me bankat, pronën e përbashkët, trashëgiminë dhe çdo gjë që ndani me dikë tjetër do të jenë në favorin tuaj sot. Mosmarrëveshjet e fundit mund të zgjidhen. Besojuni ideve tuaja dhe veçanërisht aftësisë suaj për të komunikuar atë që doni të thoni.

**Gaforrja (21 qershor - 22 korrik)**
Diskutimet me partnerët dhe miqtë e ngushtë do të shkojnë mirë sot, sepse kohët e fundit mund të jeni ndier të bezdisur me dikë. Mund të ketë pasur pak më shumë tension se zakonisht. Sot Dielli është në një vijë me Venusin përballë shenjës suaj, duke nxitur mirëkuptimin dhe kompromisin.

**Luani (23 korrik - 22 gusht)**
Kontrolloni alarmin e Hënës sot - një ditë kur mund të ndodhin gjëra të këqija - veçanërisht në lidhje me shpenzimin e parave ose marrjen e vendimeve të rëndësishme në lidhje me punën tuaj. Sot marrëdhëniet me figurat autoritare dhe kolegët do të shkojnë mirë. Më parë, dikush mund të jetë ndier i kërcënuar nga vendosmëria juaj, por sot gjërat janë në rregull.

**Virgjëresha (23 gusht - 22 shtator)**
Hëna lëviz në shenjën tuaj sot, gjë që do t'ju japë një avantazh të vogël mbi të gjitha shenjat e tjera. Mund ta provoni këtë duke i kërkuar universit një nder. Bëni një kërkesë. Kërkoni avantazhin. Shikoni çfarë ndodh. Bota do të anojë nga ju.

**Peshorja (23 shtator - 22 tetor)**
Vetmia në një mjedis të bukur do t'ju kënaq sot. Mund të shijoni kohën e kaluar në shtëpi, ose mund të gjeni frymëzim diku tjetër. Nëse po bëni dekorime të reja ose diçka tjetër për të zbukuruar shtëpinë tuaj, kini kujdes që të mos jeni shumë ekstravagantë. Keni kujdes edhe me shpenzimet tuaja.

**Akrepi (23 tetor - 21 nëntor)**
Bisedat me të tjerët do të jenë të ëmbla dhe simpatike sot sepse ndiheni të shoqërueshëm dhe miqësorë. Edhe diskutimet financiare do të shkojnë në favorin tuaj. Ndërkohë shikoni përreth jush, sepse aftësia juaj për ta vlerësuar mjedisin e përditshëm është rritur. Kjo është një dhuratë.

**Shigjetari (22 nëntor - 21 dhjetor)**
Fokusi juaj është te paratë, fluksi i parave, asetet dhe të gjitha ato që zotëroni. Dëgjoni idetë tuaja për të fituar para sepse ato do të jenë të vlefshme. Megjithatë, mund të jeni të prirë drejt ekstravagancës ose vetëkënaqësisë sot. Mos i shpërdoroni paratë tuaja të fituara me mund.

**Bricjapi (22 dhjetor - 19 janar)**
Katër planetë janë në shenjën tuaj dhe sot. Dielli është në vijë me Venusin e drejtë duke e bërë të lehtë aftësinë tuaj për t'u takuar me të gjithë. Një interes i ri dashurie mund të shfaqet në jetën tuaj. Dilni dhe shoqërohuni. Ditë e shkëlqyer për të blerë gjëra të mira sa i përket gardërobës.

**Ujori (20 janar - 18 shkurt)**
Do të shijoni kohën vetëm në një mjedis të këndshëm sepse keni nevojë të merrni frymë thellë. Mund të jeni të shqetësuar për pronën e përbashkët, taksat ose borxhin. Sidoqoftë, kujdesuni për mirëqenien tuaj mendore në mënyra të këndshme. Joga, meditimi ose një shëtitje në park do t'ju qetësojnë dhe do ta bëjnë ditën tuaj shumë të mirë.

**Peshqit (19 shkurt - 20 mars)**
Kjo është një ditë e mrekullueshme për t'u takuar me të tjerët, veçanërisht me të rinjtë ose me tipa artistikë dhe krijues. Mund të merrni përsipër një projekt dhe t'i drejtoni gjërat ashtu siç dëshironi. Për disa prej jush, një marrëdhënie platonike do të shndërrohet në romantike. Ose ndoshta, një flirt i lehtë do t'ju bëjë zemrën të rrahë fort.

# Nisje e mbarë e lojtarëve të Kosovës në vitin më të rëndësishëm

**Faton Polisi**



PRISHTINË, 5 JANAR – Fundi i vitit 2025 për disa futbollistë që bartin barrën kryesore te Përfaqësuesja e Kosovës ishte pozitiv. Disa shënuan gola e disa të tjerë dhanë kontribut me asistime për klubet e tyre.

Por edhe viti 2026 ka nisur mbarë për lojtarët që janë shtyllë e Kosovës.

Kapiteni Amir Rrahmani dhe zëvendëskapiteni Vedat Muriqi shënuan gola të dielën për Napolin, përkatësisht Mallorcan.

Për sulmuesin kryesor të Kosovës, Muriqin, ishte goli i dhjetë në La Liga këtë edicion, ndërsa për mbrojtësin Rrahmani i pari në Serie A në edicionin 2025/2026.

Napoli fitoi në kampionatin italian, ndërsa Mallorca pësoi disfatë në La Liga.

Krahas golave, Rrahmani e Muriqi shfaqën formë të mirë për klubet e tyre. Forma e mirë e lojtarëve i duhet si kurrë më parë Kosovës, që ëndërron kualifikimin historik në Kupën e Botës.

Paraqitje pozitive kishin edhe Edon Zhegrova, Mërgim Vojvoda, e po ashtu portieri Arijanet Muriq, i cili u vlerësua me notë të lartë në barazimin e Sassuolos në Serie A. Për të tjerë lojtarë nuk kanë nisur ende kampionatet. Por vitin 2025 e mbyllën me paraqitje të mira edhe Fisnik Asllani, Milot Rashica, Leon Avdullahu, Albian Hajdari dhe disa të tjerë.

Forma e mirë e futbollistëve në klubet e tyre do t'i shërbente shumë Kosovës para ndeshjes kundër Sllovakisë.

Kosova më 26 mars e luan ndaj Sllovakisë në Bratislavë ndeshjen gjysmëfinale të plejofit për kualifikim në Botëror. Gjysmëfinalja tjetër është ndërmjet Turqisë dhe Rumanisë. Fituesit e dy përballjeve luajnë në finale. Nëse Kosova fiton gjysmëfinalen, atëherë do të jetë vendëse në finalen që luhet më 31 mars.

Për të kaluar në finale, Kosovës i duhet një tjetër paraqitje e madhe nga lojtarët në Bratislavë.

"Urojmë ta mbajnë formën e mirë të gjithë lojtarët dhe të mos kenë lëndime, në mënyrë që ta kemi të kompletuar ekipin për finalet e marsit. Fillimisht ndaj Sllovakisë e më pas edhe kundër Turqisë apo Rumanisë", ka thënë drejtori i Përfaqësueses, Muharrem Sahiti.

Forma e mirë e Muriqit dhe Rrahmanit është komentuar shumë në Spanjë dhe Itali.

"Vedat Muriqi ishte e vetmja pikë e ndritshme në humbjen e Mallorcas ndaj Gironas. 'Pirati' ishte sërish ylli i mbrëmjes, duke shndërruar në gol penalltinë që e fitoi vetë. Ai renditet pas Kylian Mbappes dhe Ferran Torresit në listën e golashënuesve. Sulmuesi kosovar është një nga lojtarët kryesorë në planet e trajnerit Arrasate. Muriqi po kalon një sezon të shkëlqyer për sa u përket golave, por ai është shumë i vetmuar në këtë aspekt. Samu Costa është golashënuesi i dytë më i mirë i ekipit këtë sezon me tre gola", shkruan "Ultima Hora", mediumi i afërt me klubin e Mallorcas.

Ndërkohë, mbrojtësi Amir Rrahmani ka zënë vend në 11-shen më të mirë të javës në Serie A.

Në mediumet e Italisë, Rrahmani shfaqet si mbrojtës që kryen detyrat e tij në mënyrën më të mirë të mundshme.

Vetë Rrahmani është i kënaqur me formën. Për Rrahmanin në konferencën për shtyp ka folur edhe trajneri Antonio Conte. Tekniku italian i vlerëson lart cilësitë e kosovarit.

Cilësia që po shfaqin lojtarët për klubet e tyre, sidomos ata në top-ligat evropiane, i duhet Kosovës në mars.

© KOHA Ditore

# Rënia e Amorimit – taktika, transferimet e trazirat

MANCHESTER, 5 JANAR (BBC) – Imazhi që përshkruan periudhën 14-mujore të Ruben Amorimit te Manchester Unitedit mund të jetë ai në stolin e Grimsbyt.

Ndodhi gjatë një udhëtimi të Manchester Unitedit në bregdet, në gushtin e kaluar, për një ndeshje të "Carabao Cup". Ndeshja shkoi tmerrësisht keq për Unitedin. Skuadra e madhe humbi 12:11 në penallti. Ishte hera e parë që Manchester Unitedi u mposht nga një ekip i nivelit të katërt.

Komentet e Amorimit pas ndeshjes ngjanin me dikë që ishte gati të pranonte se puna ishte shumë e vështirë për të. Por u tërhoq disa ditë më pas, kur tha se emocionet shpesh e mposhtin dhe e kishin shtyrë të thoshte gjëra të pamatura në publik.

Megjithatë ai nuk u ndal. Të paktën jo edhe për një kohë.

Ndeshja e fundit e Amorimit në krye të Unitedit ishte barazimi 1:1 me Leedsin. Ky rezultat e la skuadrën në vendin e gjashtë në Premier League. Por ndeshja u shoqërua me komente të bëra për gazetarët.

Të premten ai në një mënyrë la të kuptohet se kishte përçarje në klub. Pas ndeshjes bëri tjetër sulm në përgjigjen e tij të fundit, që përfshinte deklaratën se "nuk do të largohej".

Kjo në fakt do të thoshte se Unitedi ose do ta mbështeste portugezin, ose do ta shkarkonte atë.

Me taktikën e tij që ishte shqetësim i vazhdueshëm dhe me drejtuesit e klubit tashmë të brengosur nga qasja brutale e Amorimit ndaj lojtarëve të akademisë, gjasat për të zgjedhur shkarkimin ishin në rritje. Këtë e ndihmuan kritikat e Amorimit ndaj anëtarëve me përvojë të skuadrës.

Dhe ai u shkarkua të hënën.

## Papa, formacioni dhe fillimi i fundit

Angazhimi i Amorimit u pa si një lëvizje progresive. Klubi solli dikë që do të punonte në një strukturë moderne dhe do të zhvillohej me kalimin e kohës. Por me 40-vjeçarin erdhi një stil specifik i lojës. Dhe formacioni 3-4-3 që ai e kishte shfrytëzuar te Sportingu.

Sa më shumë që pyetej për këtë, aq më shumë Amorim e forconte bindjen se ndryshimi do të humbte respektin ndaj tij te lojtarët. Ai ndiente se lojtarët do të mendonin se me ndryshim të formacionit nuk do të ishte i përkushtuar ndaj ideve të tij.

Ndërsa ishte i sigurt në metodat e tij – madje në një moment duke theksuar se as Papa nuk do të mund ta bindte të ndryshonte – Amorim pranoi në tetor se iu desh t'u thoshte lojtarëve të tij të injoronin zërat e jashtëm që vazhdimisht thoshin që sistemi i tij duhej të ndryshonte.

"A do të diktojë media se çka do të bëj unë?", iu drejtua Amorim gazetarëve.

"Nuk mund të ndodhë. Nuk është e mundur të ndodhë kjo. Por lojtarët e mi, ju garantoj për këtë, po dëgjojnë çka flitet dhe po e fusin këtë brenda, sepse ne nuk po fitojmë ndeshje. Ata duhet të besojnë tek unë, sepse unë shikoj më shumë ndeshje se të gjithë ju së bashku".

E gjithë kjo u kthye në vëmendje më 30 dhjetor. Katër ditë më herët ai e ktheu mbrojtjen me katër lojtarë dhe fitoi 1:0 ndaj Newcastle Unitedit. Por menjëherë kaloi në mbrojtjen me tre në ndeshjen ndaj Wolvesit.

Kjo nënkuptonte zhvendosjen e Patrick Dorgus nga roli sulmues në krahun e djathë, ku ishte shumë efektiv më 26 dhjetor. Dhe ai u zhvendos në mbrojtës të krahut të majtë.

Tifozët ishin të habitur, por edhe shumë të zhgënjyer në të njëjtën kohë.

Nuk ishte befasi që formacioni kundër Wolvesit dhe barazimi 1:1 ndaj skuadrës që kishte mbledhur vetëm dy pikë gjatë gjithë sezonit, sollën fishkëllima për ekipin. Dhe u pa shumë negativisht brenda klubit.

Drejtori teknik, Jason Wilcox foli privatisht me Amorimin më pas, duke e inkurajuar për fleksibilitet më të madh taktik. Por skuadra vazhdoi me tre mbrojtës ndaj Leedsit.

Ishte një hap tjetër i madh prapa në marrëdhënien e Amorimit me shefat e tij. Dhe kritikat e tij të vazhdueshme vetëm sa e përkeqësuan situatën.

Amorimi donte të lihej vetëm për ta bërë punën e tij, të lirë nga ndikimi i padëshiruar i Wilcox.

Por ajo që Amorimi e pa si ndërhyrje, Unitedi e konsideroi si reagim normal, e të cilit i ishte rezistuar vazhdimisht.

Situata u bë e papërballueshme. Unitedi është i gjashti, në përputhje me pritjet që ishin para fillimit të edicionit. Por ka skuadër që shumë njohës besojnë se me disa ndryshime të thjeshta taktike mund të ketë rezultate dukshëm më të mira.

Të hënën në mëngjes në Carrington, Wilcox dhe drejtori ekzekutiv, Omar Berrada, i thanë Amorimit se ishte shkarkuar.



## Lëvizjet e lojtarëve

Me Amorimin, Unitedi është zhytur në një mënyrë që nuk duket e mundshme nëse për bazë merret se si janë rregulluar financat e futbollit këto ditë. Klubi i katërt më i pasur në botë ka garuar me rivalë dukshëm më të vegjël, por të drejtuar mirë, si Brentfordi, Bournemouthi dhe Brightoni.

Amorimi në verë premtoi se ky edicion do të ishte më i mirë. Ishte në një masë, por tifozët pyesin nëse një trajner i Unitedit mund të krahasohet me vend të 15-të.

Tek Unitedi e kanë ditur se skuadra që ishte nuk përshtatej në idetë taktike të Amorimit. Dhe klubi e mbështeti me më shumë se 200 milionë funte gjatë verës, për të blerë lojtarët që i duheshin. Dhe po ashtu aprovoi largimin e Marcus Rashfordit, Jadon Sanchos, Antonyt dhe Alejandro Garnachos.

Drejtuesit po ashtu respektuan dëshirën e Amorimit për të ndryshuar sulmuesin kryesor. Rasmus Hojlund kaloi te Napoli, kurse Benjamin Sheshko shënoi vetëm dy gola në 17 paraqitje pas transferimit prej 74 milionë funtesh nga RB Leipzigu.

Në përgjithësi rekrutimi ishte dështim tek Unitedi. Madje dështim kolektiv. Dhe klubi nuk është më atraktiv si më parë.

Amorim tashmë i takon historisë, njëjtë si David Moyes, Louis van Gaal, Jose Mourinho, Ole Gunnar Solskjaer, Ralf Rangnick e Erik ten Hag para tij.

Kërkimi për trajnerin e ri ka nisur. Por mund të duhet më tepër sesa vetëm një njeri i ri në krye për të zgjedhur problemet e Unitedit.

# Te “Dardanët” mund të ketë lëvizje, por jo të shumta

**Arsim Maxhera**



PRISHTINË, 5 JANAR – Mesfushori Lindon Emërllahu ka kaluar nga Cluji rumun te skuadra ukrainase, Polissya Zhytomyr. Kalimin te Polissya së shpejti pritet ta zyrtarizojë edhe mbrojtësi Ilir Krasniqi, që ende është lojtar i skuadrës tjetër ukrainase, Kolos Kovalivka.

Emërllahu e Krasniqi janë reprezentues të Kosovës. Dhe pritet të jenë prej jo shumë lojtarëve “Dardanë” që ndërrojnë mjedis para fillimit të garës për vitin 2026.

Afati kalimtar i janarit nuk pritet të ofrojë shumë lëvizje të lojtarëve të Kosovës. Në verë kishte lëvizje të shumta e të bujshme, ndërsa në janar pritet të jetë më qetë.

Në fakt ka diskutime të shumta për lojtarë të caktuar të Kosovës, sidomos për Fisnik Asllanin. Sulmuesi 23-vjeçar tani vlerësohet 30 milionë euro, ndërsa ka kontratë me Hoffenheimin deri në qershor të vitit 2029. Me gjithë interesimin e skuadrave të mëdha, sidomos nga Gjermania, gjasat janë më të mëdha që shtatlarti ta kompletojë këtë edicion te Hoffenheimi e më pas të bëjë transferim. Bayerni e Borussia Dortmundi janë prej skuadrave që janë përmendur lidhur me transferimin e ardhshëm të Asllanit. Ka pasur raportime edhe për interesim të Barcelonës.

Asllani ka gjashtë gola e dy asistime në Bundesligë, ndërsa realizoi gola vendimtarë për Kosovën. Disa gola të tjerë në elitën gjermane do ta rrisnin ndjeshëm vlerën e tij. Hoffenheimi tani, por edhe në verë, vështirë se do të heqë dorë nga sulmuesi pa një dëmshpërblim të majmë.

Te sulmuesit e tjerë vështirë se mund të ketë lëvizje. Vedat Muriqi është stabilizuar te Mallorca, ndërsa Albion Rrahmani po kërkon stabilitetin te Sparta Praga.

Edon Zhegrova po ashtu po kërkon të stabilizohet te Juventusi, ndërsa Baton Zabërgja në verë kaloi te Metalist 1925 në Ukrainë. Ermal Krasniqi pritet ta kompletojë kampionatin te Legia Varshava në Poloni.

Gjasat vlerësoheshin të mëdha që Milot Rashica të bënte transferim në janar, por situata e tij ndryshoi për të mirë në javët e fundit. Në tri paraqitjet e fundit me Beshiktashin turk, Rashica i kishte dy asistime e një gol vendimtar.

Rashica po paraqitet mirë edhe në fazën përgatitore dhe gjasat që transferimi te Trabzonspori të realizohet janë gjithnjë e më të vogla.

“Milot Rashica, që nisi ta fitonte rastin në ekipin startues pas lëndimit të Cengiz Underit, mori aprovimin e stafit teknik me paraqitjet e tij në kampin stërvitor në Antalya”, shkruan të hënën “Fotomaç”. Ky medium i njohur në Turqi ka shkruar se Rashica është duartrokitur pas golave që i shënoi në ndeshjet stërvitore.

Mesfushorët kryesorë të Kosovës, Elvis Rexhbeçaj, Leon Avdullahu, Florent Muslija e Veldin Hoxha nuk pritet të lëvizin në janar. Valon Berisha ka kohë që nuk po luan për LASK-un në Austri, ndërsa në katër ndeshjet e fundit as që ishte grumbulluar. Berisha, që te Kosova është rezervist, mund të kërkojë ndonjë opsion më të mirë.

Muharrem Jashari, që është në Ukrainë te LNZ Cherkasy, shpreson për një lëvizje pozitive, për të rritur gjasat që në përfaqësuese të ketë më shumë minuta.

Në mbrojtje po ashtu nuk priten lëvizje të mëdha, ndonëse Lumbardh Dellovës do t’i kryente shumë punë kalimi në ndonjë klub më të madh se ai bullgar CSK Sofia.

Me nivelin që ka arritur Kosova, ligat si ajo e Ukrainës dhe e Bullgarisë nuk është se ofrojnë garanci për vend startuesi. Për lojtarët, pos paraqitjet me përfaqësuese, peshë kanë edhe ligat e klubet ku aktivizohen.

Prej portierëve, Visar Bekaj duhet të gjejë klubin e ri, kurse dy të parët, Arijanet Muriq e Amir Shaipi, pritet të qëndrojnë te skuadrat aktuale.

Shtabi teknik i udhëhequr nga Franco Foda mund të jetë i kënaqur me gjendjen e lojtarëve të Kosovës në skuadrat e tyre. E rëndësishme do të jetë që lojtarët të mos pësojnë lëndime serioze deri në mars, kur janë ndeshjet e plejofit për kualifikim në Botëror.

© KOHA Ditore

# A do të ndryshojë Ylli me Bamforthin?

**Arsim Maxhera**



PRISHTINË, 5 JANAR – “A jeni gati? Për 50 vite histori”.

Me këtë postim Golden Eagle Ylli paralajmëroi një edicion të suksesshëm në basketbollin kosovar, në 50 vjetorin e themelimit si klub.

Postimi ishte bërë që më 20 qershor të vitit të kaluar. Ylli i Suharekës më pas prezantoi logo jubilare, mori trajner cilësor të huaj e po ashtu e mbushi skuadrën me lojtarë cilësorë e të shtrenjtë, të huaj e vendorë.

Çdo gjë dukej në rregull, pos rezultateve. Fitoret ishin të rralla e kritikat ndaj skuadrës të shumta. U largua kryetrajneri grek, Fotis Takianos, e në vend të tij erdhi kroati Jeronimo Sharin, që e njeh goxha mirë ligën kosovare. Por gjendja sa u takon rezultateve nuk ndryshoi as pas ardhjes së Sharinit, ndonëse ai nuk kishte shumë kohë në dispozicion.

Sharin po ashtu u largua dhe trajneri i ri pritet të zyrtarizohet së shpejti.

U zëvendësuan edhe lojtarë të huaj, por as kjo nuk kreu punë.

Golden Eagle Ylli në vjeshtë i kishte vetëm katër fitore në Superligë, ndërsa i pësoi plot nëntë humbje. Dhe skuadra që pritej të luftonte për titull, me gjendjen momentale në tableë, duhet të luftojë për mbetje në Superligë. Bilanc si Ylli ka vetëm edhe Vëllaznimi. Skuadrat tjera kanë më shumë fitore.

Suharekasit megjithatë janë optimistë për sukses. Dhe optimizmin e mbështesin te një lojtar tjetër amerikan. Te Scott Bamforthi.

Që më 20 nëntor, Ylli njoftoi për arritjen e marrëveshjes me Bamforthin, dikur reprezentues i Kosovës. Por ai u bashkua në stërvitje me skuadër vetëm fundjavën që kaloi.

“Golden Eagle Ylli ka nënshkruar me Scott Bamforth, lojtari i natyralizuar si kosovar, i cili do të sjellë energji, përvojë dhe spektakël në parket. Bamforth pritet t’i bashkohet ekipit në javët në vazhdim”, shkruan në njoftimin e Yllit të publikuar më 20 nëntor.

Javët u shndërruan në një muaj e gjysmë. Dhe Bamforth pritet të debutojë këtë javë te suharekasit, përkatësisht të mërkurën në ndeshjen çerekfinale për Superkupë ndaj Trepçës.

Bëhet fjalë për lojtar cilësor dhe me shumë përvojë. 36-vjeçari luan në pozitën e fundorit. Së fundi luajti me sukses në Meksikë. Pas karrierës në NCAA, luajti në elitën e Spanjës për plot shtatë edicione. Ishte edhe në elitën e Italisë dhe të Francës, ndërsa një edicion u paraqit për Buduqnostin e Podgoricës. Bamforthi asnjëherë nuk ka ulur nivelin e paraqitjes dhe tani përvojën superiore e vë në dispozicion të Yllit.

“Stërvitja e parë e Scott Bamforthit dhe ai tashmë e shijon atë”, shkruan në një tjetër postim të klubit suharekas.

Forca e re e Yllit do të testohet seriozisht të mërkurën nga ora 18:45 në “Minatori”. Çerekfinalja e Kupës zhvillohet në dy ndeshje, por e para është me peshë të madhe.

“KB Golden Eagle Ylli nuk do të ndalet së punuari me përkushtim maksimal për t’iu bërë krenarë secilin prej jush. Viti 2026 do të jetë më i zjarrtë se kurrë”, janë optimistë suharekasit.

Ylli vlerësohet prej klubeve që përfitojnë më së shumti nga sponsorizimi. Paratë e shumta deri më tani nuk kanë nënkuptuar sukses. Mbetet të shihet nëse kjo do të ndryshojë ndërkohë.